



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

**PERFORMANCA E SHOQËRIVE PUBLIKE TË SEKTORIT ENERGHJITIK
NË ADMINISTRIMIN E REZERVËS HIDRIKE NË KASKADËN E LUMIT
DRIN, PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË
ENERGHJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021-2022**



JANAR 2023

***Publik:** Ky dokument u gjenerua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, specifikisht neni 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3 E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti lutemi të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.*

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë. www.klsh.org.al



RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“PERFORMANCA E SHOQËRIVE PUBLIKE TË SEKTORIT ENERGETIK NË ADMINISTRIMIN E REZERVËS HIDRIKE NË KASKADËN E LUMIT DRIN, PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021-2022”

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 342/5 prot., datë 22.07.2022.

Faza studimore e auditimit nisi në dt. 27.04.2022 me shkresën për njoftim-fillim auditimi nr. 342/3 prot., datë 21.04.2022.

Faza e terrenit të auditimit nisi në dt. 22.07.2022 me programin e auditimit të cituar më lart dhe përfundoi më datë 31.10.2022.

Projekt-raporti i auditimit, ju përcoll subjekteve të mëposhtme me shkresën nr. 342/6, date 22.12.2022.

1. Entit Rregullator të Energjisë
2. Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA
3. Operatorit të Sistemit të Transmetimit SHA
4. Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare SHA

Në respektim të afatit 1-mujor, ERE përcolli shkresën nr.1372/2 prot., datë 05.12.2022, duke shprehur dakordësi të plotë me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH-së. Gjithashtu dhe subjekti tjetër OST përcolli shkresën nr. 2575/3 Prot. Date 05.12.2022., duke shprehur dakordësi të plotë me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH-së.

Observacioni i paraqitur nga KESH i përcjell me shkresën nr. 2011/3 Prot date 27.12.2022 dhe FTL me shkresën nr. 11200/1. Prot., datë 22.12.2022., janë përfshirë në fund të këtij raporti në seksionin Shtojssa 7/1, 7/2 dhe 7/3, së bashku me argumentimin e grupit auditues dhe qëndrimin final të KLSH-së për to.

Në rastin kur observacionet e subjektit kanë sjellë në vëmendje të grupit të auditimit, informacion shtesë, të paaudituar më parë, ndryshimet janë bërë nga vetë grupi auditues, duke dhënë shpjegimet e nevojshme në shënimin përkatës, në fund të faqes respektive.

Dosja audituese kaloi në filtrin e Kryeaudituesit dhe Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, Drejtorisë së Kontrollit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, Drejtorit të Përgjithshëm dhe më pas i'u përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.



PERMBAJTJA

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	5
<i>1.1. Konteksti i problemit social</i>	<i>5</i>
<i>1.2. Rëndësia e auditimit të performancës</i>	<i>6</i>
<i>1.3. Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë</i>	<i>6</i>
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	7
<i>2.1. Hyrje në subjektet nën auditim</i>	<i>8</i>
<i>2.2. Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim</i>	<i>14</i>
<i>2.3. Rëndësia e produkteve të subjektit</i>	<i>15</i>
<i>2.4. Pesha në Buxhet dhe PBB</i>	<i>15</i>
<i>2.5. Përkufizimet dhe terminologjia</i>	<i>17</i>
<i>2.6. Skema e analizës së programit</i>	<i>17</i>
<i>2.7. Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit</i>	<i>18</i>
3. DETAJET E AUDITIMIT	18
<i>3.1. Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit</i>	<i>18</i>
<i>3.2. Objektivat e auditimit</i>	<i>19</i>
<i>3.3. Pyetjet e auditimit</i>	<i>20</i>
<i>3.4. Kriteret audituese</i>	<i>22</i>
<i>3.5. Qasja e auditimit</i>	<i>23</i>
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NENPYETJEVE	23
5. PERMBLEDHJE	68
6. GRUPI I PUNËS	71
7. ANEKS	72
<i>7/1. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I KESH-it</i>	<i>75</i>
<i>7/2. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I FTL-së</i>	<i>77</i>
<i>7/3. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I FSHU-së</i>	<i>78</i>
<i>7/4. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I ERE</i>	<i>80</i>
<i>7/5. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I OST-së</i>	<i>80</i>



Lista e shkurtimeve

ALPEX	Bursa Shqiptare e Energjisë elektrike
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
FPE	Furnizues me Pakice i Energjisë
FPSH	Furnizues Publik me shumice i Energjisë Elektrike
FSHU	Furnizuesi i Shërbimit Universal
FTL	Furnizuesi i Tregut të Lirë
ISMSI	Manuali i Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit
KESH	Korporata Energjetike Shqiptare
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPE	Prodhuesit e Pavarur të Energjisë
PV	Foto Voltaik (Photo Voltaic)
SEE CAO	Coordinated Auction Office in South East Europe
SENA	Solar Energy of Albania
SWOT	Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT


1.1. Konteksti i problemit social

Fillimi i pandemisë së Covid-19 ndër të tjera u shoqëruar me rënie të madhe të kërkesës për energji elektrike. Kur ekonomia botërore pas fazës së post pandemisë filloi të rimëkëmbet brenda një normaliteti të ri, prodhuesit e energjisë elektrike reagojnë ngadalë ndaj rritjes së kërkesës për energji elektrike. Bile në këtë periudhë vazhdoeshin përpjekjet për energjinë e gjelbër dhe zvogëlimin të emetimeve të CO₂ sipas direktivave të Bashkimit Evropian. Pas fillimit të "normalitetit të ri" në bashkëjetesë me pandeminë covid-19 dhe pasojat e luftës në Ukrainë, industria botërore rriti kërkesën për energji dhe kryesisht atë elektrike, si rezultat tregjet ndërkombëtare u ballafaquan me një rritje të shpejtë të çmimit të energjisë elektrike, duke shënuar vlera maksimale historike që kur nuk ishin dëgjuar më parë.

Për ta pasqyruar këtë fakt më poshtë paraqitet çmimet minimale të bursës së energjisë elektrike të Hungarisë-HUDEX dhe çmimet e blerjes nga shoqëritë publike shqiptare të energjisë elektrike (KESH, OST, OSHEE Grup) në funksion të veprimtarisë së tyre ligjore.

Tabela nr.1. Çmimi në Bursë dhe i blerjes nga shoqëritë publike shqiptare (euro/MWh)

Viti	Gush												
	Jan.	Shk.	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	.	Shta.	Tet.	Nent.	Dhj.	
¹ HUDEX	2021	50	42	43	60	61	62	66	70	78	150	150	197
	2022	121	144	165	197	226	232						
² KESH	2021						69	86	101	145	175	190	236
	2022	237	230	238	210	211							
³ FTL	2021	51	51	51	51	51	51	110	127	167	271	278	234
	2022	254	231	231	231								
⁴ OST	2021	68	43	51	48	51	53	68	84	96	178	223	256
	2022	258	234	338	239	232	230						



Burimi: KESH, FTL, OST, HUDEX, përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

Në referim të çmimeve të energjisë elektrike në bursën hungareze HUDEX vërehet se prej muajit Qershor 2021 filloj një rritje e lehtë e çmimit të energjisë elektrike duke pësuar në muajt pasues rritje

¹ Burimi: <https://hudex.hu/en/> çmimi HUDEX ne table paraqitet çmimin minimal për muaj.

² Burimi: KESH, përpunimi grupi i KLSH

³ Burimi: OSHEE grup, përpunimi grupi i KLSH

⁴ Burimi: OST, përpunimi grupi i KLSH



ekspontenciale për të vijuar nga 72 euro/MWh dhe për të arritur amplitudën më të lartë në muajin dhjetor 2021 me 256 euro/MWh.

Ky trend rritës u mbajt dhe përgjatë gjashtëmujorit të parë, të vitit 2022 dhe duke shënua vlerën më të lartë në muajin Korrik të 2022 me 359 euro/MWh.

Rritja e çmimeve të energjisë në bursat ndërkombëtare, u reflektuan edhe në ekonomitë e vendeve të ndryshme. Ndodhur në këtë situatë edhe vendi ynë u përball me një rritje të çmimit të blerjes së energjisë elektrike. Situata në fillim të krizës energjetike u bë më komplekse edhe si rezultat i problematikave të shfaqura në administrimin e rezervave hidrike nga shoqëritë publike përgjegjëse, por edhe të mungesës së operimit të bursës të energjisë elektrike shqiptare si pjesë e funksionimit të modelit të tregut të energjisë elektrike.

Në tabelën e mësipërme nr.1 pasqyrohen çmimet e blerjes së energjisë elektrike për shoqëritë publike shqiptare, të cilat u "kapën" befasisht në këtë trend rritje të çmimit të blerjes duke u vendosur në vështirësi financiare të likuiditeteve të tyre për të përballuar blerjen e energjisë elektrike me çmime të larta. Për këtë qëllim qeveria shqiptare financoi kompanitë publike të sektorit energjetik KESH dhe OSHEE për përballimin e blerjes së energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare.

1.2. Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi është një pjesë thelbësore e procesit të llogaridhënies për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Nëpërmjet auditimit të performancës bëhet një ekzaminim i pavarur për të kuptuar nëse angazhimet qeveritare, operacionet, programet, aktivitetet apo institucionet e saj janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim në aktivitetin e tyre. Veç këtyre, nëpërmjet auditimit, KLSH bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj.⁵ Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI 2017-2023, të cilat gjejnë pasqyrim në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022. Sipas kësaj Strategjie, KLSH ka për objektiv rritjen e cilësisë së auditimit dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, nëpërmjet audituesve të përgatitur dhe të mirë-trajnuar. Tematika e auditimeve të performancës nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.78, datë 30.06.2020⁶. KLSH ka kryer në mënyrë periodike auditime në sektorin energjetik të cilat kanë qenë auditime përputhshmërie dhe performance në lidhje me detyrimet e ndërmjetme të shoqërive publike të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Kryerja e auditimit në sistemin energjetik vjen si domosdoshmëri për të vlerësuar mekanizmat e përdorur nga shoqëritë publike përgjegjëse të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke patur si qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të këtyre shoqërive për garantimin e furnizimit me energji elektrike në mënyrë të pandërprerë dhe kosto optimale për konsumatorët familjar dhe jo familjar. Gjithashtu fillimi i këtij auditimi vjen si përgjigje ndaj reagimit dhe sensibilitetit të lartë të shoqërisë të shfaqur në lidhje me krizën energjetike globale dhe me pasoja për vendin tonë.

1.3. Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

KLSH kryen auditime periodike vjetore të përputhshmërie në subjektet KESH, OSHEE, OST. Në vitin 2016, KLSH ka kryer auditim performance⁷ mbi detyrimet e ndërsjella KESH-OST-OSHEE. Ndër konkluzionet kryesore të auditimit ishin:

⁵ Neni 6 i Ligjit 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

⁶ Manuali i Auditimit të Performancës.


⁷ Program auditimit nr. 875/5 prot., datë 28.10.2016



- Mos respektimi i marrëveshjeve dhe procedurave ligjore nga ana e kompanive, ka sjellë akumulimin dhe rritjen e detyrimeve të ndërsjella, të cilat i kanë vendosur në vështirësi këto shoqëri që të operojnë në kushte normale, për realizimin e misionit të tyre.
- Aktet nënligjore të nxjerra për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet KESH dhe OSSH në periudhën transitorë, kanë qenë të pa konsultuara me organet drejtuese të shoqërive përkatëse dhe nuk kanë reflektuar saktë problematiken e vërtetë të këtyre shoqërive, duke shërbyer si pikënisje për akumulimin e detyrimeve të ndërsjella.
- Strategjia e ndjekur nga operatori privat i shpërndarjes CEZ, jo vetëm që nuk e përmirësoi situatën financiare të kompanisë, por përkundrazi solli një përkeqësim të tregueseve financiare dhe një rritje të detyrimeve të ndërsjella, ndërmjet shoqërive të sektorit energjetik, duke vështirësuar operimin normal të këtyre shoqërive.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

1. Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare - KESH.
3. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike – OSHEE Grup.
4. Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST.
5. Enti Rregullator i Energjisë – ERE



⁸ Vendimin nr.10 datë 04.06.2021 i Këshillit Mbikëqyrës “ Miratimi strukturës organizative të KESH”

⁹ Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".



2.1. Hyrje në subjektet nën auditim

2.1.1. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A.

OSHEE është shoqëri aksionare, me 100% kapital shtetëror prej Tetorit 2014.

Aksionari i Shoqërisë "OSHEE" për periudhën nga 23.10.2014 deri në 05.05.2016 ka qenë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS).

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 317, datë 27.04.2016, përcaktoj Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si pronar të aksioneve të shoqërisë "OSHEE".

Vendimi Nr. 96 dhe 97 datë 27.10.2014 të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, i dha licencën OSHEE-s për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore.

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është të ofrojë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes për fushat e mëposhtme:

1. Kryerjen e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, me tarifa të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar;

2. Kryerjen e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejt të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) Ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve;

b) lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;

c) instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike.

3. Zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar në ndryshimet rajonale apo territoriale të kërkesës;

4. Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi;

5. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencat e shoqërisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, OSHEE mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura sa më sipër.

Organizimi i shoqërisë OSHEE

Vendimarrja dhe administrimi i Shoqërisë OSHEE Grup është e organizuar në dy nivele¹⁰, nga Asambleja e Përgjithshme si organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës.

Administratori i OSHEE Grup, zgjidhet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe është i ngarkuar me administrimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë.

Administratori vendos për çdo çështje që nuk është kompetencë ekskluzive e Asamblesë së Përgjithshme ose e Këshillit Mbikëqyrës.

Administratori raporton pranë Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit dhe realizimin e transaksioneve me rendësi të veçantë për performancën e shoqërisë.

Ndarja e shoqërisë OSHEE

Si rezultat i ristrukturimit të shoqërisë dhe ndarjes së aktivitetit të shpërndarjes¹¹ së energjisë elektrike, Licenca e operimit të sistemit të shpërndarjes i ka kaluar shoqërisë OSSH Sh.a.

Ndërsa Licenca për furnizimin dhe detyrimin e shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike i ka kaluar shoqërisë FSHU Sh.a, ndërsa Licenca për tregtimin e energjisë elektrike i kaloi shoqërisë FTL Sh.a.

¹⁰ Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Pjesa V, Titulli IV, Kapitulli III i.

¹¹ Pika 1e nenit 72 në Ligji 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë"; Urdhri i Ministrit të MIE nr. 157 dt. 12.02.2018 dhe Vendimi i ERE Nr. 211 datë 18.12.2019 "Mbi shtyrjen e periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike,..."



Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - OSSH

Në datën 1 janar 2020 ka filluar aktivitetin Shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" - OSSH Sh.A., e cila është shoqëri bijë e OSHEE Sh.A dhe ka për objekt shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) është organizuar në 11 Drejtori Rajonale dhe 4 Njësi te TL.

OSSH është i organizuar në një nivel administrimi dhe administrohet nga Këshilli i Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë.

Furnizuesi i Shërbimit Universal - FSHU

Në datën 1 janar 2020 ka filluar aktivitetin Shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A" - FSHU Sh.a., e cila është shoqëri bijë e OSHEE Sh.a., dhe ka për objekt furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë.

FSHU është i organizuar në një nivel administrimi dhe administrohet nga Këshilli i Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë.

Furnizuesi i Tregut të Lirë - FTL

Në datën 1 janar 2020 ka filluar aktivitetin Shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë Sh.A, (FTL Sh.A), e cila është shoqëri bijë e OSHEE Sh.A, dhe ka për objekt blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë. Për më tepër Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitetet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi.

FTL është i organizuar në një nivel administrimi dhe administrohet nga Këshilli i Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë.

2.1.2. Operatori i Sistemit të Transmetimit - OST

Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA., është një shoqëri tregtare 100% me aksione shtetërore. OST është krijuar më datë 14/07/2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar me funksione të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në tre shoqëri të veçanta, ku OST¹² kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispečimit dhe Operatorit të tregut.

Objekti i veprimtarisë së OST është realizimi i transmetimit të energjisë elektrike nga asetet gjeneruese të KESH SHA në infrastrukturën shpërndarëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, apo tek "konsumatorët e kualifikuar" të lidhur në rrjetin e transmetimit, si dhe transmetimin e energjisë elektrike në linjat e interkoneksionit me vendet fqinje.

Shoqëria OST SH.A., ka si objekt të veprimtarisë:

- Operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike.
- Operimin e sistemit të transmetimit nga pikëpamja e dispečerimit.
- Operimin e tregut të energjisë elektrike.

Vendimmarrja dhe administrimi i Shoqërisë OST SH.A. është e organizuar në dy nivele, nga Asambleja e Përgjithshme si organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë; dhe Këshilli Mbikëqyrës Këshilli Mbikëqyrës, përbëhet nga gjashtë anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Aksionarëve, përfaqësohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.


¹² Veprimtaria e shoqërisë bazohet në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme e Shoqërisë, si dhe ligjeve të tjera të Republikës së Shqipërisë.




2.1.3. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare – KESH SH.A.

Objekti i Shoqërisë është: Prodhimi, transformimi, shitja dhe blerja e energjisë elektrike; Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, makinerive dhe gjithë pasurive të tjera të saj; Ndërtimi i burimeve të reja për prodhimin e energjisë elektrike, etj.

Më poshtë paraqitet ecuria e transformimit të KESH-it në vite:



Kaskada e Drinit. Në shtratin e lumit Drin janë ndërtuar hidrocentralet e Fierzës, Komanit, Vaut te Dejës dhe Ashtës me kapacitet të instaluar rreth 1,400 MW, nga të cilët tre HEC-et parë administrohen nga KESH. Njësitë e Prodhimit janë organizuar mbi bazën e hidrocentraleve të mëdhenj dhe të mesëm që ka Shqipëria, të cilat janë pronë shtetërore. Këto hidrocentrale janë të ndërtuara në kaskadën e lumit Drin; HEC Fierza me fuqi të instaluar 500 MW, HEC Koman me fuqi të instaluar 600 MW dhe HEC Vau Dejës me fuqi të instaluar 250 MW.



- HEC Fierzë**

HEC Fierzë është hidrocentrali i parë i kaskadës i ndërtuar në lumin Drin në Fierzë. HEC Fierzë është i tipit me digë dhe rezervuar, diga është digë dheu, me bërthamë argjile me përmasa: lartësi 170 m, gjatësi 350 m dhe gjerësia e digës nga 350 m në bazamentin e saj, në 11 m në kreshtën e digës. Nga diga e Fierzës është krijuar një rezervuar me një volum të përgjithshëm 2,7 miliard m³ ujë dhe një sipërfaqe prej 7,2 km². Në HEC Fierzë janë instaluar 4 agregate me turbina me fuqi 125 MË për çdo njësi dhe fuqi totale të instaluar 500 MW. Prodhimi vjetor i projektuar i HEC Fierzës është 1,800 GWh.
- HEC Koman**


HEC Koman u ndërtua në Lumin Drin në pjesën veri-lindore të Shqipërisë në mes të kaskadës së Drinit. Baseni i këtij HEC-i ka një kapacitet prej 450 milion m³ ujë. Impianti u vu në punë në dy faza: njësitë 1, 2 dhe 3 në vitin 1985 dhe njësia 4 është vënë në punë në vitin 1988. Diga është e lartë 125 m. Dy tunele furnizojnë me ujë të katër turbinat që ndodhen në sallën e turbinave. Kapaciteti i instaluar i HEC Koman është 600 MW dhe prodhimi mesatar vjetor 2,060 GWh. Impianti është i lidhur me rrjetin 220 kV të transmetimit.
- HEC Vau i Dejës**

HEC Vau i Dejës ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë, në fund të kaskadës së lumit Drin, pranë qytetit të Shkodrës. Baseni i këtij HEC-i ka një kapacitet prej 580 milion m³ ujë. Edhe ky impiant është vënë në punë në dy faza: njësia 1, 2 dhe 3 në vitin 1970 dhe njësia 4 dhe 5 në vitin 1975. Diga është 90 m e lartë. Ka dy tunele furnizimi që çojnë ujin në të pesta njësitë e instaluar. Kapaciteti i instaluar është 250 MW me një prodhim mesatar vjetor prej 1,000 GWh. Impianti është i lidhur me rrjetin 220 KV të transmetimit.

Për të kuptuar më mirë korrelacionin midis nivelit të liqenit të Fierzës dhe të rezervës energjetike potenciale që mund të gjenerohet nga HEC-i i Fierzës, grupi i KLSH e transpozoi në një korrelacion varësie nivelin e liqenit me rezervën energjetike, për mundësiar një vlerësim analitik për këdo dhe jo vetëm për specialistet e fushës, pasi vetëm ky korrelacion na lejon të kuptojmë realisht në vlerë absolute rezervën energjetike për çdo rritje apo rënie të nivelit të ujit në liqenin e Fierzës. Më poshtë paraqitet grafikisht ky korrelacion: Nëse e interpretojmë këtë grafik, kuptojmë që për lartësinë maksimale të liqenit të Fierzës në kuotën 297 m.m.n.d. rezerva energjetike koresponduese është 1,439 GWh dhe për kuotën 296 m.m.n.d. është 1,390 GWh. Pra në këtë rast ku niveli i liqenit ka zbritur me 1 m, kemi humbur rezervë energjetike me 49 GWh. Interpretimi për çdo nivel të ujit në liqen,

pasqyrohet në kurbën e grafikut të mësipërm. Në rast se nëse niveli i liqenit të Fierzës shkon në 258 m.m.n.d rezerva energjetike disponibël është 259 GWh.


Pra nëse i referohemi rezervës maksimale energjetike tregon që në lartësinë 258 m.n.n.d. kemi humbur rezerve hidrike koresponduese në energjetike në masën 1,180 GWh.



2.1.4. Skema e Tregut të energjisë elektrike

Në skemën nr.2 paraqitet marrëdhënia midis aktoreve të tregut shqiptar të energjisë elektrike sipas dy komponentëve të saj, atë të flukseve dhe marrëdhënieve tregtare midis tyre, të cilat ndahen në prodhues, transmetues dhe shpërndarës.

Skema nr.1: Skema e funksionimit të tregut Shqiptar të energjisë



Burimi: OST

2.1.5. Bilanci elektroenergjetik 2021

Prodhimi total neto i energjisë elektrike për vitin 2021 ka qënë 8,962 GWh, ku 5,343 GWh ose 59.6% u prodhua nga asetet gjeneruese të KESH SH.A. dhe 3,618 GWh ose 40.4% u prodhua nga asetet e tjera gjeneruese jo prone e KESH-it. Prodhimi i energjisë elektrike me 8,962 GWh në vitin 2021, paraqet sasinë mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009–2021.

Pasi mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2020 ka qënë 6,076 GWh.

Ndërkohë që prodhimi i realizuar në vitin 2021 rezulton të jetë 2,887 GWh ose 47.5% më i lartë se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2020.

Më poshtë paraqitet i plotë Bilanci elektroenergjetik për vitin 2021.

BILANCI ELEKTROENERGITIK 2021 (MWh)

Produimi neto publik		Prodhuar nga PPE në rrjetin e OSSH			Prodhuar nga PPE në rrjetin e OST		Prodhuar nga PPE te pa varur					Produim neto vendas			
Produimi Neto KESH sha		Neto (Selit)	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OSSH për FTL	FOTOVOLTAIK	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OST për FTL	Neto Ashta	Neto Banja	Neto Mogleka	Neto KURUM	H/C Peshqesh	H/C Fanga	Produim neto vendas			
5,343,974		27,504	877,726	40,756	951,505	295,245	258,632	424,642	406,632	99,316	236,767	8,962,699			
<i>Ballanca e shkembimeve në Interkoneksion. Ballanca e shkembimeve të brend (pa OST, OSH EE). Shitur OST per Humbje + konsum vetiak Konsum uar nga Tec Vlora Devijim e nga Programi i Interkoneksionit Energji per shërbime ndihmese+di shalanca</i>	1,412,345														
Energji per FSHU nga KESH sha	3,931,629														
		Energji e siguruar nga FTL											Balanca në interkoneksion (dhënie)		
		Elerje Neto (Selit)	Elerje HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OSSH për FTL	Elerje FOTVOLTAIK	Elerje HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OST për FTL	Elerje Neto Ashta	Elerje ne Treg të Liberalizuar nga FTL	nga ost Tec Ballsh	nga ost per klientet ne treg te liber.				Balanca në interkoneksion (dhënie)		
		27,504	877,726	40,756	951,505	295,245	1,131,422	719	64,916				547,896		
		3,389,793													
		Energji nga KESH per FSHU		Energji nga FTL per FSHU		Energji për humbjet OSSH		Kliente te FTL ne treg te Liberalizuar		Eksport FTL		Energji në hyrje dhe dalje (transmetuar) për klientet ne treg te liberalizuar e të lidhur ne rrjetin e OSSH		Konsumi total i vendit	
		3,931,629		1,566,219		1,556,953		17,935		183,770		64,916		8414,803	
		5,497,848		Energji për FSHU						-64,916					

2.2. Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit paraprak, të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, kriteret të cilat do të përdorim për vlerësimin e evidencave, identifikimin e gjetjeve, hartimin e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve, janë si më poshtë vijon:

Kriteret e politikës

- Strategjia Kombëtare e Energjisë, 2018-2030.
- Direktiva 2009/72/EC për energjinë, 2009.

Kriteret e monitorimit dhe raportimi

- Raportet vjetore 2021-2022 të ERE.
- Raportet vjetore të KESH SHA.
- Raportet vjetore të OST SHA.
- Raportime të OSHEE SHA.

Kriteret teknike

- Ligji nr. 129/2014 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- Ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”.
- Ligji nr. 124/2015 “Për eficientësin e energjisë”.
- VKM nr. 519, datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.
- VKM nr.244, datë 30.03.2016 “kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.
- VKM nr. 620, datë 22.10.2021, i ndryshuar "për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimit të saj.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022 Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.
- Vendime të ERE-s mbi tarifat e energjisë elektrike.
- Rregullore mbi shkarkimin e plotave në hidrocentralet e lumit Drin.
- Statuti i shoqërive.
- Rregullore të brendshme të shoqërive.

2.2.1. Praktikrat më të mira¹³

Danimarka pioniere në energjinë e pastër!

Danimarka është vendi që tejkalon çdo vend të OECD për përdorim të energjisë së pastër dhe të rinovueshme duke qenë vend lider për banor krahasuar me vendet e OECD, gjithashtu bioenergja luan një rol të rëndësishëm në sistemin energjetik Danez.

Danimarka përdor rreth 50% të energjisë të prodhuar nga era dhe energjia diellore. Danimarka prodhon pothuajse dy herë më shumë energji të erës për banor sesa vendi i dytë midis vendeve të industrializuara në OECD.

Por energjia e erës nuk është burimi më i përdorur i energjisë së rinovueshme në këtë vend, pasi bioenergja renditet e para duke u ndjekur nga era, dielli dhe energjia gjeotermale.

Bioenergja nga bujqësia.

Më shumë se dy të tretat e energjisë së rinovueshme të Danimarkës vjen nga bioenergja, e cila është energjia e ruajtur në materiale organike ose në biomasë. Bujqësia është një biznes i madh në Danimarkë dhe në mënyrë indirekte ndihmon gjithashtu në sigurimin e energjisë, me pleh organik,

¹³ <https://denmark.dk/innovation-and-design/clean-energy>



yndyrna shtazore dhe kashtë që përdoren si bazë për biogazin dhe biokarburantet e lëngëta.

Teknologjia e erës për eksport

Novatorët kryesorë në botë për energjinë e erës janë kompanitë Daneze Vestas dhe Siemens Gamesa. Këto dy kompani në vitin 2018, kishin një të tretën e tregut botëror të instalimeve të turbinave me erë. MHI Vestas – është një sipërmarrje e përbashkët midis Vestas dhe kompanisë japoneze Mitsubishi Heavy Industries - aktualisht kanë prodhuar turbinën më të fuqishme në botë me 9.5 MW.

Pionier në biznesin e erës

Danimarka filloi të përdor energjinë e erës pas krizës së naftës të vitit 1973. Një industri e sapolindur turbinash me erë u shfaq si një "spin-off" i prodhimit të makinerive bujqësore dhe turbina e parë komerciale me erë u ngrit në 1979. Suksesi i energjisë së erës në tokë frymëzoi zhvillimin e energjisë së erës në det të hapur.

Me një kapacitet total prej 407 MW, 49 turbinat me erë mbulojnë konsumin vjetor të energjisë elektrike të rreth 425,000 familjeve daneze.

Energjia nga Dielli dhe Toka

Energjia diellore është një tjetër burim i energjisë së rinovueshme në Danimarkë. Panelet diellore përdoren për ngrohjen e ndërtesave dhe prodhimin e ngrohjes qendrore. Përveç kësaj, Danimarka ka tre objekte të energjisë gjeotermale në funksion, dhe nxehtësia gjeotermale përdoret për ngrohje qendrore.

2.3. Rëndësia e produkteve të subjektit

Sistemi elektroenergjitik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga:

Prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, tregtimi me qëllim furnizimin e klientëve të energjisë elektrike.

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH sh.a., si dhe nga subjektet private të licencuara në këtë aktivitet si: Prodhuesit me përparësi, prodhuesit e pavarur dhe vet prodhuesit e energjisë elektrike.

Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore.

Aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, pas ndarjes së Shoqërisë OSHEE, i ka kaluar shoqërisë së OSSH Sh.a. Ndërsa atë të furnizimit dhe detyrimin e shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike i ka kaluar shoqërisë FSHU Sh.a dhe për tregtimin e energjisë elektrike e mbanë shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë – FTL Sh.a.

2.4. Pesha në Buxhet dhe PBB

Në tabelat nr.2, 3, 4 pasqyrohen treguesit kryesor të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike.

Të ardhura e këtyre shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike sigurohen nga vetë ato gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Në tabelën nr. 2 pasqyrohet ecuria e të ardhurave përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe pesha që ato zënë në % kundrejt PBB në vend.

Burimet e të ardhurave nga OSHEE Grup realizohen nga shitja e energjisë, të ardhura nga kamat vonesat, nga shpërndarja e energjisë, etj.

Tabela nr.2. Buxheti dhe pesha në PBB e OSHEE - Grup

OSHEE Grup	2018	2019	2020	2021
Të Ardhura (+ Taksa Korporative 15%) (Mln. Lekë)	65,096	68,090	68,905	73,805
% në PBB	3.46%	3.50%	3.70%	4.21%

Burimi: OSHEE përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH



Në tabelën nr.3 pasqyrohen të dhëna të përgjithshme të buxhetit të OST për vitin 2019, 2020 dhe 2021.

Të ardhurat nga OST, realizohen nga transmetimi i energjisë elektrike për OSHEE-në dhe furnizuesit e kualifikuar, alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, etj.

Shpenzimet përfshijnë: shpenzimet për blerjen e humbjeve; disbalancat, shpenzimet për personelin; shpenzime mirëmbajtje riparime, shpenzime materiale, shpenzime të tjera, pagesat për organizmat rajonal; detyrimet për huat afatgjata. Investimet realizohen me fondet e veta dhe huat.

Tabela nr.3. Buxheti dhe pesha në PBB e OST

Buxheti		2019	2020	2021
Te ardhura Op	Milion Lekë	7,121	7,018	8,922
Shpenzime Op	"	6,489	5,581	7,942
Kosto transmetimi	"	1,368	1,174	2,837
Kosto te tjera pa amortizim	"	2,109	1,891	2,139
Investime	"	1,798	2,210	2,882
Buxhet (Invest+Opex)	"	8,287	7,791	10,824
Buxhet/GDP	%	0.49%	0.48%	0.61%
Ardhura/GDP	%	0.42%	0.43%	0.50%
Shpenzime/GDP	%	0.38%	0.35%	0.45%
Kosto Transmetimi/GDP	%	0.081%	0.073%	0.160%

Burimi: OST përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

Të dhënat mbi buxhetin e KESH për vitet 2019, 2020 dhe 2021 pasqyrohen në tabelën nr.4.

Të ardhurat e KESH realizohen nga veprimtaria kryesore e kompanisë që është prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike në tregun e rregulluar, të parregulluar dhe tregun e lire për optimizmin energjisë elektrike. Shpenzimet përfshijnë: shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike; shpenzimet për personelin; detyrimet për huat, etj. Investimet realizohen me fondet e veta dhe hua.

Tabela nr.4. Buxheti dhe pesha në PBB e KESH

Buxheti		2019	2020	2021
Te ardhura	Mln Lekë	9,376	11,191	18,596
Shpenzime Op	"	6,461	9,318	9,896
Investime	"	1,480	441	2,935
Buxhet (Invest+Opex)	"	7,942	9,759	12,831
Buxhet/GDP	%	0.47%	0.60%	0.73%
Ardhura/GDP	%	0.55%	0.69%	1.05%
Shpenzime/GDP	%	0.38%	0.58%	0.56%

Burimi: KESH përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH



2.5. Përkufizimet dhe terminologjia

Shoqëri Aksionare: Formë organizimi e biznesit që formohet me bashkimin e kapitaleve individuale duke krijuar kapitalin aksionar, por që sipas Ligjit mund të themelohet edhe nga një person i vetëm fizik dhe/ose juridik.

Shoqëri Publike: Shoqëritë Publike themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj.

Aktivite të energjisë elektrike: Janë aktivitetet ekonomike që lidhen me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike, si dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Balancim: Tërësia e proceseve, nëpërmjet të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të përcaktuar të qëndrueshmërisë së tij.

Burime të rinovueshme të energjisë janë burimet e rinovueshme jofosile të energjisë, si era, energjia diellore, energjia aerotermale, energjia gjeotermale, energjia hidrotermale dhe oqeanike, energjia hidrike, biomasa, gazi i përfutur prej vend grososjes së mbetjeve, gazi i përfutur prej impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së rinovueshme.6. "Burim rezervë" është një burim dytësor i furnizimit me energji elektrike, që nuk është i lidhur me sistemin elektroenergjetik.

Operimi i tregut: është veprimtaria që kryen operatori i tregut për organizimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë dhe të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë.

Certifikim: është procedura, e cila përcakton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si një parakusht për përcaktimin dhe miratimin e këtij operatori.


Detyrimi i shërbimit publik: është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari përkryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, eficientë të energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

Furnizues i mundësisë së fundit: është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.

Operimi i tregut: është veprimtaria që kryen operatori i tregut për organizimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë dhe të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë.

Shoqëri elektroenergjetike: është një person fizik ose juridik që kryen të paktën një nga veprimtaritë: prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim ose blerje të energjisë elektrike, i cili është përgjegjës për detyrimet tregtare, teknike ose të mirëmbajtjes, lidhur me këto veprimtari, pa përfshirë klientët fundorë.

2.6. Skema e analizës së programit





2.7. Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit

Pas njohjes se programit të auditimit subjektet e përfshira nën auditim, gjatë fazës së terrenit u treguan të gatshëm dhe bashkëpunues me grupin e auditimit, duke u përgjigjur në kohë intervistave, pyetësorëve dhe duke përcjell evidencën dokumentare të plotë dhe në kohë. Gjatë kësaj faze që përkon dhe me hartimin e Projekt Raportit subjektet kanë treguar interes dhe kanë përcjell edhe analiza dhe dokumentacion shtesë në lidhje me objektin e këtij auditimi.

Grupi i auditimit në fund të fazës së terrenit vlerëson stafet përkatëse të subjekteve nën auditim për gatishmërinë dhe përcjelljen në kohë të evidencës mbështetëse dokumentare në lidhje me pyetjet e parashtruara në piramidën e pyetjeve.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1. Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e aktivitetit të subjektit janë ato me të cilat përballen shoqëritë publike KESH, OST dhe OSHEE në lidhje me realizimin e përgjegjësi të tyre që lindin nga aktiviteti në tërësi, duke u fokusuar në marrëveshjet dhe rakordimet për detyrimet e ndërsjella. Sektori elektro-energetik, si një nga sektorët më tërheqës dhe që sjell të ardhura mjaft të mëdha për kompanitë që operojnë në këtë fushë, mbart me vete një sërë problematikash, ku midis më kryesoreve është edhe shlyerja e detyrimeve në përgjithësi dhe atyre të ndërsjella në veçanti, si dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e rritje së tyre në të ardhmen dhe likuidimin gradual deri në eliminimin e tyre.

Analiza SWOT e sistemit elektroenergetik

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT të Sistemit Elektroenergetik, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Tabela nr. 5. Analiza SWOT

Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
Ristrukturimi organizativ i shoqërive publike të sektorit elektro energjetik.	Detyrimet e mbartura ndër vite midis shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike.
Alternativat e financimit të detyrimeve të mbartura për pastrimin e llogarive kontabël, nëpërmjet Net-imit të tyre.	Mungesë likuiditeti financiar afatgjatë, të shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike. Mungesë e gjurmës së auditit dhe e kontrollit të brendshëm për menjanimin e ngjarjeve me risk të lartë në KESH.
Injektimi nga qeveria, i parave në sistemin elektroenergetik, nëpërmjet instrumenteve të ndryshëm financiar, për të përballuar rritjen e çmimeve të energjisë elektrike të importuar.	Niveli i lartë i humbjeve të energjisë në sektorin e shpërndarjes. Mungesë në strukturën e shoqërive, të sektorit të studimit të tregut, për optimizmin e shpenzimeve për transaksionet e shit-blerjes. Mungesa e sistemit SCADA të përqendruar në KESH.
Stafi kualifikuar dhe me eksperiencë në shoqëritë e sistemit elektroenergetik shqiptar.	Mungesa e certifikimit me standardin ISO 27001 për sigurinë e informacionit në sektorin elektroenergetik.
Investime të larta në sigurinë e digave në kaskadën e lumit Drin.	Sistemi i matjes pa matësa inteligjent për konsumatorin fundor. Borxhi i lartë i debitorëve buxhetore kundrejt OSHEE Grup. Mungesa e operimit të Bursës shqiptare të energjisë elektrike.
Shanset (O)	Kërcënimet (T)



Kuadri ligjor për sektorin energjetik në përputhje me direktivat e BE.	Rritja e Çmimit të energjisë elektrike në bursë.
Mundësi diversifikimi i portofolit gjenerues.	Risku hidrologjik në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike.
Mbështetje me hua nga Banka vendase dhe të huaja për financimin e sektorit të energjisë elektrike.	Rritja e frekuencës së sulmeve kibernetike mbi infrastrukturën kritike të shoqërive publike në sektorin e energjisë elektrike.
Zhvillimi kombëtar dhe rajonal i transmetimit të energjisë elektrike në përputhje me direktivat ENTSO-e .	

Burimi: Grupi i auditimit KLSH

Kategorizimi i riskut në strategjik, financiar, juridik, operacional.

Risqet janë kategorizuar në strategjik, financiar, juridik dhe operacional, të ndarë sipas ambientit të kontrollit menaxherial, risqet brenda kontrollit menaxherial janë përfshirë tek Fuqitë & Dobësitë dhe ato jashtë kontrollit menaxherial janë përfshirë tek "Shanset & Kërcënimet".

Tabela nr. 6 Kategorizimi i riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Forma (Struktura) e Financimit	Risk Strategjik	I Lartë
2	Prioritizimi i investimeve		I Mesëm
3	Risku i biznesit	Risk Financiar	I Lartë
5	Risku Operacional		I Lartë
6	Risku i Kreditimit		I Mesëm
7	Risku i Tregut		I Mesëm
8	Risku i likuiditeteve		I Mesëm
9	Mosrespektimi i kontratave dhe detyrimeve të ndërsjella të shoqërive publike në sektorin e energjisë elektrike	Risk Rregullator dhe Juridik	I Mesëm
10	Risku hidrologjik	Risk Operacional	I Lartë
11	Niveli i lartë i humbje në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike		I Lartë

Burimi: Grupi i auditimit KLSH

3.2. Objektivat e auditimit

Vlerësimi i performancës së veprimtarisë së shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike përgjatë periudhës 2021 dhe 6-mujorit të parë të 2022, e cila përkon me krizën globale në fushën e energjisë dhe që ka impaktuar edhe vendin tonë.

Nëpërmjet vlerësimit të performancës së këtyre shoqërive dhe në veçanti të administrimit të rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, grupi i auditimit në përfundim të fazës së terrenit do të paraqes problematikat kryesore dhe do të rekomandoj masa të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre shoqërive brenda objektit të këtij auditimi.



3.3. Pyetjet e auditimit

Pyetja kryesore:

A ka qënë efciente veprimtaria e shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike, për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike dhe përballimin e krizës energjetike përgjatë periudhës së vitit 2021 deri në muajin Maj 2022?


Pyetjet e nivelit të parë:

1. A ka qënë efciente veprimtaria e KESH në lidhje me administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin?
2. A ka qënë efektive veprimtaria e KESH për diversifikimin e portofolit të asetëve gjeneruese?
3. A kanë qënë efektive masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe OSHEE Grup, KESH, OST për përballimin e krizës energjetike përgjatë vitit 2021-2022?
4. A janë përmbushur detyrimet ligjore të modelit të tregut të energjisë elektrike?

Pyetjet e nivelit të dytë:

- 1.1. Cilat janë hapat e ndërmarra nga KESH për implementimin e sistemit SCADA në rezervën hidrike të kaskadës në lumin Drin?
- 1.2. A ka qënë efektive veprimtaria e KESH në lidhje me menaxhimin e tepricës së energjisë elektrike dhe optimizimit të kostove të blerjes së saj?
 - 2.1. A ka ndikuar në uljen e kostove të prodhimit të energjisë elektrike vendosja e burimeve alternative nga KESH?
 - 3.1. A janë optimizuar shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar përgjatë vitit 2021 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2022 nga shoqëritë OSHEE, OST dhe KESH?
 - 3.2. A janë ndërmarrë masa dhe procedura efektive për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sistemit energjetik?
 - 4.1. A ka qënë efektive veprimtaria e ERE për periudhën 2021-Maj 2022 për sektorin e energjisë elektrike?
 - 4.2. A janë përmbushur detyrimet ligjore të sigurisë kibernetike nga shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike?

A ka qënë efciente veprimtaria e shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike, për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike dhe përballimin e krizës energjitike përgjatë periudhës së vitit 2021 deri në 6 mujorin e parë 2022?



3.4. Kriteret audituese

PYETJA KRYESORE	A ka qënë efciente veprimtaria e shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike, për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike dhe përballimin e krizës energjetike përgjatë periudhës së vitit 2021 deri në 6 mujorin e parë 2022?	
Pyetjet auditueses	Kriteret Audituese	Referenca e kritereve
NIVELI I PARË 1. A ka qënë efciente veprimtaria e KESH në lidhje me administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin?	Rregullorja e shkarkimit të plotave miratuar me Vendim nr. 187, date 15.01.1988.	Germa I
2. A ka qënë efektive veprimtaria e KESH për diversifikimin e portofolit të asetëve gjeneruese?	Strategjia Kombëtare e Energjisë, 2018-2030. Ligji nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.	
3. A kanë qënë efektive masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe OSHEE, KESH, OST për përballimin e krizës energjetike përgjatë vitit 2021-2022?	Vkm 620 date 22.10.2021., i ndryshuar; Vkm nr 757, date 9.12.2021.,.	Kreu 4 4, pika 1 dhe 2.; kreu 8, pika 1 dhe 2. Kreu 1, pika 1a.
4. A janë përmbushur detyrimet ligjore të modelit të tregut të energjisë elektrike?	Vendimi i ERE nr.214, date 28.12.2017 “Për miratimin e Rregullave të tregut Shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në bursën Shqiptare të energjisë”.	Vendimi Nr. 139, datë 15.08.2016 i ERE
NIVELI I DYTË 1.1. Cilat janë hapat e ndërmarra nga KESH për implementimin e sistemit SCADA në rezervën hidrike të kaskadës në lumin Drin?	Ligj nr. 87/2015 për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin “energji ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit”.	
1.2. A ka qënë efektive veprimtaria e KESH në lidhje me menaxhimin e tepicës së energjisë elektrike dhe optimizimit të kostove të blerjes së saj?	Rregullores nr. prot 2762/8, 06.06.2018 “Mbi miratimin e Rregullores së Tregtimit të Energjisë Elektrike nga KESH sh.a.”	Kreut 5, pika 1.
2.1. A ka ndikuar në uljen e kostove të prodhimit të energjisë elektrike vendosja e burimeve alternative nga KESH?		
3.1 A janë optimizuar shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar përgjatë vitit 2021 dhe 6 mujorit të parë 2022 nga shoqëritë OSHEE, OST dhe KESH?	Rregullorja e Tregtimit të Energjisë Elektrike nr. 2762/8, date 06.06.2018 për KESH-in. FTL dhe OST në baze të Vendimit të ERE 103.	
3.2. A janë ndërmarrë masa dhe procedura efektive për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sistemit energjetik?	Ligji 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.	



4.1 A ka qene efektive veprimtaria e ERE për periudhën 2021-Maj 2022 për sektorin e energjisë elektrike?		
4.2. A janë përmbushur detyrimet ligjore të sigurisë kibernetike nga shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike?	ligjin 2/2017 për sigurinë kibernetike dhe Vendimit nr.126 të ERE. Urdhri nr.22, datë 26.04.2018 të AKCESK.	

Burimi: Grupi i KLSH

3.5. Qasja e auditimit

Grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit, bazuar në dokumentacionin e grumbulluar dhe të analizuar, të dhënat e kërkuara dhe të plotësuara nga subjektet nën auditim, komunikimet me stafin, pasqyrimin në media të këtij aktiviteti, si dhe në praktikatat e mira të vendeve të BE-së në këtë fushë, pati një qasje audituese pragmatiste, pra një miks i qasjes sasiore dhe cilësore.

Paradigma kryesore e auditimit është:

“Sektori i energjisë elektrike si një sektor i rëndësishëm së veçantë për sigurinë kombëtare duhet të diversifikoi asetet gjeneruese me kosto eficiente duke ruajtur ekuilibrin mjedisor dhe garantuar qëndrueshmërinë e sistemit dhe furnizimin e pandërprerë të tregut të energjisë elektrike në vend”.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NENPYETJEVE

A ka qënë efiçente veprimtaria e shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike, për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike dhe përballimin e krizës energjetike përgjatë periudhës së vitit 2021 deri në 6 mujorin e parë 2022?

Për sa më lart, pas auditimit, trajtimit të observacioneve, KLSH i qëndron mesazhit auditues se:

Kriza globale energjetike u shoqërua me rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi dhe me mungesë të likuiditeteve financiare të shoqërive të sistemit elektroenergjetik shqiptar, duke vështirësuar garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike.

Keqmenaxhimi i kaskadës së Drinit, solli si pasojë rënien e rezervës hidroenergjetike në liqenin e Fierzës dhe rritjen e kërkesës për import të energjisë elektrike, në një periudhë që përkon me çmime shumë të larta të energjisë elektrike në bursë.

Ndodhur në këto kushte, Qeveria Shqiptare, injektoi nëpërmjet instrumenteve financiarë 165 milion euro dhe 20 miliard lekë, që sistemi elektroenergjetik të mos kalonte në kolaps.

Vlera e importit të energjisë elektrike për 6 mujorin e parë të 2022, u rrit me 156% krahasuar me vlerën e këtyre importeve për vitin 2021.

Shpenzimet për blerjen e energjisë nga importi për vitin 2021 dhe 6 mujorin e parë 2022, arritën vlerën **659,982,839 euro**.

Strategjitë e ndjekura nga sistemi për diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike, kanë rezultuar deri tani jo eficient, duke sjellë ekspozimin e përhershëm të sistemit elektroenergjetik kundrejt riskut meteorologjik. Kjo si pasojë, ka sjellë rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi me çmime të larta.

KESH përveç disa nismave fillestare në investime për burime foto volta-ike (PV), është larg realizimit të objektivave strategjike, për diversifikimin e portofolit gjenerues, me energji të rinovueshme.

Një nga sfidat e tjera të sistemit, ngelet niveli i lartë i humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike, e vlerësuar 21%¹⁴ për 2021 dhe 20% në 2022.

¹⁴ Të dhënat sipas ERE “Raporti 2021 dhe 9 mujori i parë 2022



Niveli i lartë i humbjeve, është pasojë e investimeve të pamjaftueshme në infrastrukturën e sistemit të shpërndarjes dhe mos implementimit¹⁵ të sistemit inteligjent të matjes¹⁶.

Siguria kibernetike, gjithashtu mbetet një çështje sensitive, në kushtet kur sistemi elektroenergetik është i klasifikuar, si infrastrukturë kritike e rëndësisë së veçantë për sigurinë kombëtare.

Garantimi i sistemeve të informacionit dhe ruajtja e të dhënave korporative, kërkon që shoqëritë e sektorit elektroenergetik, të certifikohen me standardin ISO 27001.

Krahas masave të marra për përballimin e krizës së energjisë elektrike, Qeveria Shqiptare duhet të gjejë zgjidhje të qëndrueshme dhe eficiente për vënien në funksion të TEC-it të Vlorës, si dhe fillimin e operimit të bursës shqiptare të energjisë, për ta bërë të plotë modelin e tregut të energjisë.

4.1. A ka qënë efciente veprimtaria e KESH në lidhje me administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin?


Rregullorja¹⁷ mbi shkarkimin e plotave ka përcaktuar kuotat maksimale të lejuara për HEC-et e kaskadës së lumit Drin.

Në rregullore kuotat maksimale të lejuara sipas muajve për liqenin e Fierzës janë:

- Në Janar, Shkurt niveli maksimal i lejuar është 290 m mbi nivelin e detit;
- Në Mars niveli maksimal i lejuar është 292 m mbi nivelin e detit;
- Në Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator niveli maksimal i lejuar është 296 m.m.n.d;
- Në Tetor, Nëntor, Dhjetor niveli maksimal i lejuar është 260 m mbi nivelin e detit.

Kuotat maksimale të lejuara për Liqenin e Fierzën paraqiten në grafikun nr.1

Grafiku nr.1. Kuotat maksimale të lejuara në Liqenin e Fierzës



Burimi: KESH

Nga auditimi rezulton se:

Nivelet minimale të lejuara në liqenin të Fierzës sipas muajve për periudhën kohore 01.01.2020-31.12.2021, janë përcaktuar në kontratën¹⁸ tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe furnizuesit të shërbimit universal (FSHU) SH.A., për furnizimin e klientëve fundor.

¹⁵ OSSH brenda vitit 2025 duhet të implemetoj sistemin inteligjent te matjes

¹⁶ Pika 2 dhe 3 neni 78 Sistemet matëse inteligjente të Ligjit 43/2015 për sektorin e energjisë elektrike

¹⁷ Miratuar, më datë 15.01.1988

¹⁸ Nr.2920/1 Prot., datë 24.09.2020; miratuar me vendimin ERE nr.04., date datë 15.01.2021



Në shtojcën nr.3 të kontratës parashikohet niveli minimal i lejuar për liqenin e Fierzës për vitin 2021, të paraqitura në tabelën nr.7

Tabela nr.7 Parashikimi i nivelit minimal të Liqenit të Fierzës për vitin 2021 (m.m.n.d)

Treguesit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Niveli I Fierzës (ne fund te muajit)	271	274	282	291	294	295	289	279	276	272	269	270

Burimi: KESH

Tabelat e mëposhtme, pasqyrojnë ecurinë e treguesve kryesor të rezervës hidroenergjetike, të kaskadës së lumit Drin.

Mbi bazën e të cilave grupi i auditimit, kryqëzoi të dhënat e marra nga subjektet nën auditim, për të arritur në konkluzion mbi menaxhimin e rezervës hidroenergjetike.

Grupi i auditimit, u përqendrua kryesisht në transaksionet e kryera në periudhën Qershor-Tetor 2021 dhe Mars 2022.

Niveli i rezervës hidroenergjetike në kaskadën e lumit Drin 2021-2022

Fillimi i vitit 2021 rezultoi me prurje të larta duke rritur nivelin e rezervës hidroenergjetike.

Në Janar prurjet ishin 694 m³/s, në Shkurt 502 m³/s, në Mars 264 m³/s, në Prill 304 m³/s dhe në Maj 297 m³/s, duke rezultuar më të lartat për periudhën 2018-2021.

Në tabelën nr. 8. pasqyrohen prurjet në HEC-t e kaskadës së Drinit.

Tabela nr. 8. Prurjet në kaskadën e lumit Drin (m³/s)

Viti	Prurjet (m ³ /s)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2021	Fierze	694	502	264	304	297	103	71	62	67	65	85	282
	Koman	319	232	87	105	146	100	48	25	22	23	63	198
	Vau I dejes	165	116	20	20	19	8	8	7	8	7	19	43
2022	Fierze	146	116	104	355	204							
	Koman	74	77	46	189	113							
	Vau I dejes	10	17	9	33	11							

Burimi: KESH, përpunimi i të dhënave nga grupi i auditimit te KLSH

Si rrjedh e prurjeve të larta, niveli i liqenit të Fierzës në fund të muajt Maj 2021, kapi kuotën maksimale, duke arritur në 296.65 m.m.n.d. Si pasojë e operacioneve të kryera nga KESH në periudhën Qershor – Tetor, niveli i liqenit të Fierzës filloj të zbres ndjeshëm nën nivelin minimal të lejuar.

Niveli i rezervës hidroenergjetike në Liqenin e Fierzës në Tetor zbriti me 29 m krahasuar me nivelin në muajin Maj, duke zbritur në kuotën 296.65 m.m.n.d. Në tabelën nr.9 paraqiten të dhëna mbi nivelin e HEC-ve në kaskadën e Drinit për periudhën objekt auditimi.

Tabela nr. 9. Niveli i rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin (m.m.n.d)

Viti	HEC	Niveli I ujit (m)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2021	Fierza	Në fillim te muajit	272.20	291.67	294.08	292.57	294.33	296.65	291.69	282.65	274.27	271.34	267.74	267.77
		Në fund te muajit	291.67	294.08	292.57	294.33	296.65	291.69	282.65	274.27	271.34	267.74	267.77	275.13
	Koman	171.76	172.19	171.40	172.87	172.54	173.00	172.86	173.18	173.61	171.75	170.45	172.37	
	Vau I dejes	73.38	74.17	74.05	74.19	73.89	73.67	73.89	73.79	73.73	73.42	73.79	74.83	
2022	Fierza	Në fillim te muajit	275.13	270.68	268.28	260.67	282.51							
		Në fund te muajit	270.68	268.28	260.67	282.51	288.99							
	Koman	173.05	172.95	172.85	171.65	171.47								
	Vau I dejes	73.88	73.88	73.78	73.89	73.44								

Burimi: KESH, përpunimi i të dhënave nga grupi i auditimit te KLSH



Në grafikun nr.2., paraqiten vlerat e rezervës hidroenergjetike maksimale, minimale të lejuara dhe ato të arritura në HEC-in e Fierzës në vitin 2021.


Kurba me ngjyrë gri, që përfaqëson nivelin e Fierzës në 2021, qëndron poshtë vlerave minimale të lejuar për periudhën Qershor-Nëntor.

Kjo tregon që niveli i Fierzës në këtë periudhë ka rënë poshtë vlerave minimale të lejuara.

Në muajin nëntor¹⁹ prurjet në liqenin e Fierzës u rritën me 20 m³/s krahasuar me muajin e mëparshëm, duke ndikuar në rritjen e nivelit të liqenit të Fierzës. Në këtë muaj liqeni i Fierzës kapi nivelin minimal të lejuar, grafikisht tregohet në prerjen e kurbës me ngjyrë blu dhe gri.

Në muajin Dhjetor si rezultat i rritjes së prurjeve të cilat shkuan në 282 m³/s, niveli i liqenit të Fierzës shkoj në 275.13 m.m.n.d, duke rritur rezervën energjetike në 624 GWh, rezervë kjo e përafërt me rezervën e dhjetorit të 2019²⁰ e cila rezulton më e larta për periudhën 2019-2021.

Grafiku nr.2. Niveli minimal, maksimal i lejuar dhe kuota e liqenit të Fierzës në 2021



Burimi: KESH, përpunimi nga grupi i KLSH

Rezerva energjetike në liqenin e Fierzës 2021-2022

Si rezultat i rënies së nivelit të liqenit të Fierzës në periudhën Qershor -Tetor 2021, referuar tabelës nr.10., rezerva hidroenergjetike zbriti nga 1,422 GWh në 444 GWh, dhe në Mars 2022 zbriti në 304 GWh.

Tabela nr. 10. Rezerva energjetike në liqenin e Fierzës. (GWh)

Viti	Rezerva Energjetike	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2021	Fillim muaji	548	1,193	1,300	1,232	1,311	1,422	1,194	850	601	527	444	445
	Fund muaji	1,193	1,300	1,232	1,311	1,422	1,194	850	601	527	444	445	624
2022	Fillim muaji	624	511	456	304	845	1,082						
	Fund muaji	511	456	304	845	1,082							

Burimi: KESH, përpunimi i te dhënave nga grupi i auditimit te KLSH

Sasia e prodhuar në HEC-et e kaskadës së Lumit Drin 2021-2022

HEC-et e kaskadës së lumit Drin, në vitin 2021 kanë prodhuar 5,392,709 MWh energji elektrike. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2021 është 173% më shumë se prodhimi i vitit 2020; 179% më shumë se prodhimi i 2019 dhe pothuajse i barabartë me prodhimin e vitit 2018.

Në tabelën nr.11., pasqyrohen të dhëna mbi sasinë e prodhuar në tre HEC-et e kaskadës së lumit Drin dhe sasia e matur në hyrje të Nst.TL.

¹⁹ Prurjet ne muajin nentor ishin 85 m³/s

²⁰ Ne muajin dhjetor 2019 rezerva energjetike ne liqenin e fierzes ishte 636 GWh



Diferenca prej 41,402 MWh midis prodhimit bruto nga HEC-et e kaskadës së Drinit dhe sasisë hyrje në sistemin e transmetimit të tensionit të lartë, kjo sasi energjie elektrike sipas KESH përfaqëson humbjet teknike të ndodhura gjatë transformimit të energjisë elektrike nga transformatorët e TL të këtyre HEC-ve.

Kjo humbje përfaqëson 0.77% të sasisë totale të prodhuar nga këto HEC-et.

Tabela nr.11. Humbjet teknike të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-t e KESH

Viti 2021	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total	Humbje teknike
Prodhim Bruto-HEC-t kasakada e Drinit	654,126	657,343	595,205	525,895	557,951	486,553	496,980	358,486	201,332	203,171	197,964	457,703	5,392,709	0.77%
Prodhim Bruto -Matje OST	648,907	652,202	590,705	521,886	553,680	482,891	493,297	355,805	199,808	201,638	196,427	454,060	5,351,307	

Burimi: KESH, përpunimi i te dhënave nga grupi i auditimit te KLSH

Referuar tabelës 12., rezulton se:

Në Maj 2021., HEC-i i Fierzës ka prodhuar 182,880 MWh energji elektrike, me një regjim pune sa ½ e kapacitetit gjenerues, pra me 2 turbina.

Në Tetor 2021., HEC-i i Fierzës ka prodhuar 71,414 MWh, me një prodhim ditor prej 3,000 MWh, çka do të thotë që ka punuar afërsisht 24 ditë duke shfrytëzuar vetëm 1 (një) turbinë.

Në Prill 2022 HEC-i i Fierzës ka prodhuar 4,315 MWh, me një prodhim ditor prej 3,000 MWh., që nënkupton që ka punuar një turbinë për 1.4 ditë.

Tabela nr. 12. Sasia e prodhuar në HEC-et e kaskadës së Lumit Drin. (MWh)

Viti	Sasia e prodhuar	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2021	Fierze	171,946	218,723	231,110	189,386	182,880	176,827	195,131	140,221	68,851	71,414	48,449	108,536
	Koman	349,009	313,912	239,703	222,722	249,885	210,179	203,515	148,836	90,347	88,284	99,545	224,013
	Vau I dejes	133,171	124,708	124,391	113,787	125,187	99,546	98,335	69,428	42,134	43,473	49,970	125,153
2022	Fierze	138,609	83,640	112,958	4,315	46,745							
	Koman	186,628	133,421	172,784	115,364	110,612							
	Vau I dejes	93,471	68,538	84,921	67,516	51,446							

Burimi: KESH, përpunimi i te dhënave nga grupi i auditimit te KLSH

Shtojca nr.1 e kontratës²¹ tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH-it dhe furnizuesit të shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve fundor për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, parashikon prodhimin e energjisë elektrike në kaskadën e Drinit, siç paraqitet në tabelën nr.13.

Tabela nr. 13. Parashikimi i Prodhimit në Kaskadën e Drinit për vitin 2021

Treguesit	Njesia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
Gjenerimi KESH	MWh	400,000	365,000	324,000	265,000	260,000	299,000	365,000	380,000	254,000	295,000	355,000	388,000	3,950,000

Burimi: KESH, FSHU

KESH për muajin Maj, i ka shitur FSHU sasinë 317,077 MWh, duke tejkaluar me 57,077 MWh sasinë e parashikuar në kontratë.

Në muajin Tetor, KESH duhej të prodhonte të paktën 295,000 MWh për nevojat e FSHU;

Për shkak të nivelit të ulët të rezervës hidroenergjetike, KESH ka prodhuar 203,171 MWh në Tetor dhe i ka shitur FSHU sasinë 201,206 MWh energji elektrike;

Diferenca prej 1,965 MWh midis sasisë prodhuar dhe asaj të shitur FSHU është përdorur nga KESH në formën e shkëmbimeve apo procedurave për optimizim;

²¹ nr. 2920/1 prot., datë 24.09.2020



Tabela nr. 14. Sasia e shitur nga KESH për FSHU (MWh)

Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2021	446,713	377,581	450,324	327,395	317,077	401,948	467,469	323,244	182,473	201,206	199,094	450,180
2022	549,601	499,472	547,602	212,895	262,454							

Burimi: KESH, përpunimi i te dhënave nga grupi i auditimit te KLSH

Importi i energjisë elektrike nga FTL për FSHU

Për plotësimin e nevojave të FSHU shoqëria FTL siguron sasinë e nevojshme për furnizuesin e shërbimit universal nëpërmjet sasisë së prodhuar nga BRE dhe sasisë të kontraktuar me KESH dhe pjesën e pa mbuluar e importon nëpërmjet procedurave të prokurimit.

FTL për muajin Maj 2021 ka siguruar energji nëpërmjet burimeve të ndryshme të pasqyruara në tabelën nr.15 me sasinë totale 599,932 MWh për nevojat e FSHU dhe mbulimin e humbjeve të OSSH. Në Maj shoqëria FTL ka blerë në tregun e parregulluar sasinë 1,488 MWh dhe në Tetor 258,470 MWh.

Tabela nr. 15. Burimet e furnizimit me energji elektrik për FSHU

Burimet e Blerjes 2021	Njesia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Shuma
Energji e Blere nga Fotovoltaike	MWh	1,734	2,488	3,779	3,708	4,674	4,737	4,844	4,588	3,754	3,024	1,615	1,812	40,756
Energji e Blere nga HEC-et ne Shperndarje	MWh	123,027	127,093	106,488	137,509	115,240	51,402	21,139	12,333	11,620	32,580	37,145	129,655	905,232
Energji e Blere nga HEC-et ne transmetim	MWh	147,262	137,659	98,116	147,878	130,049	51,266	18,998	7,102	8,576	24,808	36,489	143,303	951,506
Energji e Blere nga HEC- Ashta	MWh	36,275	33,478	31,720	28,965	31,404	24,725	23,679	16,911	11,127	11,902	13,509	31,550	295,245
Energji e Blere nga Import	MWh	1,488	1,344	1,486	1,440	1,488	1,440	58,577	245,448	271,448	258,470	278,673	10,120	1,131,422
Energji e Blere nga KESH	MWh	446,713	377,581	450,324	327,395	317,077	401,948	467,469	323,244	182,473	201,206	199,094	450,180	4,144,704
Total		756,500	679,644	691,912	646,895	599,932	535,518	594,706	609,626	488,998	531,990	566,524	766,621	7,468,865

Burimi: FTL, përpunimi i te dhënave nga grupi i auditimit te KLSH

Gjetje:

Për sa më lart,

- Në fund të muajit Maj 2021 liqeni i Fierzës kishte një kuote maksimale prej 296.65 m.m.n.d. Niveli i liqenit në këtë periudhë ishte brenda vlerave të lejuara maksimale dhe mbi mesataren disa vjeçare. Niveli i lartë i arritur në 6 mujorin e parë të 2021 përbente një siguri për të menaxhuar dhe shfrytëzuar sipas kushteve optimale kaskadën e lumit Drin edhe për 6 mujorin e dytë të vitit 2021.
- Niveli i rezervës hidroenergjetike në Liqenin e Fierzës në Tetor 2021 zbriti me 29 m krahasuar me atë të muajt Maj. Në Tetor niveli zbriti në kuotën 267.74 m.m.n.d.
- Rënia e nivelit të Fierzës ka vijuar edhe përgjatë vitit 2022 duke arritur minimumin historik në fund të muajit Mars 2022 në kuotën 260.67 m.m.n.d.
- KESH në periudhën Qershor deri Gusht 2021, që i përket periudhës së thatë me prurje të pakta, rriti prodhimin e HEC-ve të kaskadës së Drinit duke prodhuar në total në këtë periudhë 1,192,661 MWh ose 30% të kërkesës së FSHU për furnizimin e konsumatorëve fundor.
- KESH nuk ka respektuar aneksin nr.1 të kontratës për furnizimin e FSHU me sasinë e energjisë elektrike të planifikuar për muajt Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor 2021.
- KESH përveç operacioneve të tjera, si ato të shitjeve nga prurjet e larta, optimizimit, etj., në periudhën Qershor-Tetor 2021, ka dhënë 149,442 MWh energji elektrike shoqërisë tregtare N.E.në formën e shkëmbimit. Periudhë kjo që korrespondon me rënien e nivelit të liqenit të Fierzës.

Konkluzione:

Për sa më lart,

- Rënia e nivelit të liqenit në muajin Tetor 2021, ka ardhur si rezultat i mosrespektimit të kushteve të shfrytëzimit dhe administrimit të kaskadës së Drinit, për ruajtjen e kuotave të prodhimit dhe nivelit minimal të lejuar.
- Në periudhën e thatë, në kushtet e mungesës së prurjeve; KESH rriti nivelin e shfrytëzimit të HEC-ve në periudhën Qershor-Gusht 2021, duke prodhuar gati 30% të kërkesës së kontraktuar me FSHU.



3. Një faktor tjetër që ka ndikuar në rënien e rezervës hidroenergjetike është sasia e energjisë elektrike të prodhuar për shkëmbim me N. E. në periudhën Qershor-Tetor 2021.

4. Administrimi i rezervës hidrike ngelet një nga problematikat kryesore si në drejtim të rezervimit të sasisë hidrike në rezervuarët e kaskadës në kushtet e prurjeve të mëdha, ashtu edhe në ruajtjen e vlerave të mesatares shumëvjeçare në kushtet e mungesës së reshjeve siç ka qënë rasti gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2021.

Rekomandim:

1.1. Këshilli Mbikëqyrës i KESH të analizoj problematikat e shfaqura në lidhje me shfrytëzimin dhe menaxhimin e rezervës hidroenergjetike në kaskadën e lumit Drin, kryesisht atë të 6 mujorit të dytë të vitit 2021 dhe të tre mujorit të parë 2022.

Vazhdimisht

I. Veprimtaria e KESH mbi sigurinë e digave në kaskadën e lumit Drin.

KESH sh.a., krahas prodhimit të energjisë, ka si objekt kryesor të veprimtarisë edhe mirëmbajtjen e veprave hidroteknike në përgjithësi dhe digave e objekteve të tyre në veçanti. Objektivi kryesor i KESH është sigurimi i prodhimit të energjisë elektrike por njëkohësisht dhe siguria e veprave/digave dhe mirëmbajtja e tyre.

Siguria e digave është e rregulluar me një kuadër ligjor dhe konsiston në tërësinë e masave organizative, teknike dhe financiare që garantojnë shfrytëzimin normal të objektit, jetëgjatësinë e tij dhe mos cenimin e të "tretëve", e parashikuar kjo që në fazën e projektimit, ndërtimit dhe gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së veprave.

Kuadri ligjor është:

a. Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave".

b. Vendimi Nr. 147, datë 18.03.2004, "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave".

Investimet e nevojshme në lidhje me rritjen e sigurisë së digave ndahen në:

a. Investime ndërtimore për sigurinë e veprave;

b. Investime elektromekanike për sigurinë dhe optimizimin e shfrytëzimit të veprave për prodhimin e energjisë elektrike.

A. Investime ndërtimore për sigurinë e veprave

Në gjashtë digat e tre HEC-ve të kaskadës së lumit Drin janë instaluar sistemet e monitorimit, si me poshtë:

- Sistemi i Monitorimit Gjeologjik
- Sistemi i Monitorimit Gjeodezik
- Sistemi i Monitorimit Hidrologjik
- Sistemi i Monitorimit Sizmik
- Sistemi i Monitorimit të Filtrimeve.

B. Investime elektromekanike për sigurinë dhe optimizimin e shfrytëzimit të veprave për prodhimin e energjisë elektrike.

Investimet elektromekanike, janë si më poshtë:

- Rehabilitim Agregatësh
- Rehabilitim Gjeneratorësh
- Rehabilitim Turbinash
- Rehabilitim i sistemeve elektromekanike të portave të shkarkimit të veprave shkarkuese të plotave të ujit në të tre HEC-et.



Rekomandim:

1.2. KESH të rrisë projektet e investimeve në lidhje me rritjen e parametrave të sigurisë së digave për të minimizuar rrezikun e katastrofës. Investimet vjetore për sigurinë e digave të shoqërohen me investime në teknologji për monitorimin, mirëmbajtjen dhe parashikim.

Vazhdimisht

4.1.1. Cilat janë hapat e ndërmarra nga KESH për implementimin e sistemit SCADA në rezervën hidrike të kaskadës në lumin Drin?

Sistemi SCADA²² shërben për të monitoruar, kontrolluar në kohë reale dhe për të ruajtur të dhëna dhe parametra që janë tregues të ecurisë së procesit teknologjik.

Në rastin e HEC-ve të kaskadës së Drinit, sistemet SCADA shërbejnë për të monitoruar dhe kontrolluar kryesisht të gjithë proceset elektro-mekanike që kryhen turbina (gjeneratori) deri në injektimin e energjisë elektrike në sistemin e transmetimit.

Hidrocentrali në vetvete është një vepër komplekse, ku ndërthuren shumë element, duke filluar nga veprat hidroteknike të cilat bëjnë akumulimin, marrjen dhe shkarkimin e rezervës hidrike dhe nga agregatet, të cilat përbëhen nga:

- Pjesa mekanike, turbina e cila bënë të mundur shndërrimin e energjisë potenciale të masës ujore të akumuluar, në energji kinetike të lëvizjes rrotulluese.*
- Gjeneratori elektrik, i cili shndërron energjinë kinetike të lëvizjes rrotulluese në energji elektrike.*
- Pajisjet elektrike transformuese dhe elementet e traktit të Nënstacionit që bëjnë të mundur transmetimin e energjisë elektrike.*

Të gjithë elementet kanë parametra mekanik, elektrik, gjendje(statuse), sensor, dhe shërbejnë si sinjal hyrje (input) për PLC²³, ndërsa si output-e janë komandat, që ekzekutohen nga pajisje elektrike, elektrohidraulike, (bobina, elektrovalvula, servomotor etj).

SCADA e HEC-ve komunikon me PLC-të ose RTU²⁴ dhe gjithë elementet përbërës të centralit, si:

- PLC e sekuencave të agregatit,
- PLC e rregullatorit të shpejtësisë,
- PLC në veprat e marrjes dhe shkarkimit dhe PLC e Nënstacionit., etj.

Administrimi i veprës bëhet nëpërmjet një ndërfaqësi për të gjitha nënsistemet e automatizuara duke bashkërenduar në kohë reale të gjitha sekuencat që kanë të bëjnë me operimin e agregatit dhe pajisjeve të tjera elektromekanike.

Nëpërmjet in-put-ve të PLC-ve e më pas në sistemin SCADA, përfitohen të dhënat e nevojshme në lidhje me presionin, shpejtësinë, vlera të matura të rrymës, tensionit, pozicione, etj., Ndërkohë sinjalet Out-put janë komanda që ekzekutohen automatikisht por edhe manualisht nga administratori i sistemit.

Përveç in put-eve kryesore që kanë të bëjnë me agregatin në SCADA dërgohen input-e edhe në lidhje me kuotën e liqenit, nivelin e prurjeve nga agregati dhe sasinë e ujit nga shkarkimet. Në HEC-et e kaskadës së Drinit janë implementuar edhe sisteme të tjera monitorimi që operojnë të pavarura. Dërgimi i këtyre të dhënave është i dedikuar, p.sh., në rastin e sistemit të matjes gjeodezike, monitorimit sismik, monitorimit hidrologjik, etj.

Më poshtë në skemën nr.3 paraqitet mënyra sesi do të funksionoi SCADA qendrore në godinën kryesore të KESH duke komunikuar me SCADA-t e tjera të HEC-ve të kaskadës së Drinit.

KESH ka parashikuar që projekti SCADA qendror do të ketë funksionet e një dispeçerie me të drejta të plota mbi monitorimin dhe kontrollin e të gjithë sistemit.

Gjithashtu projekti parashikon zgjerim të gamës të të dhënave që do të shkëmbehen në skadën e

²² Supervision Control and Data Acquisition


²³ Programmable Logic Controller

²⁴ Remote Terminal Unit



dispecerisë qendrore, duke përfshirë edhe sistemet e tjera të monitorimit që operojnë të pavarura, të cilat kanë të bëjnë me monitorimin e digës dhe të dhënat hidrologjike etj.

Skema nr.2 Skema e komunikimit te SCADA-ve lokale me atë qendrore në KESH



Burimi: Dizenjuar nga grupi i KLSH

Gjetje:

Për sa më lart,

KESH ende nuk ka implementuar sistemin qendror SCADA²⁵ për të bashkërenduar në mënyrë informatike dhe kohë reale me SCADA-t lokale të HEC-ve të kaskadës së lumit Drin.

Konkluzione:

Për sa më lart,

Mungesa apo vonesa e implementimit të SCADA qendrore në KESH, e cila do të shërbej si një dispeceri qendrore për monitorim dhe kontroll në kohe reale me burimet e gjenerimit të KESH ka bërë që marrja e informacioneve në KESH të bëhet manualisht apo pjesërisht për disa parametra në kohë reale.

Rekomandim:

KESH të marrë masat e nevojshme për përfundimin dhe implementimin e sistemit SCADA për të patur kontroll në kohë reale të aseteve gjeneruese.

Menjëherë

4.1.2. A ka qënë efektive veprimtaria e KESH në lidhje me menaxhimin e tepricës së energjisë elektrike dhe optimizimit të kostove të blerjes së saj?

Menaxhimi i tepricave të BRE²⁶

Në rast të tepricave të krijuara nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, ato do të depozitohen tek shoqëria publike e prodhimit, për t'u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë.

²⁵ ligj nr. 87/2015 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së republikës federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin "energji ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit"

²⁶ neni 12 i VKM nr. 456, datë 29.6.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"



Këto sasi rakordohen me bazë mujore dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes bazuar në sasinë dhe programet e kërkuara nga Furnizuesi i Tregut të Lirë dhe dakortësuar ndërmjet palëve, deri në mbulimin e plotë të humbjeve.

Shoqëria publike e prodhimit kompenson Furnizuesin e Tregut të Lirë në vlerë, për sasinë e depozituar dhe që nuk është shkëmbyer deri në fund të vitit kalendarik, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike.

Teprica e burimeve të rinovueshme të depozituara dhe që nuk përdoren për mbulimin e humbjeve mund të shiten në treg të lirë nga prodhuesi publik.

Kjo marrëdhënie do rregullohet në kontratën dypalëshe ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë, duke mbajtur në konsideratë rregullat e tregut të balancimit në fuqi.

Nga auditimi konstatohet se:

KESH-FTL-FSHU sipas përcaktimeve të VKM 456/2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", kane hartuar dhe nënshkruar kontratën për vitin 2022 dhe e kanë dërguar për miratim ERE-së.

Sasia e depozituar-shkëmbyer FTL dhe KESH deri në muajin shtator 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti 2022	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Total
Energji elektrike e siguruar per humbjet (MWH)	236,774	172,060	166,606	360,116	245,745	102,436	55,668	53,464	75,813	1,468,682
Humbjet faktike	230,529	138,482	173,587	120,046	95,552	93,593	112,713	102,554	74,350	1,141,406
Dif. ka shkuar per furnizimin e klienteve fundor	6,245	33,578	(6,981)	240,070	150,193	8,843	(57,045)	(49,090)	1,463	327,276

Burimi: KESH, përpunimi grupi i auditimit të KLSH-së

HEC-et e kaskadës së Drinit përgjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021, si pasojë e rritjes së prurjeve nga reshjet e shiut, treguesit e kaskadës së Drinit kapen vlerat maksimale.

Në zbatim të rregullores së plotave ku miradministrimi i digave ka lidhje direkte me sigurinë e tyre, KESH-sh.a. bëri operacione të shitjes së energjisë në kushtet e prurjeve të larta, me qëllim ruajtjen e kuotave optimale të rezervës hidrike dhe prodhimin e energjisë elektrike me qëllim shmangien e derdhjes së ujit pa prodhim energjie e rrjedhimisht pa përfitim financiar.

I. Shitjet e energjisë elektrike të KESH-it nga prurjet e larta

Për periudhën Janar – Maj; 01-11 Qershor dhe 06-14 Dhjetor 2021 si rezultat i prurjeve të larta në kaskadën e Drinit, KESH ka kryer procedura të shitjes së energjisë elektrike në sasinë 1,125,827 MWh me çmim 48 euro/MWh duke përfituar të ardhura në shumën 54,198,269 euro.

Në tabelën nr.16 paraqitet shitjet me prurje të larta për vitin 2021 sipas muajve respektiv.

Në muajin dhjetor në datat 06-14.12.2021 në kushtet e prurjeve të larta, KESH ka kryer procedura të shitjeve të sasisë 18,180 MWh me çmimin 215 euro/MWh në shumën 3,899,689 euro.

Nga auditimi rezulton se:

Për vitin 2021, KESH nuk ka arkëtuar 2,288,388.90 euro nga sasia e shitur në kushtet e prurjeve të larta.



Shuma prej 2,288,388.90 euro paraqet detyrimin e mbartur nga shoqëria N4T, pasi kjo kompani duhej të arkëtonte 54,198,260 euro KESH-it nga blerja e energjisë elektrike ndërkohë që ka arkëtuar vetëm 51,909,930.1 euro.

Shënim: Ky rast është trajtuar më hollësisht në faqen 39 pika V, efektiviteti i menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Tabela nr.16. Sasitë e shitura nga prurjet e larta

	Muaji	Sasia	Çmimi	Vlera
		MWh	Euro/MWH	Euro
2021	Janar	214,830	39	8,300,018
	Shkurt	276,687	29	8,035,951
	Mars	151,763	47	7,101,189
	Prill	168,214	55	9,257,857
	Maj	230,053	57	13,119,721
	Qershor 01-11.06.2021	66,100	68	4,483,843
	Dhjetor 06-14.12.2021	18,180	215	3,899,689
	Total	1,125,827	48	54,198,269

Burimi: KESH, përpunimi nga grupi i KLSH

II. Shitjet/blerjet për optimizim

Për periudhën Korrik–Dhjetor 2021 janë realizuar shitje dhe blerje për të optimizuar portofolin financiar. Në tabelën nr.17 pasqyrohen operacionet tregtare për optimizim në vitin 2021

Gjetje:

Departamenti i Operimit të Tregut nuk ka mundur të realizoj me sukses optimizimin e portofolit financiar nëpërmjet shitjeve/blerjeve për vitin 2021.

Në tabelën nr.17 paraqiten operacionet tregtare të shitje/blerjes të realizuara nga KESH për vitin 2021. Shitjet dhe blerjet e realizuara nga DOT për optimizim në pamje të parë perceptohet që janë realizuar me sukses, pasi çmimi i shitjes është më i lartë se ai i blerjes, por ajo që ka ndikuar në mos realizimin e procesit të optimizimit është se sasitë e blera nga KESH kanë qënë më të larta se ato të shitjes dhe për pasoj kanë ndikuar që efekti financiar i të ardhurave të rezultojë me humbje në shumën (5,840,019) euro për vitin 2021. Në muajin Dhjetor 2021 KESH ka kryer procedura për optimizimin e portofolit financiar, por siç pasqyrohet në tabelën nr.17, KESH ka shitur 240 MWh me një çmim mesatar 450 euro/MWh por ndërkohë ka blerë një sasi të madhe prej 29,364 MWh me çmim mesatar 236 euro/MWh. Kjo ka sjell që ky operacion për optimizim të rezultojë me një tregues negativ në portofolin financiar të KESH me 6,835,026 euro.

Tabela nr. 17. Operacionet tregtare shitje/blerje për optimizim në 2021

2021	Muaji	Sasia	Çmimi	Vlera
		MWh	Euro/MWh	Euro
Shitje	Qershor 25, 29, 30.06.2021	1,260	112	141,425
Blerje	Qershor 27.06.2021	510	69	35,430
Shuma 1				105,995
Shitje	Korrik	5,650	117	661,941



Blerje	Korrik	5,608	86	483,307
Shuma 2				178,635
Shitje	Gusht	3,600	147	528,156
Blerje	Gusht	3,158	101	318,994
Shuma 3				209,162
Shitje	Shtator	2,992	170	508,796
Blerje	Shtator	2,140	145	309,551
Shuma 4				199,244
Shitje	Tetor	4,400	213	938,305
Blerje	Tetor	3,627	175	636,334
Shuma 5				301,971
Shitje	Dhjetor	240	450	108,000
Blerje	Dhjetor	29,364	236	6,943,026
Shuma 6				(6,835,026)
Total				(5,840,019)

Burimi: Kesh, përpunimi nga grupi i KLSH

Nga auditimi i disa procedurave me zgjedhje rastësore për vitin 2022 të zhvilluara nga KESH për optimizim të portofoli financiar. Grupi i KLSH përzgjedhi procedurën e muajit Shtator 2022.

Për sa tregohet në tabelën nr. 18 rezulton se përsëri shoqëria ka kryer operacione që nuk kanë rezultuar në rritjen e të ardhurave të shoqërisë po me humbje në shumën (49,612) euro. Në këtë procedurë KESH ka shitur 600 MWh me çmimin 601 euro/MWh në shumën 360,547.80 euro dhe ka blerë një sasi prej 780 MWh ose 180 MWh më shumë se shitja me çmim prej 525 euro/MWh, duke shpenzuar shumën prej 410,160 euro.

Tabela nr. 18 Operacionet tregtare shitje/blerje për optimizim në 2022

Shitje/Blerje	Shoqëria	LOT	Periudha	Orari	Sasia	Çmimi	Vlera
					MWh	Euro/MWh	Euro
Shitje Optimizim	AYEN Energy Trading	1	29.08-02.09.2022	19:00-22:00	120	671	80,520.00
	GSA shpk	1	29.08-02.09.2022	19:00-22:00	120	602.22	72,266.40
	Info Telecom	1	29.08-02.09.2022	19:00-22:00	150	570	85,500.00
	Renrgy Energy Trading	1	29.08-02.09.2022	19:00-22:00	60	606.69	36,401.40
	TID shpk	1	29.08-02.09.2022	19:00-22:00	150	572.4	85,860.00
Blerje Optimizim	TID shpk	2	29.08-04.09.2022	00:00-06:00	600	526.1	315,660.00
	Info Telecom	2	29.08-04.09.2022	00:00-06:00	180	525	94,500.00
Shitje Optimizim					600		360,547.80
Blerje Optimizim					780		410,160.00
Efekti financiar					(180.00)		(49,612.20)

Burimi: Kesh, përpunimi nga grupi i KLSH



Për sa më lart, DOT dhe komisioni i shitblerjeve ka vepruar në mospërputhje me nenin 4 pika 4.2 të rregullores së përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga KESH²⁷ dhe pika IV.4 e manualit të tregtimit²⁸, ku parashikohet se:

AK nëpërmjet procesit të tregtimit se energjisë elektrike, synon përfitimin financiar nëpërmjet shitjes dhe/ose optimizimin e portofolit financiar/energjistik nëpërmjet shitblerjes, kjo në varësi të vlerësimit që i behet situatës rast pas rasti.

III. Plotësimi i kërkesës së FSHU nga KESH

Furnizuesit të Shërbimit Universal, ka detyrimin e shërbimit publik për blerjen e sasisë të nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga KESH²⁹. Sasia dhe çmimi për njësi e energjisë elektrike, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të furnizuesit të shërbimit universal, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së Prodhimit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Kjo sasi energjie, për qëllime të përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik përkundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal, është përcaktuar në kontratën Nr. 2920/1 Prot., datë 24.09.2020 të miratuar nga ERE të bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit. Bazuar në Nenin 2 të kontratës së sipërcituar, "Sasia e kontraktuar dhe çmimi i shitjes", sasia e prodhimit të energjisë që KESH duhet të furnizoj FSHU-në për vitin 2020 dhe 2021, përcaktuar në Vendimin Nr. 10841/1 Prot., datë 27.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të KESH-sh.a. ka qënë në sasinë 3,950,000 MWh.

Gjetje:

Nga auditimi i evidencës së administruar nga grupi i auditimit të KLSH, rezulton se:

a. Këshilli mbikëqyrës i KESH nëpërmjet vendimit nr.15 date 01.07.2021 me objekt "Për miratimin e disa ndryshimeve në programin ekonomik financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2021", ka rishikuar totalin e prodhimit neto nga 3,977,367 MWh në 5,322,813 MWh, nga ku rezulton që KESH për vitin 2021 ka prodhuar 5,901,697 MWh duke realizuar dhe tejkaluar parashikimin e planit ekonomik financiar.

b. KESH ka përmbushur detyrimin kundrejt FSHU, nga ku sasia e energjisë elektrike e shitur FSHU është 4,145 GWh, kundrejt sasisë së kontraktuar prej 3,950 GWh.

c. Diferenca e sasisë së energjisë elektrike të shitur kundrejt të asaj të kontraktuar prej 194,704 MWh. nga KESH për FSHU është shitur me çmimin 1.5 leke/KWh, pra me të njëjtin çmim si ajo e sasisë së kontraktuar. Për sa më lart KESH ka vepruar në mospërputhje me neni 2 pika 3 të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 10841 /1prot, datë 27.12.2019 ku parashikohet se:

Shitësi në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë e prodhimit të energjisë elektrike mbi atë të parashikuar në piken 1, por në çdo rast jo me shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundor që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, është i detyruar t'ia ofrojë (propozojë) fillimisht Blerësit me çmimin e HUPX për atë moment.

d. Nga auditimi i faturave tatimore rezulton se e gjithë sasia e lëvruar nga KESH për vitin 2021 për FSHU është shitur me 1.5 lekë (Pa TVSH).

²⁷ Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme të Aksionerit nr. 5233/1 date 12.06.2019

²⁸ Urdhëri nr.121, datë 06.12.2019

²⁹ Bazuar në nenin 5/2 të VKM-në Nr. 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar



Tabela nr. 19. Totali i sasisë se shitur FSHU nga KESH për vitin 2021

Muaji	sasia (MWh)	çmimi (pa TVSH)	Vlera me TVSH	
Janar	446,713	1,500	804,083,400	
Shkurt	377,581	1,500	679,645,800	
Mars	450,324	1,500	810,583,200	
Prill	327,395	1,500	589,311,000	
Maj	317,077	1,500	570,738,600	
Qershor	401,948	1,500	723,506,400	
Korrik	467,469	1,500	841,444,200	
Gusht	323,244	1,500	581,839,200	
Shtator	182,473	1,500	328,451,400	
Tetor	201,206	1,500	328,451,400	
Nentor	199,094	1,500	362,170,800	
Dhjetor	01-20.12.2021	255,476	1,500	358,369,200
	Shuma1	3,950,000	1,500	6,978,594,600
Dhjetor	21-31.12.2021	194,704	26,486	6,188,316,173

Burimi: KESH, përpunimi nga grupi i auditimit te KLSH

Nga auditimi rezulton se:

Sasinë e kontraktuar si detyrim për të furnizuar FSHU për vitin 2021, KESH e ka realizuar brenda datës 20.12.2021.

Sasia e lëvruar (shitur) nga KESH për FSHU pas datës 20.12.2021 deri më 31.12.2021 është 194,704 MWh.

Në referim të pikës 3 nenit 2 të kontratës së sipërcituar, KESH-i sasinë 194,704 MWh duhej ta faturonte me çmimin e HUPX për FSHU.

Në referim të çmimeve të publikuara nga HUPX për periudhën (20 – 31.12.2021) çmimi mesatar ka qënë 231.75 dhe me kursin ditor të këmbimit ku 1 euro këmbej me 120.76 lekë, KESH duhej të faturonte për vitin 2021 FSHU **13, 166,910,773 lekë** për gjithë sasinë e shituar.

Nga përllogaritjet e grupit të KLSH për sasinë shtesë, FSHU i detyrohet KESH-it në shumën 6,188,316,173 lekë (me TVSH).

Pasi $194,704 \text{ MWh} * [(231.75 * 120.76) - 1,500] * 1.2 = 6,188,316,173 \text{ leke}$.

Për sa më lart, në referuar të programit të rishikuar ekonomik financiar për veprimtarinë e KESH sh.a për vitin 2021., me nr.15, date 01.07.2021 protokolluar në KESH me nr.3474/1prot. Date 16.07.2021 në relacionin bashkëlidhur për rishikimin e programit ekonomik - financiar të veprimtarisë së shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021, miratuar nga asambleja e përgjithshme e aksionareve të shoqërisë me vendimin nr. 135/1 date 14.01.2021 "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021-2025", pika 1. Shitjet për FSHU është parashikuar, se:

Shitjet për FSHU sipas detyrimit për shërbim publik të përcaktuar me Vendimin e Asamblesë Nr. 135/1 date 14.01.2021 "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021-2025" dhe sipas kontratës, parashikohen në masën 3,950 GWh, me çmim 1.5 leke/Kwh dhe rreth 208 GWh me çmimin mesatar të bursës HUPX.

Këshilli Mbikëqyrës në vendimin nr.20 date 21.10.2021 protokolluar në KESH me nr.4981/2 Prot date 10.11.2021 me objekt "Për miratimin e disa ndryshimeve në programin ekonomik financiar të shoqërisë KESH për vitin 2021" në relacionin bashkëlidhur në lidhje me sasinë dhe çmimin për FSHU, ka parashikuar që:



Shitjet për FSHU sipas detyrimit për shërbim publik të përcaktuar me Vendimin e Asamblesë Nr. 135/1 date 14.01.2021 "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021-2025" dhe sipas kontratës, parashikohen në masën 3,950 GWh, me çmim 1.5 leke/Kwh dhe rreth 208 GWh me çmimin mesatar të bursës HUPX.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.20 datë 21.10.2021 me objekt "Për miratimin e disa ndryshimeve në programin ekonomik financiar të shoqërisë KESH për vitin 2021" miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me shkresën nr.5755/3 datë 19.11.2021 ka konfirmuar që çmimi mbi sasinë e kontraktuar prej 3.950 GWh duhet të jetë sa çmimi mesatar i bursës HUPX.

Konkluzione:

Për sa më lart,

KESH ka plotësuar dhe tejkalluar sasinë e kontraktura për shitje për FSHU, por nuk ka bërë diferencim në çmimin e shitjes për sasinë shtesë dhe për pasoj kjo ka ndikuar tek të ardhurat e KESH.

Rekomandim:

1. KESH në bashkëpunim me MIE, në cilësinë e pronarit të përbashkët për shoqëritë KESH dhe OSHEE grup, të kërkoj që shuma 618,8316,173 lekë (me TVSH) t'i faturohet shoqërisë FSHU sh.a., si një detyrim i lindur nga kontrata e shitblerjes të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të KESH.

Deri më datë 30.06.2023

Gjetje:

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë KESH në vendimin nr.15 date 01.07.2021, pika 1 "Treguesit kryesor" për vitin 2021 (i miratuar) dhe 2022 (i rishikuar) ka përcaktuar se sasia për prodhim për furnizim e OSHEE-Klient Tarifor për 2021 të jetë 2,851,843 MWh dhe për vitin 2022 të jetë 2,833,887 MWh.

Ndërkohë në relacionin bashkëlidhur Tabela 3 - Treguesit e Pritshëm të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike 2021 (MWh) është përcaktuar respektivisht për vitin 2021 sasia e energjisë elektrike të jete 3,950,000 MWh dhe në atë të rishikuar me 4,157,672 MWh.

Për sa më lart, në referim edhe të sqarimeve të përfaqësuesit të KESH, rezulton që Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 01.07.2021, tek treguesit kryesor nuk ka përputhshmëri me relacionin bashkëlidhur duke paraqitur të dhëna të tjera me ato të pasqyruara në relacionin mbështetës, por sipas tyre është lapsus.

Rekomandim:

2. Këshilli Mbikëqyrës i KESH-it të bëj ndryshim në Vendimit nr.15, date 01.07.2021 duke saktësuar dhe unifikuar vendimin me të dhënat e relacionit bashkëlidhur tij.

Menjëherë

IV. Shkëmbimi i energjisë elektrike me kompaninë N. E.

Problematikat e konstatuara në lidhje me marrëveshjen Nr.2350/1 Prot. Datë 04.05.2021 për shkëmbimin e energjisë midis KESH dhe subjektit tregtar N. E. është trajtuar në raportin përfundimtar të KLSH nr.889/34 Prot. Date 07.06.2022.

Trajtimi në këtë Projekt Raport auditimi të performancës ritrajtohet sepse periudha e auditimit reflekton operacione tregtare të përditësuar në lidhje me sasinë e shkëmbimit reciprok të sasisë së kontraktuar në marrëveshjen e sipërcituar.

Nga auditimi rezulton se:

Nga auditimi i evidencës dokumentare mbi nominimin dhe lëvrimin e sasisë së shkëmbyer midis KESH dhe subjektit tregtar N. E. informacion i marrë pranë OST. Mbi bazën e këtij informacioni



grupi i KLSH referuar bursës HUPX sipas fashave orare të shkëmbimit midis KESH dhe subjektit tregtar N. E., përcaktoi çmimet e kuotuar në HUPX për të dyja drejtimet e shkëmbimit deri në Maj të vitit 2022.

Në tabelën nr.20 pasqyrohen transaksione/shkëmbime të energjisë elektrike, nga ku rezulton se KESH i ka lëvruar subjektit tregtar N. E. sasinë e energjisë elektrike jo në kushte të favorshme për te optimizuar portofolin financiar.

Mbi bazën e profilit dhe fashës së nominuar/lëvruar është përcaktuar çmimi sipas bursës hungareze HUPX, siç paraqitet në tabelën nr.20.

Në të gjitha shkëmbimet KESH ka kryer operacione që nuk e kanë favorizuar portofolin financiar të saj, pasi nëse shkëmbimet e sasisë do të konvertonim në vlerë financiare nga fillimi i tyre deri me date 31.10.2022, rezulton që KESH të ketë një të ardhur të munguar në shumën 9,367,730 euro.

Në tabelën nr.24 paraqitet ecuria e shkëmbimeve të energjisë elektrike midis KESH dhe shoqërisë tregtare N. E.

Gjetje:

Subjekti tregtar N. E. deri në fund të muajt shtator 2022 është debitor për sasinë 17,515 MWh.

Në bazë të kësaj marrëveshje kompania ka një fitim të munguar prej 9,367,730 euro në portofolin e vet financiar, pasi nëse sasia totale e shkëmbyer do të ishte shituar/blerë për optimizim në bazë të çmimeve referente në HUPX do të kishte një fitim prej 9,367,730 euro.

Tabela nr. 20. Detyrimi i mbetur i N. E. ndaj KESH deri me shtator 2022

Muaji/2021	Shkëmbimi		Sasia	Çmimi i ponderuara HUPX	Vlera
			MWh	Euro/MWh	Euro
Maj	Marrje	N.-KESH	(8,605)	49	(420,549)
	Dhënie	KESH-N.	1,381	56	76,902
Qershor	Marrje	N.-KESH	(16,195)	59	(948,179)
	Dhënie	KESH-N.	14,975	102.5	1,534,485
Korrik	Marrje	N.-KESH	(28,952)	73.3	(2,122,356)
	Dhënie	KESH-N.	41,196	112.97	4,654,091
Gusht	Marrje	N.-KESH	(31,055)	83.4	(2,591,060)
	Dhënie	KESH-N.	41,094	133	5,452,767
Shtator	Marrje	N.-KESH	(30,209)	106	(3,197,697)
	Dhënie	KESH-N.	40,329	160	6,453,365
Tetor	Marrje	N.-KESH	- 14,440	125.55	(1,812,929)
	Dhënie	KESH-N.	10,467	255.85	2,677,955
Nëntor	Marrje	N.-KESH	-		
	Dhënie	KESH-N.	-		



Dhjetor	Marrje	N.-KESH	-		
	Dhënie	KESH-N.	-		
Balanca 2021			19,986		9,756,795
Muaji/2022	Shkëmbimi		Sasia	Çmimi mesatar HUPX	Vlera
			MWh	Euro/MWh	
Prill	Marrje	N.-KESH	(2,441)	157	-383128.93
	Dhënie	KESH-N.	0		
Maj	Marrje	N.-KESH	(30)	198	-5935.85
	Dhënie	KESH-N.	0		
Balanca 2022			(2,471)		(389,065)
Balanca Maj 2021 - Shtator 2022			17,515		9,367,730

Burimi: KESH, përpunimi nga grupi i KLSH

Konkluzion:

Për sa me lart,

në zbatim të VKM 244 datë 30.03.2016 "Për kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, qe do te zbatohen ndaj të licesuareve në sektorin e energjisë elektrike, te cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" KESH duhet te garantoje përbushjen e detyrimit për shërbimit publik për furnizim te qëndrueshëm te FSHU sh.a ofrimin e shërbimeve ndihmese për operimin e sistemit elektroenergjitik Shqiptar si dhe te respektoj parimet e leverdishmërisë ekonomike dhe energjitike në kushtet kur e kërkon situata hidrologjike ne vend ne përputhje me kriteret e shfrytëzimit të kaskadës.

Rekomandim:

3. Administratori i shoqërisë KESH Sh.A. të kërkoj nga subjekti tregtar N.E. kthimin e menjëhershëm të sasisë së energjisë elektrike prej 17,515 MWh si detyrim i mbetur i kësaj shoqërie kundrejt KESH-it.

Deri më datë 31.12.2022

Rekomandim:

4. Administratori i shoqërisë KESH Sh.A. në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës të nxjerrin dhe të miratojnë udhëzime apo akte administrative ku të mirëpërcaktohet procedura e shkëmbimit të energjisë elektrike me subjekte tregtare duke ndjekur të njëjtin parim të optimizimit "shit shtrenjtë dhe bli lire".

Në vijimësi



IV. Efektiviteti Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Procedurat e shitjeve realizohen mbi bazën marrëveshjeve³⁰ të lidhura me shoqëri tregtare të licensura në tregun e energjisë elektrike, që rinovohen çdo vit në bazë të dokumentacionit të kërkuar nga sektori i Kontrollit dhe Vlerësimit të Transaksioneve pranë DOT-it.

Në rast se shoqëritë tregtare nuk shprehin interes për lëshimin e garancisë bankare (opsionale) atëherë subjekti tregtar fitues i një procedure shitblerje duhet të parapaguaj vlerën e sasisë së kontraktuar.

Fatura me parapagesë (Prepayment Invoice) përgatiten nga sektori i administrimit të kontratave në DOT³¹ dhe konfirmohen (firmoset) nga drejtori i këtij Departamenti.

Më pas kjo faturë protokollohet në KESH dhe i përcillet nga sektori i administrimit të kontratave në adresën e e-mail të shoqërisë tregtare dhe njëkohësisht dhe Drejtorit të DOT-it.

Likuidimin i faturës së shitjes nga subjekti tregtar duhet të realizohet sipas afatit të përcaktuar në faturë (proforme invoice)³².

Subjekti tregtar brenda afatit të kërkuar në faturë, duhet të konfirmoj kryerjen e pagesës duke dërguar në adresën e e-mail të sektorit të administrimit të kontratës dhe të Drejtorit të DOT-it *swift code*-in e skanuar.

Njëkohësisht sektori i administrimit të kontratave ka akses në llogarinë bankare të KESH për pagesat e shitjes energjisë, si mundësi për të bërë kryqëzimin e të dhënave.

Me likuidimin e faturës nga subjekti tregtar, sektori i administrimit të kontratave informon drejtorin e DOT për pagesën e kryer.

Pas kësaj Drejtori i DOT urdhëron sektorin e transaksioneve të energjisë të bëjë nominimin e sasisë së kontraktuar.

Për sa më lart, kjo është procedura e rregullt që ndiqet për shitjen e energjisë elektrike nga KESH në rastin e prurjeve të larta.

Në periudhën Mars - Qershor 2021, shoqëria "N. F. T. D. B." (N4T) ka marrë pjesë në procedurat e shitjes nga KESH Sh.A së energjisë elektrike, si rezultat i prurjeve të larta në kaskadën e lumit Drin.

Gjetje:

Siç pasqyrohet në tabelën nr. 21., shoqëria N4T për periudhën 24 -30.04.2021 ka kryer pagesë pjesore në shumën 470,000 euro, e cila është kryer në disa pagesa përgjatë muajve Maj, Qershor dhe Shtator. Ndërkohë për tre faturat e tjera të emetuara nga KESH, shoqëria N4T nuk ka kryer asnjë pagesë megjithëse KESH-i ka lëvruar sasinë 27,090 MWh energji elektrike shoqërisë tregtare N4T.

Përpos kësaj KESH ka lejuar shoqërinë N4T të vazhdonte normalisht blerjet edhe për tre procedura të tjera pasardhëse duke mos likuiduar asnjë faturë shitje.

Gjithë struktura përgjegjëse pranë KESH që përgjigjej për kryerjen e pagesës nga N4T duke filluar nga sektori i administrimit të kontratave pranë DOT, DOT dhe sektor të tjerë pranë DOT, të cilët kanë përpiluar faturat me parapagim dhe kanë akses në llogarinë bankare të shitjeve kanë lejuar që N4T të blejë energji pa asnjë penalitet dhe pa ndërprerje në kushtet kur nuk ka likuiduar si në rastin e likuidimit pjesërisht por akoma më keq në rastin që nuk ka likuiduar tërësisht faturat e njëpasnjëshme për muajt Maj dhe Qershor 2021 duke i krijuar KESH-it një disbalacë negative në llogarinë e të ardhurave, e përlllogaritur vetëm në pricipal pa kamatë vonesat në shumën 2,288,399 euro.

Konkluzion:

Auditimi i procedurave të shitjes për prurje të larta dhe veçanërisht ato të realizuara me shoqërinë tregtare N4T, megjithëse e trajtuar hollësisht në raportin përfundimtar të KLSH nr.889/34 Prot. Date 07.06.2022, rimerret përsëri në këtë projekt raport për të evidentuar problematikën serioze që ka

³⁰ Marrëveshje e përgjithshme për lëvrimin dhe pranimin e energjisë elektrike date 17.08.2018.

³¹ Departamenti I Operimit të Tregut

³² due date



funksionimi i MFK-së në drejtim të sigurimit të kontrollit të brendshëm, si një nga pilastrat kryesore të funksionimit të saj.

Pasi mos likuidimi i faturave pasardhëse për shitje të njëpasnjëshme për një periudhe gati një mujore, rezulton se gjithë hierarkia e parashikuar në rregullore për gjurmimin dhe zbatimin e të gjitha hallkave të kontrollit të brendshëm në këtë rast nuk ka funksionuar, duke e bërë sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit jo efektiv.

Tabela nr.21. Ecuria e likuidimit të faturave të shitjes N4T

Blerës	Periudha	Sasia (MWh)	EUR/MWh	Shuma (Euro)	Likuiduar (euro)	Balanca e palikujduar (euro)
N4T	24 -30.04.2021	14,560	61.65	897,640	470,000	427,640
	29.05-06.06.2021	9,600	63.05	605,280	-	605,280
	29.05-06.06.2021	5,440	64.36	350,118	-	350,118
	07-11.06.2021	7,800	74.06	577,668	-	577,668
	07-11.06.2021	4,250	77.09	327,633	-	327,633
Totali						2,288,339

Burimi: KESH, përpunimi nga grupi i KLSH

Rekomandim:

5. Administratori i shoqërisë KESH, nëpërmjet nxjerrjes së akteve administrative të përcaktoj procedura të qarta në lidhje me gjurmën e auditit për Departamentin e Operimit të Tregut, për të mos lejuar përsëritjen e këtij fenomeni që përbën një ngjarje me risk të lartë.

Menjëherë

4.2. A ka qënë efektive veprimtaria e KESH për diversifikimin e portofolit të aseteve gjeneruese?

Vizioni³³ i KESH-it është që të bëhet një lojtar kyç në tregun rajonal të energjisë duke diversifikuar kombinimin e burimeve tona të energjisë së rinovueshme dhe duke ofruar produkte dhe shërbime të reja. Bazuar në analizën e risqeve ponteciale të jashtme e të brendshme të shoqërisë KESH, strategjia e sipërcituar parashikon si zgjidhje ponteciale ndër të tjera, ndërtimin e aseteve të reja gjeneruese për të rritur kapacitet.

KESH në zbatim edhe të strategjisë së sektorit elektroenergjetik ka planifikuar në programet ekonomiko financiare fonde për ndërtimin e aseteve të reja gjeneruese.

Fokusi i shoqërisë në asetet e reja gjeneruese kanë qënë në teknologjitë e gjenerimit të cilat janë plotësuese dhe të përputhshme me asetet ekzistuese në administrim.

Impianti fotovoltaik

³³ Vendimi 06. datë 24.04.2019 i Këshillit mbikëqyrës për miratimin e strategjisë së shoqërisë KESH sh.a



Shoqëria KESH në programin ekonomik për vitin 2020 dhe 2021 kishte parashikuar ndërtimin e impiantit të parë gjenerues fotovoltaik. Impianti fotovoltaik në digën e Qyrsaqit filloj të gjeneroj për herë të parë në muajin Maj 2022. Impianti PV ka kapacitet 5.1 MWh dhe kosto³⁴ 0.05 Euro/KWh ose 6 All/KWh.

Shoqëria KESH ka planifikuar ndërtimin e një impiantit fotovoltaik lundruer në sipërfaqen e liqenit të Vaut të Dejës me kapacitet të instaluar prej 12.9 MWh.

Një tjetër projekt i shoqërisë KESH është ndërtimi i impiantit fotovoltaik në digën e Zadejës në HEC-in e Vaut të Dejës, mbi të cilin do të instalohet nën shembullin e PV Qyrsaqit, një impiant me kapacitet 8.3 MWh (në tokë).

TEC -Vlora

Sfida kryesore e KESH për diversifikimin e asetëve gjeneruese ngelet TEC Vlora, ky aset ende nuk i është shtuar portofolit gjenerues të shoqërisë KESH sh.a.

TEC Vlora ka një kapacitet të instaluar 98 MW, aktualisht është në kushte konservimi për shkak të defektit të shfaqur në sistemin e ftohjes që prej vitit 2012.

TEC-i Lundruer

Ndërkohë projekt në fazë të avancuar është projekti i asetit të përkohshëm gjenerues termik në Triport, Vlorë.

Ky aset termik është kontraktuar nga KESH në përputhje me parashikimet e VKM Nr. 620, i ndryshuar, nëpërmjet së cilës shoqërisë ju dha e drejta që të kontraktojë asete gjeneruese termike për periudha të përkohshme, ku sipas VKM Nr. 757³⁵, datë 21 Dhjetor 2021, autorizon KESH sh.a., që në përputhje me nevojat t'i drejtohet tregut ndërkombëtar për të marrë përkohësisht (2 vjet) me qera asete gjeneruese termike shtesë.

Kosto ditore sipas marrëveshjes dypalëshe e këtij asetit është 63 mijë\$ /ditë+31.500 \$ /ditë³⁶.

Në total TEC-i lundruer vetëm si detyrim kontraktor do të kushtoj buxhetit të KESH 94,500 \$/ditë.

Blerje e lëndës djegëse nga KESH do të realizohet nëpërmjet kontratave kuadër dhe projeksionit të prodhimit duke synuar çmime lënde djegëse sa më të favorshme dhe me furnizim në kohë sipas nevojës së shoqërisë.

Kapaciteti i instaluar i TEC-it lundruer është 110 MWh.

Kosto e prodhimit të energjisë elektrike sipas përlllogaritjeve të KESH-it, ku janë përfshirë;

a) çmimi i rentës;

b) kosto e lëndës djegëse dhe materialeve të tjera të konsumueshme;

dhe c) Taksa të tjera që aplikohen në Republikën e Shqipërisë.

Sipas KESH, nëse përjashtohet akciza për lëndën djegëse, duke ju referuar çmimit mesatar të parablerjes së lëndës djegës HFO³⁷, nga ku për vitin 2022 parashikohet të jetë 470 deri 585 USD/Ton. TEC-lundruer i Vlorës sipas përlllogaritjeve të KESH, kostoja e gjenerimit fikse për dy vite shkon në 202 Euro/MWh.

Konkluzione:

Për sa më lart,

I. Objektivi i rritjes së kapaciteteve gjeneruese nëpërmjet diversifikimit të asetëve gjeneruese është sigurimi i gjithë sasisë së energjisë së nevojshme për përmbushjen e Detyrimit të Furnizimit Publik duke synuar të mbajë kostot e gjenerimit më të ulëta se çmimet e tregjeve ndërkombëtare të energjisë elektrike, duke optimizuar prodhimin e energjisë nga kombinimi i burimeve hidrike dhe termike dhe

³⁴ sipas LCOE

³⁵ Për disa ndryshime në VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021

³⁶ për mirëmbajtjen (SLA)

³⁷ Referuar Bursës së Rotterdam.



duke përmbushur Detyrimin e Furnizimit Publik gjatë gjithë vitit, edhe në periudhën e thatë kur çmimet e energjisë elektrike rriten.

II. Kombinimi i prodhimit të energjisë elektrike nga dy burime të rinovueshme të saj, siç janë dielli edhe uji është një mundësi shumë e mirë për të garantuar rritjen e efikasitetit në prodhim dhe për të rritur sigurinë e furnizimit të vendit me energji elektrike.

Rekomandim:

1.KESH në bashkëpunim MIE të vendos në funksion TEC-in e Vlorës, si një aset i kapitalizuar dhe shumë efektiv në situatën aktuale të krizës së energjisë elektrike, dhe në ekuilibër me ruajtjen e mjedisit e të gjenerimit të sigurt të energjisë elektrike.

Në vijimësi

4.2.1. A ka ndikuar në uljen e kostove të prodhimit të energjisë elektrike vendosja e burimeve alternative nga KESH?

I. Asetet gjeneruese hidrike:

Metodologjia e llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike është miratuar me vendimin nr. 28 date 24.06.2005 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit"

Objektivi i metodologjisë së llogaritjes së tarifave të gjenerimit është të sigurojë bazën ligjore për llogaritjen e komponentëve të kostos së gjenerimit, duke synuar në afatgjatë vendosjen e një kuadri rregullator për sektorin shqiptar të gjenerimit në përputhje me Traktatin për Komunitetin e Energjisë për Europën Juglindore (ECSEE). Llogaritja e kostos së gjenerimit nga asetet gjeneruese hidrike, bazohet në koston operacionale vjetore, ku përfshihet vlera e amortizimit vjetor dhe kostot e tjera operacionale.

Tabela nr.22. Elementet e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et

Viti	Njësia	2021	2022
1. Shpenzime Personeli	mije leke	1,530,828	1,382,201
2. Blerje materiale dhe produkte	mije leke	131,901	201,522
3. Shpenzime amortizimi dhe vlerësimi, humbje nga zhvlerësimi	mije leke	2,976,120	3,610,810
4. Furnitor dhe shërbime	mije leke	1,346,400	1,133,989
5. Shpenzime të tjera operative	mije leke	104,971	18,126
6. Te ardhura financiare	mije leke	135,099	135,008
7. sasia e energjisë në treg	MWh	3,975,497	3,989,395
8. Kosto (1+2+3+5+6)/7	Lek/KWh	1.57	1.62

Burimi: Llogaritja dhe përpunimi nga KESH

II. Aseti gjenerues PV:

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe paraqitura nga ana e shoqërisë, kosto e gjenerimit për impiantin fotovoltaik vlerësuar mbi bazën LCOE (Levelized Cost of Energy (LCOE) e cila mat kostot për energjinë e pritshme të prodhuar gjatë jetës së asetit. PV në digën e HEC-it të Vaut të Dejës ka filluar të prodhojë energji elektrike në Maj 2022.



Kostoja e prodhimit të energjisë elektrike llogaritet bazuar në koston aktuale të ndërtimit të asetit (Capex) dhe koston së operimit të tij përgjatë jetës së pritshme.

Referuar, për LCOE reale të PV Diga Qyrmaq me fuqi 5,143 MWp, vlera CAPEX sipas kontratës me zbatuesin e projektit është 468,004,500 ALL.

Konvertuar në EUR me kursin e këmbimit 1 EUR = 123.57 ALL, rezulton vlera e CAPEX me 3,787,363 EUR.

Për sa më lart, kostoja e prodhimit të energjisë nga PV është 56,8 Euro/MWh.

Tabela nr.23. Llogaritja e koston së prodhimit nga PV

Calculated LCOE (EUR/MWh)	
Plant Capacity (in MW)	5,143
CAPEX (in EUR)	3,787,363
Plant Activity (Lifetime in year)	25
WACC (%)	8.0
Cf (Capacity Factor in %)	15.5
Production during first year (MWh)	6.987
Efficiency yearly Production Degradation (in %)	5
Average O & M Cost (in EUR)	30,858
LCOE (Euro/MWh)	56,8

Burimi: Llogaritja dhe përpunimi nga KESH

III. Aseti gjenerues termik

Shoqëria KESH sh.a. parashikon që në vitin 2023, të vendos në pune asetin gjenerues termik të përkohshëm në zonën e Triportit Vlorë, në afërsi të TEC Vlora.

Ky aset gjenerues do të përdorë lëndën djegëse hidrokarbur të llojit HFO.

Aseti gjenerues është kontraktuar nga KESH në formën e qirasë financiare së bashke me operimin dhe mirëmbajtjen.

Aseti ka një kapacitet të instaluar prej 114 MWh, të përbërë nga 19 motorë me djegie të brendshme me kapacitet gjenerues prej 6 MWh/motor.

Faktori i kapacitetit është llogaritur në jo më pak se 0.85.

TEC-lundruet i Vlorës sipas përlllogaritjeve të KESH, ka një kosto gjenerimi të llogaritur fikse për dy vite prej 202 Euro/MWh duke përjashtuar akcizën dhe taksat.

Në tabelën nr.24 paraqiten të dhëna financiare në lidhje me zërat e kostove direkte dhe indirekte si dhe taksat ponteciale. Kosto ditore sipas marrëveshjes dypalëshe e këtij asetit është 63 mijë\$ /ditë+31.500 \$ /ditë³⁸.

Tabela nr.24. Kosto e prodhimit të energjisë elektrike nga Tec-i lundruet

Emërtimi	Çmimi USD/Ton	Vlera lek/ton	Vlera lek/kg	Densiteti	vlera lekë/l	vlera euro/l
LENDA DJEGESE						
Bursa FOB VLSFO 0.5% Squfur	565	61,020	61.02			
Premio	70	7,560	7.56			
Çmimi blerjes			68.58	0.98	67.21	0.57

³⁸ për mirëmbajtjen (SLA)



Akciza					37	0.32
Takse karboni					3	0.03
Takse qarkullimi					5	0.04
Magazininim shkarkimi euro/ton	18	2,106				0.02
Mazhi fitimit furnizues	103	12,000			12	0.12
Çmimi pa akcize, pa Taksa					83.34	0.71
Çmimi me taksa pa akcize						0.76
Çmimi me taksa me akcize					124.21	1.08
TVSH					24.84	0.21
Çmimi me TVSH					149.1	1.29
Konsumi për MWh (Litra)						212
Çmimi pa akcize pa taksa (Euro/MWh)						151.01
Çmimi pa akcize (Euro/MWh)						161.76
Çmimi me akcize (Euro/MWh)						228.81
Kosto e Qirasë (\$/Dite)						63,000
Kosto e Operimit dhe Mirëmbajtjes (\$/Dite)						31,500
Kosto e qerases (çmimi/dite*full load/prodhim) \$/MWh						40.18
Kosto totale akcize me taksa (Euro/MWh)						191.19
Kosto totale pa akcize pa taksa (Euro/MWh)						201.94
Kosto totale akcize me taksa (Euro/MWh)						268.98

Burimi: Llogaritja dhe përpunimi nga KESH

4.3.A kanë qënë efektive masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe OSHEE Grup, KESH, OST për përballimin e krizës energjetike përgjatë vitit 2021-2022?

I. Në lidhje me emergjencën e sektorit të energjisë elektrike Qeveria Shqiptare ka mbështetur këtë sektor si në drejtim të rritjes së likuiditetit por dhe të përshtatjes me dinamizmin e zhvillimit të krizës duke gjeneruar një sërë aktesh nënligjore për të mbështetur këtë sektor të rëndësishëm strategjik, nga te cilat ato me kryesoret brenda periudhës objekt auditimi, janë renditur më poshtë:

1. Vendimi i Këshilli të Ministrave nr. 584, datë 08.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", ku ndër të tjera kërkohet që Shoqëritë "KESH" sh.a., "OST" sh.a. dhe "OSHEE Group" sh.a., të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë ngarkohet që të



sigurojë mekanizmat e duhur financiarë, me qëllim mundësimin e importit të energjisë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike.

2. Vendim nr. 620, datë 22.10.2021 "Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përbalimin e parandalimin e saj".

3. Vendim nr. 256, datë 29.4.2022 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike".

4. Vendim nr. 456, datë 29.6.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike".

5. Vendim nr. 705, datë 18.11.2021 "Për miratimin e garancisë shtetërore në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Bankës A. I. sh.a. e Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., për financimin e kapitalit punues, në kuadër të nevojave për import të energjisë";

6. Vendim nr. 706, datë 18.11.2021, "Për miratimin e garancisë shtetërore në favor të Bankës O. A. sh. a, për kontratën e kredisë ndërmjet Bankës O. A. sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a, për financimin e kapitalit punues, në kuadër të nevojave për import të energjisë.

7. VKM nr. 757 datë 09.12.2021, për ndryshimin e VKM Nr. 620/2021, ku Shoqëria KESH sh.a. ngarkohet me detyrimin për të furnizuar FSHU me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të saj. Për këtë qëllim KESH sh.a ka të drejtë të marrë me qira asete gjeneruese termike të energjisë, të shkëmbejë/depozitojë apo të kryejë transaksione shitblerjeje në tregun e lirë.

II. Financimi i sektorit elektroenergjistik.

Krahas akteve ligjore qeveria ka marre vendime për financimin e këtij sektori dhe konkretisht për KESH-in, pasqyrohet sa më poshtë vijon:

1. Në zbatim të VKM 620/2021 nga MFE është lëvruar në muajin Mars dhe Prill 2022 në llogarinë e KESH kredia me objekt "Për të siguruar likuiditetin e nevojshëm për kryerjen e pagesave për blerje energjie" prej **65 mln EUR**. Norma e interesit të kthimit të vlerës së huasë është 2.94%. Huaja do të shlyhet në 4 këste të barabarta, secili këst në vlerën prej 16,250,000 EUR, me këste vjetore prej pesë këstesh duke filluar nga data 01.10.2023 deri në 01.10.2026.

2. Nëpërmjet Aktit normativ nr.3 datë 12.03.2022, miratuar me Ligjin Nr. 31/2022, për sektorin e energjisë elektrike, në pikën 3 të nenit 3; KESH-it i është akorduar "Fondi prej 20 mld lekë."

Për sa më lart, me Vendim Nr.498, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave, në zbatim të Aktit Normativ Nr. 3, shoqëria KESH u mbështet në muajin Gusht 2022 me shumën prej 8 mld Lekë në formën e injektimit kapital. Kjo shumë është lëvruar në llogarinë e KESH në muajin Gusht 2022.

Tabela nr.25. I pritshmi i KESH për vitin 2022 në mije leke

Te ardhura gjithsej	29,491,911
Shpenzime gjithsej	55,586,435
Fitmi bruto	(26,094,524)
Injektivim kapitali	20,000,000
Hua	7,905,300
Totali	1,810,776

Burimi: KESH



Nga pjesa mbetur prej 12 mld lekë është lëvruar 8 mld lekë në Muajin Tetor 2022.

Ne total brenda periudhës së auditimit, Qeveria nëpërmjet instrumenteve financiar ka financuar KESH nëpërmjet huas me 65 mln euro dhe 16 mld lekë, në formën e injektimit kapital nga aksionari i vetëm (MIE).

Në kuadër të masave të marra OSHEE Grup sha së bashku me shoqëritë bija, përmes organeve vendimmarrëse respektive, ka ndërmarrë masat e mëposhtme:

1. Vendim Nr. 14, datë 15.11.2021 "Mbi miratimin e limitit të kredisë (overdraft) në vlerën 15 milion Euro me garanci sovraane pranë "R. B." sh.a për FSHU sh.a në cilësinë e kredimarrësit, miratimin si dorëzanës të shoqërisë "OSHEE Grup" sh.a dhe si bashkëkredimarrës të OSSH sh.a dhe FTL sh.a pranë R. B.. sh.a";

Miratim Asambleje i Vendimit nr. 14 me nr.8226/1 dt.17.11.2021.

2. Vendim Nr. 15, datë 15.11.2021 "Mbi miratimin e limitit të kredisë (overdraft) në vlerën 20 milion Euro me garanci sovraane pranë "I. S. B. sh.a për FSHU sh.a në cilësinë e kredimarrësit, miratimin si dorëzanës dhe/ose bashkëkredimarrës të shoqërisë "OSHEE Group" sh.a pranë "I. S. B. sh.a";

Miratim Asambleje i Vendimit nr. 15 me nr.8226/3 dt.17.11.2021

3. Vendim Nr. 16, datë 15.11.2021 "Mbi miratimin e limitit të kredisë (overdraft) në vlerën 20 milion Euro me garanci sovraane pranë "O. Bank" sh.a për FSHU sh.a në cilësinë e kredimarrësit, miratimin si dorëzanës dhe/ose bashkëkredimarrës të shoqërisë "OSHEE Grup" sh.a pranë "O. Bank";

Miratim Asambleje i Vendimit nr. 16 me nr.8226/2 dt.17.11.2021

4. Vendim Nr. 17, datë 15.11.2021 "Mbi miratimin e limitit të kredisë (overdraft) në vlerën 10 milion Euro me garanci sovraane pranë "Banka A.I." sh.a për FSHU sh.a në cilësinë e kredimarrësit, miratimin si dorëzanës dhe/ose bashkëkredimarrës të shoqërisë "OSHEE Group" sh.a pranë "Banka A.I." sh.a;

Miratim Asambleje i Vendimit nr. 17 me nr.8226/4 dt.17.11.2021

5. Vendim Nr. 18, datë 15.11.2021 "Mbi miratimin e limitit të kredisë (overdraft) në vlerën 16.5 milion Euro me garanci sovraane pranë "R. Bank" sh.a për OSSH sh.a në cilësinë e kredimarrësit, miratimin si dorëzanës të shoqërisë "OSHEE Group" sh.a dhe si bashkëkredimarrës të FSHU sh.a dhe FTL sh.a pranë R. Bank sh.a";

Miratim Asambleje i Vendimit nr. 18 me nr.8226/5 dt.17.11.2021

6. Vendim Nr. 19, datë 06.12.2021 "Mbi rinovimin e limitit të kredisë (overdraft) pranë T. Bank të OSHEE Group sh.a, FSHU sh.a, OSSH sh.a në cilësinë e kredimarrësit, rritjen e limitit të FSHU sh.a dhe miratimin e dorëzanëve të shoqërive "OSHEE Grup" sh.a, FSHU sh.a, OSSH sh.a dhe FTL sh.a pranë T. Bank sh.a";

Miratim Asambleje i Vendimit nr. 19 me nr. 8805/, date 10.12.2021

V. Mbështetje financiare për OSHEE

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 18.11.2021 "Për miratimin e garancisë shtetërore në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Bankës A. I. sh.a. e Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Grup sh.a., për financimin e kapitalit punues, në kuadër të nevojave për import të energjisë";

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 18.11.2021 Për miratimin e garancisë shtetërore në favor të Bankës O. A. sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Bankës O. A. sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Grup sh.a., për financimin e kapitalit punues, në kuadër të nevojave për import të energjisë

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 03.12.2021 "Për miratimin e garancisë shtetërore në favor të I. S. Bank sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet I. S. Bank sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit



Universal sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., për financimin e kapitalit qarkullues, në kuadër të nevojave për import të energjisë";

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 738, datë 03.12.2021 "Për miratimin e garancisë shtetërore në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet R. Bank sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a. Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)sh.a., për financimin e kapitalit punues, në kuadër të nevojave për import të energjisë";

Për sa më lart, OSHEE Group në bashkëpunim me qeverinë e Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar bankave të nivelit të dytë për financim. Për këtë arsye, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A. për përmirësimin e situatës financiare, kanë marrë vendimet e mëposhtme, të cilat i gjeni bashkëngjitur:

1. Vendimi Nr. 13, datë 10.11.2021 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A., "Mbi miratimin si bashkredimarrës të shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A., për limitin e kredisë (overdraft) të shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., në vlerën 15 milion euro me garanci sovraane pranë "R. Bank" SH.A.", miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 11.11.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "OSSH" Sh.A., "Mbi miratimin si bashkredimarrës të shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A., për limitin e kredisë (overdraft) të shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., në vlerën 15 milion euro me garanci sovraane pranë "R. Bank" SH.A.".

2. Vendimi Nr. 14, datë 10.11.2021 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A., "Mbi miratimin e limitit të kredisë (overdraft) në vlerën 16.5 (gjashtëmbëdhjetë pikë pesë) milion euro me garanci sovraane pranë "R. Bank" sh.a., për shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A., në cilësinë e kredimarrësit", miratuar me Vendimin Nr. 14, datë 11.11.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "OSSH" Sh.A., "Mbi miratimin e limitit të kredisë (overdraft) në vlerën 16.5 (gjashtëmbëdhjetë pikë pesë) milion euro me garanci sovraane pranë "R. Bank" sh.a., për shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A., në cilësinë e kredimarrësit".

VI. Konsumi i energjisë elektrike për 9 mujorin e parë 2022

Ne kushtet e krizës së energjisë elektrike një nga masat eficente për përballimin e blerjes së energjisë së domosdoshme në tregjet ndërkombëtare është dhe ulja e konsumit të përgjithshëm të energjisë. Bazuar në evidencën dokumentare të grupit të KLSH të përcjell nga OST mbi vlerat e konsumit të përgjithshëm në vend sipas muajve të cilat pasqyrojnë totalin e konsumit si atë të transmetuar për OSHEE por edhe për klientët e kualifikuar, pra në vetvete përbejnë konsumin total në vend.

Nga analizimi i të dhënave duke filluar nga muaji prill 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021 kemi një rënie të konsumit të energjisë elektrike gjë që beri që shoqëritë të blejnë me pak energji dhe duke ruajtur vlerat e nivelit të Fierzës në drejtim të menaxhimit të rezervës hidrike.

Tabela nr.26. Konsumi total i energjisë elektrike

(në MWh)

VITI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	SHUMA VJETORE
2019	735,982	588,395	604,655	546,419	534,409	550,081	597,607	633,584	530,409	509,656	522,917	649,950	7,004,064
2020	712,634	617,343	583,411	479,222	489,952	506,902	579,118	592,735	545,133	553,335	616,579	718,383	6,994,749
2021	735,306	626,143	670,530	619,700	546,824	570,076	664,188	690,609	568,095	590,354	618,430	755,361	7,655,615
2022	758,687	669,019	720,505	576,329	537,756	573,269	625,956	613,326	491,551	-	-	-	5,566,397

Burimi: OST, përpunimi nga grupi i KLSH



Tabela nr. 27. Niveli i rënies së konsumit të energjisë elektrike 2022

PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR
7.0%	1.7%	0.6%	5.8%	11.2%	13.5%

Burimi: OST, përpunimi nga grupi i KLSH

Në tabelën nr. 27 paraqitet niveli i rënies së konsumit të përgjithshëm i cili ka filluar prej muajit prill 2022 me 7% dhe duke vazhduar dhe kapur amplitudën në muajin shtator 2022 me një rënie me 13.5% kundrejt shtatorit të 2021.

Rënia me e vogël është në muajin Shtator, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 nga ku rezulton me **13%** të rënies së konsumit.

Kjo tregon që fushata sensibilizuese nga shoqëritë elektroenergjitike dhe qeveria kanë rezultuar efektive në këtë drejtim.

VII. Fasha konsumatore-Segmenti familjar

Grupi i auditimi si gjatë fazës studimore dhe të terrenit, analizoj të dhënat në lidhje me numrin e abonentëve sipas fashave me sekuenca ndryshimi 100 kWh. Grupi i KLSH për vet sensibilitetin që ka konsumi brenda fashës 800 KWH, për qytetarët shqiptar analizoj numrin e abonentëve që kalojnë fashën 800 KWh, pra nr. e abonentëve sipas segmentit familjar "801-900"; "901-1000" dhe mbi 1001 KWh. Rezultatet e përpunimit të dhënave paraqiten në tabelën nr. 28.

Tabela nr. 28. Abonentët aktiv me konsume mbi 800 KWh/muaj për vitin 2021

2021	Nr. Abonenteve per fashat			% e nr. Abonenteve kundrejt nr. Total			Totali i abonentëve me konsum mbi 800 KWH		Totali i abonentëve
	"801_900"	"901_1000"	">1001"	% e "801_900"	% e "901_1000"	% e ">1001"	Nr.	%	
Janar	20,306	13,535	34,018	1.9%	1.2%	3.1%	67,859	6.2%	1,086,889
Shkurt	20,180	13,638	37,535	1.9%	1.3%	3.5%	71,353	6.6%	1,087,506
Mars	17,561	11,627	30,372	1.6%	1.1%	2.8%	59,560	5.5%	1,087,698
Prill	13,666	9,016	19,587	1.3%	0.8%	1.8%	42,269	3.9%	1,088,151
Maj	5,140	3,471	9,445	0.5%	0.3%	0.9%	18,056	1.7%	1,089,614
Qershor	4,357	2,581	6,923	0.4%	0.2%	0.6%	13,861	1.3%	1,090,600
Korrik	7,453	5,041	12,246	0.7%	0.5%	1.1%	24,740	2.3%	1,092,575
Gusht	8,816	5,215	14,259	0.8%	0.5%	1.3%	28,290	2.6%	1,094,473
Shtator	3,978	2,767	6,800	0.4%	0.3%	0.6%	13,545	1.2%	1,096,173
Tetor	4,967	3,526	7,925	0.5%	0.3%	0.7%	16,418	1.5%	1,097,543
Nentor	7,616	4,610	11,182	0.7%	0.4%	1.0%	23,408	2.1%	1,099,158
Dhjetor	24,572	17,502	47,676	2.2%	1.6%	4.3%	89,750	8.2%	1,100,170

Burimi: FSHU, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi rezulton se:


Në vitin 2021 në segmentin familjar në total janë mesatarisht 1,092,546 abonentë aktiv të regjistruar në FSHU.

Grupi i auditimit i KLSH kërkoj të dhëna nga FSHU mbi numrin e abonentëve dhe konsumin e energjisë elektrike për segmentin familjar jo në nivel mesatar, por nr. e abonentëve sipas muajve pasi një variabël i rëndësishëm është konsumi mujor familjar cili ndryshon nga muaj në muaj dhe si rrjedhim rrit apo zvogëlon numrin respektiv të abonentëve në një muaj.

Në aneksin nr.3., gjendet i plotë konsumi dhe numri i abonentëve për vitin 2021 dhe 2022 të ndarë sipas muajve për të gjitha fashat e konsumit të energjisë elektrike në KWh.



Grafiku nr.3. % e familjeve që konsumojnë më shumë se 800 KWh/muaj-2021



Burimi: FSHU, përpunimi grupi i KLSH

Po t'i referohemi tabelës se mësipërme për numrin e abonentëve familjar që kalojnë fashën prej 800 KWh, shihet se në muajin dhjetor 2021 numri total i abonentëve mbi këtë fashe konsumi ishte 89,750 abonentë familjare ose thënë ndryshe 8.2 % e totalit të abonentëve.

Tabela nr. 29. Abonentët aktiv me konsume mbi 800 KWh/muaj për vitin 2022


2022	Nr. Abonenteve per fashat			% e nr. Abonenteve kundrejt nr. Total			Totali i abonenteve me konsum mbi 800 KWH		Totali I Abonenteve
	"801_900"	"901_1000"	">1001"	"801_900"	"901_1000"	">1001"	Nr.	%	
Janar	25,602	18,707	54,637	2.3%	1.7%	5.0%	98,946	9.0%	1,100,703
Shkurt	20,610	15,128	39,144	1.9%	1.4%	3.5%	74,882	6.8%	1,102,989
Mars	20,865	15,106	37,829	1.9%	1.4%	3.4%	73,800	6.7%	1,104,299
Prill	9,290	5,919	14,256	0.8%	0.5%	1.3%	29,465	2.7%	1,105,261
Maj	3,996	2,743	6,997	0.4%	0.2%	0.6%	13,736	1.2%	1,106,274
Qershor	4,347	2,670	7,337	0.4%	0.2%	0.7%	14,354	1.3%	1,108,273
Korrik	6,997	4,540	11,392	0.6%	0.4%	1.0%	22,929	2.1%	1,109,513
Gusht	6,442	4,193	12,007	0.6%	0.4%	1.1%	22,642	2.0%	1,111,917
Shtator	3,407	2,301	7,439	0.3%	0.2%	0.7%	13,147	1.2%	1,115,693

Burimi: FSHU, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

Nga krahasimi i konsumit parashikohet që edhe në Dhjetor 2022 të ruhet trendi i abonentëve në segmentit mbi 800 KWh, pra parashikohet që numri i abonentëve të jetë mbi 8 % të totalit të abonentëve të 2022³⁹.

³⁹ Numri mesatar i abonentëve familjar deri në Shtator 2022 është 1,107,214

Grafiku nr. 4. % e familjeve që konsumojnë me shume se 800 KWh/muaj-2022



Burimi: FSHU, përpunimi grupi i auditimit të KLSH

4.3.1 A janë optimizuar shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar përgjatë vitit 2021 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2022 nga shoqëritë OSHEE, OST dhe KESH?

Shoqëria⁴⁰ FTL SH.A. me detyrimin e shërbimit publik nder te tjera ka kryer blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe sigurimin e sasisë së energjisë elektrike të nevojshme për plotësimin e kërkesës së klientëve tariforë.

Referuar Rregullave të përkohshme të tregut Shqiptar të energjisë elektrike miratuar nga ERE me vendimin nr.139 date 15.08.2016, specifikisht Shtojcës A, si dhe në përputhje me marrëveshjet nr.93 date 16.12.2019 "Për pjesëmarrjen në treg "nënshkruar ndërmjet palëve KESH dhe OST, shoqëritë publike OST, FTL dhe KESH ka detyrimin të njoftoj kontratën tek OST tek DOT (Drejtoria e Operimit të Tregut) informacion për çdo kontratë shitje/blerje që ato kanë kryer.

Shoqëria FTL bazuar në kontratën për shitblerjen e energjisë elektrike midis shoqërive FTL sh.a - FSHU sh.a siguron energjinë e pa plotësuar nga shoqëria e prodhimit KESH sh.a në treg të parregulluar për mbulimin e kërkesës së klientëve fundorë si dhe bazuar në kontratën për shitblerjen e energjisë elektrike midis shoqërive FTL sha -OSH sh.a. siguron energjinë e pa plotësuar nga burimet e rinovueshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Procedura e prokurimit të shitblerjes FTL i kryen në platformën elektronike.

OST zhvillon procedurën e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit. Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, është miratuar me vendimin nr.103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE.

⁴⁰ VKM Nr. 244, datë 30.3.2016 "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar



Kjo në përputhje me nenin Neni 62. Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit, shërbimet e balancimit dhe shërbimet ndihmëse, Pika 1 dhe 2, të Ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike". Bazuar në këtë rregullore çdo pjesëmarrës tregu i cili kërkon të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të energjisë organizuar nga OST sh.a. duhet të paraqesë dokumentacion ligjor dhe administrativ të përcaktuara në nenit 11, të vendimit të ERE nr. 103, datë 23.06.2016, i ndryshuar. Më pas shqyrtimit të dokumentacionit, në bashkëpunim me Departamentin Ligjor dhe Çështjeve korporative, pranohen subjekte të cilat i plotësojnë kërkesat ligjore të kërkuara dhe iu jepet akses në Modulin Network Losses të platformës elektronike DAMAS.

Shoqëria KESH në procedurat e shitblerjes bazohet në rregulloren e miratuar me vendimin nr.5233/1 date 12.06.2019 e Asamblesë së përgjithshme të aksionarit. Objekti i kësaj rregullore është të mundësojë shoqërisë zhvillimin e aktivitetit tregtar në sektorin e energjisë elektrike. Në zbatim të nenit 13-dispozitat kalimtare pika 12.1 Administratori urdhrin nr.121, date 06.12.2019 ka miratuar Manualin "Mbi procedurën e tregtimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a". Procedurat e shitblerjes nga KESH për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar jo në një platformë elektronike por me anën e një adrese e-mail trading@kesh.al

Përgjatë vitit 2021 shoqëritë publike të sektorit elektroenergjitik kanë kryer procedura të blerjes së energjisë elektrike nga importi nëpërmjet platformave/e-mail dhe rregulloreve të sipër cituara. Në tabelën nr.30 pasqyrohet aktiviteti vjetor i tyre për blerjen e energjisë elektrike për nevojat e tregut shqiptar të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2021 është importuar në total 1376120 MWh energji elektrike në vlerën totale 258,643,706 euro me një çmim mesatar 188 euro/MWh.

Procedurat e realizuar për blerjen nga importi të energjisë elektrike nga OSHEE grup përgjatë vitit 2021 për nevojat e OSSH, FSHU dhe FTL (35 KV).

OSHEE grup (FTL) në vitin 2021 ka importuar 1,131,422 MWh për 230,944,335.54 euro me çmim mesatar 204.1 euro/MWh.

Ndërkohë KESH në vitin 2021 ka importuar 54,194 MWh për 10,587,206 euro me çmim mesatar 195 euro/MWh, ndërsa OST ka importuar 190,504 MWh për 17,112,165 euro me çmim mesatar 90 euro/MWh.

Tabela nr. 30. Importi i energjisë elektrike për vitin 2021 nga sektori elektroenergjitik


Shoqëria	OST			FTL			Kesh			Total	
	Energji e Blere nga Import	Cmimi i blerjes nga Import	Vlera	Energji e Blere nga Import	Cmimi i blerjes nga Import	Vlera	Energji e Blere nga Import	Cmimi i blerjes nga Import Loti 1	Vlera		
Muaj	MWh	Euro/MWh	Euro	MWh	Euro/MWh	Euro	MWh	Euro/MWh	Euro	MWh	Euro
Janar	19,823	68	1,341,675	1,488	50.50	75,144	-	-	-	21,311	1,416,819
Shkurt	20,440	43	881,882	1,344	50.50	67,872	-	-	-	21,784	949,754
Mars	23,080	51	1,173,926	1,486	50.50	75,043	-	-	-	24,566	1,248,969
Prill	12,750	48	606,162	1,440	50.50	72,720	-	-	-	14,190	678,882
Maj	15,965	50	800,742	1,488	50.50	75,144	-	-	-	17,453	875,886
Qershor	18,395	53	973,242	1,440	50.50	72,720	510	69.47	35429.7	20,345	1,081,392
Korrik	14,485	65	945,076	58,577	107.64	6,305,372	5,608	86.18	483306.5	78,670	7,733,755
Gusht	15,190	81	1,237,148	245,448	128.18	31,462,159	3,158	101.01	318993.62	263,796	33,018,301
Shtator	12,718	84	1,068,518	271,448	164.98	44,784,765	2,140	144.65	309551.4	286,306	46,162,835
Tetor	10,322	165	1,702,413	258,470	265.71	68,678,269	3,627	175.44	636334.25	272,419	71,017,016
Nentor	10,829	204	2,214,053	278,673	276.45	77,039,160	9,787	190.11	1860563.56	299,289	81,113,776
Dhjetor	16,507	252	4,167,327	10,120	220.95	2,235,967	29,364	236.45	6943026.48	55,991	13,346,321
Totali	190,504		17,112,165	1,131,422		230,944,335.54	54,194		10,587,206	1,376,120	258,643,706

Burimi: KESH, OST, OSHEE grup, përpunimi nga grupi i KLSH

Për sa referohet në tabelën 30, 31 sektori elektroenergjitik ka importuar për vitin 2021 dhe 6 mujorin e pare 2022 në total **659,982,839 euro**.



Grafiku nr. 5. Vlera financiare e importit te energjisë elektrike 2021




Burimi: KESH, OST, OSHEE grup, përpunimi nga grupi i KLSH

Tabela nr. 31. Importi i energjisë elektrike për vitin 2022 nga sektori elektroenergjitik

Shoqëria	ost			FTL			KESH			Total	
	Sasia e energjisë	Cmimi i blerjes	Vlera	Sasia e energjisë	Cmimi i blerjes	Vlera	Sasia e energjisë	Cmimi i blerjes	Vlera		
Muaj	MWh	Euro/MWh	Euro	MWh	Euro/MWh	Euro	MWh	Euro/MWh	Euro	MWh	Euro
Janar	14,270	258.01	3681820.2	43,344	254.3	11,022,364	137,750	237.23	32,677,830	195,364	47,382,015
Shkurt	15,648	234.51	3669592.09	4,032	230.6	929,658	209,736	230.35	48,311,804	229,416	52,911,054
Mars	16,507	336.06	5547382.22	4,458	230.6	1,027,881	165,655	237.90	39,408,783	186,620	45,984,046
Prill	9,842	238.13	2343657.53	4,320	230.6	996,062	44,328	209.62	9,291,903	58,490	12,631,623
Maj	9,480	228.93	2170215.82	-	-	-	76,864	210.57	16,184,915	86,344	18,355,131
Qershor	6,537	252.05	1647627.36	-	-	-	119,713	231.37	27,698,313	126,250	29,345,941
Korrik	-	-	-	-	-	-	173,781	436.10	75,785,124	173,781	75,785,124
Gusht	-	-	-	-	-	-	120,750	484.54	58,507,806	120,750	58,507,806
Shtator	-	-	-	-	-	-	126,036	479.52	60,436,394	126,036	60,436,394
Tetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Nentor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	72,284		19,060,295	56,154		13,975,966	1174613.00		368302872.36	1,303,051	401,339,133

Burimi: KESH, OST, OSHEE grup, përpunimi nga grupi i KLSH

Grafiku nr.6. Vlera financiare e sasisë te importuar për vitin 2022



Burimi: KESH, OST, OSHEE grup, përpunimi nga grupi i KLSH



Siç shihet nga krahasimi mes 2021 dhe 6-mujorit te pare te 2022, vlera e importit është rritur ndjeshëm, dhe ne 6 mujorin e pare te 2022, është 156% me madhe sesa vlera e importi total te 2021.

Planifikimi i fashave orare për të optimizuar blerjen e energjisë elektrike nga importi.

Nga auditimi rezulton se planifikimi apo zgjedhja e ditës dhe fashës orare për blerjen e energjisë elektrike ngelet një problematikat e trashëguara dhe si e tillë këto shoqëri duhet te rrisin nivelin e kapaciteteve te burimeve njerëzore qe kane për objekt te veprimitarisë se tyre zgjedhjen optimale te fashës orare të blerjes apo shitjes, pasi zgjedhja e duhur ka ndikim ne optimizimin e shpenzimeve te këtyre shoqërive pasi përcaktimi sipas një modeli statistikor te studiuar mund te rezultojë në blerjen e energjisë elektrike me çmim me te ulet ne krahasim me fashat e përzgjedhura.

Për te pasqyruar rëndësinë e një planifikim te mire dhe të studiuar por analizojmë përcaktimin e fashës orare te lotit 2 te procedurës se prokurimit P.sh. marrim rastin e blerjes se energjisë elektrike nga FTL për periudhën 11-17 tetor 2021.

Përzgjedhja e kësaj procedure ka për qëllim ilustrativ në lidhje me përcaktimin e fashës orare, pasi kjo procedure është realizuar sipas parashikime ligjore dhe për më shumë që loti 2 është anuluar nga komisioni i blerjeve te FTL.

I. Hapat e ndjekura.

1. Ne tabelën e mëposhtme paraqitet kërkesa e përlogaritur nga sektori i tregimit pranë FTL.

Datat	MWh (24h)	1:00	2:00	3:00	4:00	5:00	6:00	7:00	8:00	9:00	10:00	11:00	12:00	13:00	14:00	15:00	16:00	17:00	18:00	19:00	20:00	21:00	22:00	23:00	0:00
11.10.21	13,719	375	340	325	321	329	370	487	652	690	693	675	669	654	664	659	652	656	679	754	780	727	637	522	409
12.10.21	13,548	353	319	302	298	305	341	456	619	679	686	673	675	666	669	663	653	656	682	758	779	730	638	528	420
13.10.21	13,748	369	328	309	303	310	348	464	628	684	686	676	687	677	679	667	661	667	691	769	793	744	655	533	420
14.10.21	13,548	353	319	302	298	305	341	456	619	679	686	673	675	666	669	663	653	656	682	758	779	730	638	528	420
15.10.21	13,547	355	322	305	299	305	340	451	607	678	695	684	689	679	670	663	659	659	680	745	773	719	634	522	414
16.10.21	13,549	357	321	304	300	307	342	436	584	680	702	697	712	700	688	670	647	649	674	737	767	712	626	520	417
17.10.21	13,251	360	323	304	298	303	331	400	529	633	665	668	684	680	660	627	608	621	655	733	799	753	660	535	422

2. Në bazë të planifikimit dhe konfirmimit të prodhimit ditore nga KESH sasia mesatare ditore e kërkuar nga FTL është 13,559 MWh.

3. KESH ka konfirmuar me e-mail volumin e energjisë për furnizim sipas kërkesës së FTL, për periudhën 13- 21 Tetor 2021, KESH do të gjenerojë 6,000 MËh/ditë për nevojat e konsumatorëve fundore.

4. Pra FTL duhej të planifikonte për të prokuruar sasinë (13,559-6,000=7,559 MWh).

5. FTL prokuroi sipas profilit të mëposhtëm në 2 lote.

Loti 1. – Fasha orare e përzgjedhur nga FTL

Datat	MWh (24h)	1:00	2:00	3:00	4:00	5:00	6:00	7:00	8:00	9:00	10:00	11:00	12:00	13:00	14:00	15:00	16:00	17:00	18:00	19:00	20:00	21:00	22:00	23:00	0:00	
13.10.21	6,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250
14.10.21	6,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250
15.10.21	6,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250
16.10.21	6,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250
17.10.21	6,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250

Loti 2- Fasha orare e përzgjedhur nga FTL

Datat	MWh (24h)	1:00	2:00	3:00	4:00	5:00	6:00	7:00	8:00	9:00	10:00	11:00	12:00	13:00	14:00	15:00	16:00	17:00	18:00	19:00	20:00	21:00	22:00	23:00	0:00	
13.10.21	2,880								180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	
14.10.21	2,880								180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	
15.10.21	2,880								180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	
16.10.21	2,880								180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	
17.10.21	2,880								180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	180	

Në këtë procedurë FTL ka planifikuar (6,000+2,880=8,880 MWh në ditë), nga ku rezulton se sektori



i tregtimit te FTL ka planifikuar dhe prokuruar më shumë se kërkesa me 1,321 MWh.

6. N.q.s. marrim për reference çmimet e bursës HUPX të javës pasardhëse, konkretisht e Mërkurë datë 6 deri te Dielën datë 10 Tetor 2022, çmimi i bursës HUPX në profilin 07-23 është realizuar ne vlerën 232,32 Euro/MWh.

Potencialisht kostoja e blerjes do të ishte **3.345.408 Euro** (14,400 * 232,32).

Kjo është tabloja e parë që ka sektori i planifikimit në FTL.

II. Për sa më lart, grupi i auditimit të KLSH për te demonstruar rëndësinë që ka përcaktimi i fashës orare lotin 2 e ndau ne dy lote, përkatësisht Loti 2 (opsional) dhe loti 3 (opsional), siç paraqiten më poshtë:

Loti 2 – (opsional)

Datat	MWh (24h)	1:00	2:00	3:00	4:00	5:00	6:00	7:00	8:00	9:00	10:00	11:00	12:00	13:00	14:00	15:00	16:00	17:00	18:00	19:00	20:00	21:00	22:00	23:00	0:00	
13.10.21	1,560							130	130	130	130	130	130	130	130	130	130								130	130
14.10.21	1,560							130	130	130	130	130	130	130	130	130	130								130	130
15.10.21	1,560							130	130	130	130	130	130	130	130	130	130								130	130
16.10.21	1,560							130	130	130	130	130	130	130	130	130	130								130	130
17.10.21	1,560							130	130	130	130	130	130	130	130	130	130								130	130

1.N.q.s. marrim për reference çmimet e bursës HUPX të realizuara të javës pasardhëse, konkretisht e Mërkurë date 6 deri te Dielën date 10 Tetor 2022, çmimi i bursës HUPX në profilin 06-16 & 22-23 është në vlerën **211,89 Euro/MWh.**

Sasia për lotin 2 (opsional) është 7,800 MWh.

Kosto Blerje (duke marrë si referencë çmimin HUPX); (7880 * 211,89 = 1.669.693 Euro).

Loti 3-(opsional)

Datat	MWh (24h)	1:00	2:00	3:00	4:00	5:00	6:00	7:00	8:00	9:00	10:00	11:00	12:00	13:00	14:00	15:00	16:00	17:00	18:00	19:00	20:00	21:00	22:00	23:00	0:00	
13.10.21	1320											220	220	220	220	220	220									
14.10.21	1320											220	220	220	220	220	220									
15.10.21	1320											220	220	220	220	220	220									
16.10.21	1320											220	220	220	220	220	220									
17.10.21	1320											220	220	220	220	220	220									

2. N.q.s. marrim për referencë çmimet e bursës HUPX të realizuara të javës paraardhëse, konkretisht e Mërkurë date 6 deri te Dielën date 10 Tetor 2022, çmimi I bursës HUPX ne profilin 10-16 ishte realizuar në vlerën 207,92 Euro/MWh.

Sasia për lotin 3 (opsional) do te jete 6,600 MËH. Kosto Blerje do te ishte 1.372.272 Euro (6,600 * 207,92).

3. Pra sipas planifikimit te grupit te KLSH sasia prej 14400 MWh që përbën shumen totale te Lotit 2&3 (opsional) do te mund te blihej ne shumën **3.041.965 Euro.**

4. Në referim me përzgjedhjen e fashës orare nga sektori i tregtimit te FTL dhe ato te supozuara nga grupi i KLSH kemi një diference prej 303,443 Euro çka tregon që shoqëria gjate planifikimit mund të shpenzonte 303,443 Euro me pak.

III. Grupi i KLSH e pa këtë variant edhe në "Post factum" pasi çmimet HUPX i përkisnin periudhës së realizuar, pra hipotezën e pare te parashikuar ne lidhje me shpërndarjen e fashës orare në dy lote atë 2&3 (opsional) ta testojmë me çmimet e realizuara në bursën HUPX.

Planifikimi i sasisë prej 14,400 MWh nga sektori i tregtimit te FTL, duke ju referuar çmimit HUPX për periudhën 13-17 Tetor në profilin 07-23 rezultoi me 223,14 euro/MWh. Nëse FTL do të realizonte procedurën e blerjes se Lotit 2, për sasinë 14400 MËH do te shpenzonte **3,213,216 euro**⁴¹ (14,400 * 223,14).

⁴¹ Shënim: Në përllogaritje janë marre vetëm vlerat e bursës hungareze HUPX



1. Për lotin 2 (opsional), Çmimi HUPX për periudhën 13-17 Tetor në profilin 06-16 & 22-23 rezultoi 204 Euro/MWh. Kosto Blerje sipas këtij profili do të ishte 1,607,520 Euro (7,880 * 204).
 2. Për lotin 3 (opsional), Çmimi HUPX për periudhën 13-17 Tetor profili 10-16 rezultoi 194,56 Euro/MWh. Kosto Blerje sipas këtij profili do të ishte 1.284.096 Euro (6600*194,56).
- Totali i shpenzimeve për Lotin 2&3 (opsional) për sasinë 14,400 MWh do të ishte 2,891,616 Euro. Në referim të ngjarjes së ndodhur pra të çmimeve ne HUPX pasi ka kaluar kjo periudhe kohore pra pas periudhës 13-17 tetor, nëse sektori i tregtisë se FTL do të kishte planifikuar profilet orare te lotit 2 si ato te përzgjedhura nga grupi i KLSH do të shpenzonte 321,600 Euro më pak.

Gjetje:

Për sa më lart, nga përzgjedhja rastësore e një procedure blerjeje nga një prej shoqërive të sektorit të energjisë elektrike tregon rëndësinë që ka planifikimi optimal i profilit dhe fashës orare, pasi planifikimi i gabuar i tyre nuk mundëson optimizimin e shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike duke rritur shpenzimet dhe kostot e blerjes së energjisë elektrike.

Konkluzion:

Për sa më lart, analizimi i opsionit te lotit 2 gjate planifikimit nga ana e FTL është demonstrativ pasi nga auditimi I kësaj procedure loti 2 është anuluar dhe gjithë arsyetimi shërben vetëm qe sektori përkatës pranë FTL te bej një studim me te hollësishëm me variante dhe skenar te ndryshëm për te optimizuar blerjen e energjisë elektrike. Nëse FTL nuk do të kishte planifikuar për lotin 2, profilin 07-23, por do të zgjidhte profilin 06-16 (loti 2-opsional) & 22-23 (loti 3-opsional) diferenca midis hipotezës së planifikimit të një jave më pare "*ex ante*" me atë ndodhur "*post factum*" do të ishte 18,157 euro (321,600-303,443). Kjo tregon qe hipoteza e hedhur nga grupi i KLSH duke patur një shmangie prej 0.59% ose 0.0060 nga vendosja e fashave hipotetike te përzgjedhura, tregon qe do ishte ngjarje e sigurt me një probabilitet të lartë që të ndodhte.

Rekomandim:

Administratorët e OSHEE grup dhe KESH-it duhet të ngrenë pranë shoqërive të tyre sektor të analizës së tregut për planifikimin, përcaktimin dhe zgjedhjen e profilit dhe fashave orare sipas modeleve statistikore për të optimizuar shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike nëpërmjet procedurave të shitblerjes.

Në vijimësi

4.3.2. A janë ndërmarrë masa dhe procedura efektive për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sistemit energjetik?

Vlerësimi i performancës së detyrimeve të ndërsjella KESH–OST–OSHEE Grup, nga grupi i auditimit të KLSH ka një fokus te veçantë. Për vete rëndësinë e vlerësimit e tyre dhe masave te marra nga sektori qe këto detyrimi te zvogëlohen dhe ne një të ardhme të shkojnë drejt vlerave minimale, pasi sektori i energjetikës, për faktin se është një sektor strategjik, ka përfituar herë pas here financime nga buxheti i shtetit për daljen nga kriza financiare, duke rritur shpenzimet buxhetore dhe për pasojë ka ulur mundësinë për më shumë investim në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, etj.

Nga auditimi i evidencës mbështetëse te administruar nga grupi i KLSH, detyrimet e OSHEE grup kundrejt OST kane ardhur nga:

Disbalanca sistemim 2016-2017 në shumen 5,203,247.22 EURO sipas faturave të lëshuara nga OST për OSHEE në zbatim të vendimit të ERE Nr. 110, datë 14.05.2018, dërguar pranë OSHEE me shkresën Nr. 4003, datë 31.05.2018.



OSHEE me shkresën Nr. 10615/1, datë 11/06/2018 ka kthyer pa veprim faturat dhe ka ndjekur rrugë gjyqësore për kontestimin e vendimit të lartpërmendur.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 3851, datë 29.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së OSHEE-së si të pabazuar në ligj dhe në prova.

OSHEE ka apeluar vendimin dhe çështja vijon të jetë në gjykim.

OST me kërkesë-padinë Nr. 7475, datë 31.10.2018, ka kërkuar njohjen e detyrimit nga OSHEE dhe pagesën e faturave.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, (me kërkesë të palës paditur OSHEE), Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 3809, datë 13.03.2019 vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se padia e OST-së është mbështetur në vendimin Nr. 110, datë 14.05.2018 të ERE, çështja nuk mund të zgjidhet pa u zgjidhur më parë në Gjykatën Administrative të Apelit me vendim të formës së prerë.

Në referim të rakordimit midis OSHEE dhe OST deri më datë 31.12.2021, totali i detyrimeve neto të OSHEE grup është 16,512,930,669 lekë.

Pasqyra e plotë e këtij detyrim gjendet në aneksin nr. 4.

Sipas rakordimit midis OSHEE me KESH detyrimi i OSHEE është **47,026,871,427 lekë**. Pasqyra e plot e këtij detyrimi gjendet në aneksin nr.

Gjetje:

Shoqëritë publike të sektorit energjetik e kanë detyrim ligjor respektimin e marrëveshjeve mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Lindja dhe akumulimi i detyrimeve financiare të ndërsjella KESH-OSHEE-OST, ka ardhur si rezultat i moszbatimit të procedurave ligjore, të cilat janë materializuar nëpërmjet marrëveshjeve të pranuar nga këto shoqëri.

Marrëdhëniet ndërmjet shoqërive KESH, OST dhe OSHEE janë rregulluar nga marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet këtyre subjekteve dhe konkretisht:

Operatori i Shpërndarjes nuk i ka respektuar këto marrëveshje të miratuara nga ERE kundrejt KESH dhe OST, duke iu krijuar këtyre të fundit vështirësi për ushtrimin normal të aktivitetit të tyre.

Këto marrëveshje janë shkelur konkretisht: për fatura furnizimi energjie elektrike të lëshuara nga KESH që nuk njihen/pranohen nga OSHEE; fatura për kamatëvonesa në pagesa të lëshuara nga KESH që nuk njihen/pranohen nga OSHEE; mos shlyerje e detyrimeve të OSHEE ndaj KESH për huat afatgjata; mos shlyerjen e detyrimit të OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, etj.

Në Ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara", të ndryshuar me Ligjin nr. 24/2015 "Për një shtesë në Ligjin nr. 48/2014 'Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare'", është parashikuar si përjashtim nga zbatimi i këtij ligji detyrimet që rrjedhin nga shitja, blerja dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, pa përfshirë pagesat që kryhen në tregun e parregulluar, sipas përcaktimeve të rregullave të tregut të energjisë elektrike".

Konkluzion:

Për sa më lart, mosrespektimi i marrëveshjeve dhe procedurave ligjore nga ana e kompanive, ka sjellë akumulimin dhe rritjen e detyrimeve të ndërsjella, të cilat i kanë venë në vështirësi këto shoqëri të operojnë në kushte normale për realizimin e misionit të tyre.

Në lidhje me reduktimin e detyrimeve të ndërsjella Ministria e Financave dhe ekonomisë së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë nxjerre urdhrin përbashkët nr.304 date 17.12.2020 për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike.

Trajtimi i detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë ka qenë një proces sfidues për shkak të nivelit të lartë të detyrimeve të trashëguara dhe akumulimit të detyrimeve të reja. Procesi i konsolidimit të detyrimeve të mbartura është menaxhuar përmes një marrëveshjeje ristrukturimi afatgjatë mes kompanive. Si rezultat i zbatimit të reformës në sektor, janë akumuluar dhe disa



detyrime te reja mes kompanive. Detyrimet e prapambetura nga njësitë e tjera publike, veçanërisht ndërmarrjet e ujësjellësve, mbeten problem për shkak të mekanizmit të dobët të ekzekutimit të pagesave.

Marrja e masave për të ndaluar akumulimin e borxheve të reja është një parakusht i rëndësishëm për reduktimin e përgjithshëm të detyrimeve prapambetura në sektor. Plan i përbashkët i veprimeve ka për qëllim parandalimin e lindjes së borxheve të reja ndërmjet kompanive të energjisë elektrike dhe për të forcuar disiplinën e pagesave nga palët e treta.

Rekomandim:

Shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike në bashkëpunim me MFE dhe MIE të rrisin përpjekjet për disiplinimin e pagesave korrente, ku procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura të sigurohet nëpërmjet marrëveshjeve të ristrukturimit të borxheve mes kompanive, dhe kur është e mundur të aplikohet instrumenti i net-imit të detyrimeve të ndërsjella për të përshpejtuar procesin e konsolidimit financiar.

Në vijimësi

4.4. A janë përmbushur detyrimet ligjore të modelit të tregut të energjisë elektrike?

Modeli Shqiptar i Tregut (MSHT) është hartuar në bazë të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për krijimin e Tregut Rajonal të energjisë elektrike, i cili është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2006.

Modeli i Tregut synon mbështetjen për zbatimin e angazhimeve të marra në kuadër të Ligjit për Sektorin e Energjisë dhe akteve nënligjore përkatëse.

Modeli Shqiptar i Tregut karakterizohet si një treg me shumicë i bazuar në transaksione bilaterale dhe kontrata të lidhura midis dy pjesëmarrësve të tregut Jashtë Bursës (*Over the Counter-OTC*), ose si një treg i organizuar i ditës në avance dhe tregut brenda ditës i organizuar përmes Bursës BSHE. Parimet kryesore të modelit të tregut janë:

- Zbatimi i parimit të kostos marxhinale të ofertave në tregjet e organizuara si pjesë e mbikëqyrjes së tregut, me fokus shmangien e abuzimit të tregut;
- Funksionimi si një treg i organizuar i Ditës në Avance dhe tregut Brenda Ditës, për tregtimin e flukseve fizike të energjisë elektrike, në periudhën kohore të ditës në avancë;
- Tregtimi i kontratave fizike afatgjata dypalëshe do të lejohet në përputhje me kapacitetin e blerë dhe të nominuar në ankandet eksplicite të organizuara nga SEECAO;
- Të gjitha format e tjera të tregtimit do të jenë vetëm financiare;
- Skemat bazë që menaxhojnë marrëdhëniet midis subjekteve të ndryshme që veprojnë në role të ndryshme në treg, janë marrëdhëniet kontraktuale.

Marrëdhëniet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut në operimin fizik të Modelit të Tregut përcaktohen me marrëveshje ndërmjet pjesëmarrësve individuale dhe BSHE dhe OST, ose rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve standarde të zbatueshme dypalëshe.

Prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet burimeve hidrike HEC-ve ndahen në:

*Në prodhues publik (KESH sh.a; HEC-et përgjatë kaskadës së lumit drin)
dhe prodhues privat me përparësi (HEC-et e vegjël).*

- HEC-et e vegjël sipas kontratës koncesionare përkatëse marrin klasifikimin "me përparësi" për shkak të radhës së dispeçerimit të energjisë së tyre.

Kundrejt prodhuesit publik (KESH-it), energjia e HEC-eve të vegjël dispeçerohet e para, fillimisht për mbulimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes dhe më pas për përdorim nga konsumatori.

-Marrëdhëniet midis shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike janë rregulluar nëpërmjet kontratave dypalëshe ndërmjet entiteteve të konfirmuara nga ERE, i cili operon juridikisht për përputhshmërinë ligjore të modelit të tregut të energjisë, duke ruajtur parimet e transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit, etj.



Me shpalljen e gjendjes së emergjencës⁴², u vendosen disa role të reja për sa i përket shoqërive publike, si KESH sh.a. dhe OSHEE Group.

Flukset e shpërndarjes aktuale të energjisë⁴³, paraqiten si më poshtë:

1. Per vitin 2021 çmimi i shitjes së energjisë elektrike është miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 10841 /1 Prot, date 27.12.2019 dhe sipas këtij vendimi çmimi i shitjes është 1.5 leke/kWh dhe KESH është i detyruar të furnizoj FSHU me 3,950,000 MWh. Me hyrjen në fuqi të VKM 757 date 09.12.2021, dhe në zbatim të saj KM ka nxjerr vendimin 1394/1 date 16.02.2022 ku KESH furnizon me energji shoqërinë FSHU për klientët konsumatorë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes 0.4kV me çmim të shitjes prej 2.6 ALL/kWh dhe për klientët konsumatorë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes 6/10/20 kV me çmimin 12 ALL/kWh.

2. Për furnizimin e Klientëve të lidhur në tensionin 0.4/6/10/20 KV-Viti 2022

KESH kryen rolin e Prodhimit të energjisë elektrike në kaskadën e lumit Drin, të importit dhe të tepricave të HEC-eve të vegjël (sasia e mbetur e energjisë pas mbulimit të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes) në formën e depozitës duke ia kthyer mbrapsht sasinë e energjisë për mbulimin e humbjeve në momentin kur këto të fundit nuk plotësohen nga prodhimi i HEC-eve të vegjël (kryesisht muajt e thatë të vitit). Në rast se prodhimi i prodhuesve me përparësi tejkalon nivelin vjetor të humbjeve të rrjetit të shpërndarjes KESH paguan diferencën e mbetur me çmimin e rregulluar (max 8.5 ALL/kWh).

Sipas akteve nënligjore dhe administrative në fuqi KESH është i ngarkuar me detyrimin për shërbim publik, për furnizimin e të gjithë sasisë së energjisë së kërkuar nga shoqëria FSHU.

Shoqëria KESH përgjatë vitit 2022 furnizon me energji shoqërinë FSHU për klientët konsumatorë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes 0.4 kV me çmim të shitjes prej 2.6 ALL/KWh dhe për klientët konsumatorë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes 6/10/20 kV me çmimin 12 ALL/KWh.

Çmimi i energjisë i paguar nga Klientët fundor është i ndryshëm në varësi të pikës së furnizimit nëse Tension i Ulët (TU 0.4 KV) apo Tension i mesëm (TM 6/10/20 KV) si dhe në varësi të llojit të klientit për TU. Konkretisht:

- Familjarët e lidhur në TU paguajnë energjinë e konsumuar me çmim 9.5 ALL/KWh.
- Biznes i vogël i lidhur në TU, paguan energjinë e konsumuar me çmimin 11.4 ALL/KWh.
- Konsumatorët e lidhur në TM paguajnë për energjinë e konsumuar 18.8 ALL/KWh.

3. Për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes (humbjet e OSSH)

Mbulimi i humbjeve në rrjet, realizohet nga subjekti që administron rrjetin e transmetimit të energjisë dhe subjekti që administron rrjetin e shpërndarjes.

- Humbjet në transmetim mbulohen nga shoqëria OST sh.a. aktualisht në bazë të VKM Nr. 456/2022, me çmim të rregulluar energjia për humbjet e nevojshme për OST mundësohet nga shoqëria KESH me çmim 8.5 ALL/KWh.

- Humbjet në shpërndarje mbulohen nga OSSH. OSSH sh.a. dispeceron nëpërmjet shoqërisë FTL energjinë e prodhuar nga prodhuesit nga burimet e rinovueshme të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të VKM, energji e cila përdoret për mbulimin e humbjeve.

- Nëse energjia e prodhuar nga prodhuesit nga burimet e rinovueshme të energjisë elektrike është në sasi më e madhe se energjia e nevojshme për mbulimin e humbjeve, atëherë kjo energji depozitohet

⁴² VKM nr. 256 , date 29.4.2022 për disa ndryshime në vendimin nr.584, date 8.10.2021, të këshillit të ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike"

⁴³ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022 Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike



pranë shoqërisë KESH, për tu tërhequr në muajt kur prodhimi nga prodhuesit nga burimet e rinovueshme është më i vogël se nevoja për mbulimin e humbjeve.

- Nëse energjia e prodhuar nga prodhuesit nga burimet e rinovueshme është më e vogël se nevoja atëherë shoqëria FTL, në rolin e agjentit për OSSH:

a) Tërheq energji nga ajo e depozituar pranë KESH sh.a., ose

b) Blen energji në tregun e parregulluar

- *Nëse prodhimi i HEC-eve të vegjël i plotëson humbjet në sasi*

Prodhimi i HEC-eve të vegjël → FTL → OSSH → Plotësohen humbjet në rrjet

- *Nëse prodhimi i HEC-eve të vegjël i tejkalon humbjet si sasi*

Prodhimi i HEC-eve të vegjël → FTL → OSSH plotëson humbjet → Të gjithë tepricat i merr KESH → Tepricat shkojnë për plotësimin e kërkesës së FSHU.

Nëse ka ende teprica në orë të caktuara dhe kërkesa e FSHU është plotësuar KESH është i detyruar të shesë në tregje tepricën e prodhuar nga HEC-et e vegjël.

- *Nëse prodhimi i HEC-eve të vegjël nuk i mbulon dot humbjet si sasi*

a) Në rast se OSSH ka depozituar energji në KESH si tepricë prodhimi KESH mbulon humbjet e OSSH. b) Në rast se sasia e depozituar në rastet e tepricave është kthyer plotësisht tek OSSH nga KESH-i për mbulimin e humbjeve atëherë OSSH nëpërmjet operatorit FTL blen energji në tregje për mbulimin e humbjeve të rrjetit të shpërndarjes.

4.Për mbulimin e humbjeve të sistemit të transmetimit (KESH – OST)

KESH Prodhim dhe/ose import dhe/ose teprica të prodhimit të HEC-eve të vegjël → Mbulon të gjithë humbjet e OST kundrejt të njëjtit çmim si prodhuesit me përparësi (OST i paguan KESH max 8.5 ALL/kWh).

Prodhuesit me përparësi sipas kontratave koncesionare përkatëse paguhen me çmimin e bursës HUPX por jo më shumë se 8.5 ALL/KWh.

5.FTL në rolin e tregtarit për blerjen e energjisë elektrike FSHU.

- *FSHU sh.a.*, është shoqëria që furnizon me energji elektrike konsumatorët e lidhur në nivel tensioni 0.4/6/10/20 kV, me çmime 9.5 lek/kWh për konsumatorët të lidhur në nivel tensioni 0.4 kV dhe 18.8 leke/kWh për konsumatorët e lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV.

-*FTL sh.a.*, është shoqëria e cila menaxhon flukset e energjisë elektrike (kryen shitje-blerje) për llogari të FSHU dhe OSSH sh.a. dhe luan rolin e tregtarit për furnizimin e energjisë elektrike për ato kategori konsumatorësh që kanë dalë në tregun e lire por që nuk gjejnë furnizues ose ka raste ku rrjeti nuk është gati për këtë proces.

Në këtë rast FTL luan edhe rolin e FMF – Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

Çmimi i shitjes në këtë rast është ai i blerjes së energjisë elektrike që FTL e siguron nëpërmjet procedurave për blerje energji elektrike në tregun e lirë.

Në kushtet ku FTL është lideri i Grupit të Balancimit për FSHU sh.a., OSSH sh.a. dhe HEC-ve të vegjël, duhet të përlllogarisë sasinë e energjisë elektrike që duhet t'i kërkojë KESH sh.a. për furnizim. FTL blen energjinë elektrike nga HEC-et e vegjël e me koncesion me çmim të rregulluar, me 8.5 leke/kWh. Energjinë elektrike e blere nga HEC-et e vegjël ia shet shoqërisë OSSH sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes me të njëjtin çmim që ia ka blere HEC-ve. Në rast të tepricave apo mungesave VKM nr. 456 datë 29.06.2022 ka prezantuar mekanizmin e depozitimit pranë KESH, e në rast të mungesës së depozitës pranë KESH, FTL realizon procedurën e blerjes për humbjet e OSSH.

-*OSSH sh.a.*, është shoqëria e cila menaxhon rrjetin e shpërndarjes për sa i përket përmirësimit të rrjetit dhe uljes së humbjeve. Shoqëria OSSH sh.a. ka në pronësi rrjetin nga 110/35/20/10/6/0.4 kV, ku për mirëmbajtjen e rrjetit shoqëria ka llogaritur tarifën e rrjetit të cilat miratohen nga Bordi I ERE dhe i faturohet furnizuesve që furnizojnë konsumatorët fundore.



Gjithashtu, OSSH sh.a. blen nga FTL me 8.5 Lekë/KËh energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e vegjël për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe në rast se nevoja për humbjet nuk plotësohet nga sasia e blere nga HEC-et atëherë OSSH sh.a. ia blen energjinë FTL-së me çmimin e importuar në tregun e lirë (në rastet kur mungon sasia e depozituar në KESH).

6.KESH në rolin e shërbimit publik

Shoqërisë KESH sh.a. i është vendosur edhe detyrimi për shërbimin publik për kategorinë e konsumatorëve që lidhen në nivel tensioni 0.4/6/10/20 kV.

Në kushtet e emergjencës, shoqërisë KESH sh.a. ka detyrimin për të furnizuar shoqërinë OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit me çmim të rregulluar, konkretisht me çmimin që FTL i blen HEC-ve të vegjël (max 8.5 Leke/kWh).

Duke qenë se shoqëria KESH sh.a. ka në menaxhim vetëm asete prodhuese hidrike, ka varësi 100% nga kushtet meteorologjike.


Kur kushtet meteorologjike janë pa reshje shiu, kjo shoqëri është e detyruar që plotësimin e kërkesës me energji elektrike përtej asaj që mbulon nga prodhimi i kaskadës së Drinit t'i sigurojë nga importi në tregun e lirë.

Në rastet kur kushtet meteorologjike janë të favorshme e me reshje të mëdha, KESH sh.a. kryen menaxhimin e kaskadës së Drinit. Nëse pas plotësimit të kërkesës vendase për energji, KESH me qëllim minimizimin e shkarkimeve pa prodhim të energjisë elektrike operon duke shitur energji elektrike në tregun e lirë, gjithashtu KESH sh.a. do të menaxhojë edhe tepricat e HEC-ve të vegjël.

7.Bursa Shqiptare e Energjisë elektrike - ALPEX

Në skemën nr.4 tregohet mënyra sesi do të funksionoj Bursa Shqiptare-ALPEX në tregun e energjisë elektrike.

Skema nr.4. Funksionimi i Bursës ALPEX



Burimi: ALPEX, dizenuar nga grupi i Auditimit të KLSH.

Operimi i tregut të energjisë elektrike kryhet nga operatori i tregut, i licencuar nga ERE. "Operatori i tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, në bazë të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe për të gjitha aktivitetet e lidhura me të, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financiar (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut. Operatori i tregut do të jetë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX). OST Sh.a. përfaqëson 57.25% të aksioneve dhe KOSTT Sh.a. 42.75%.



Për sa më lart, nga auditimi rezulton se: Bursa e energjisë elektrike nuk ka filluar operimin në tregun e energjisë elektrike.

4.4.1 A ka qenë efektive veprimtaria e ERE për periudhën 2021- Maj 2022 për sektorin e energjisë elektrike?

Enti Rregullator i Energjisë është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit në Shqipëri që drejtohet nga bordi, i cili përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë.

ERE funksionon në bazë të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar.

Vendimet e bordit të ERE, kanë pasur objekt të tyre rishikimin apo ndryshimin e akteve të miratuara më herët, shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendime apo akte, zgjatjen e afateve të vendimmarrjes së bordit të ERE, fillimin e procedurës apo licencimin/rinovimin e licencave të subjekteve në veprimtaritë e tregtimit, prodhimit, furnizimit të energjisë elektrike apo në veprimtaritë e tregtimit të gazit natyror, shqyrtimin e aplikimeve të shoqërisë OSSH sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni për vitin 2021 dhe FSHU sh.a., për miratimin e çmimit të shërbimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2021, fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022 dhe për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024 për të cilat ERE zhvilloi dhe një seancë zyrtare publike etj.

Gjatë vitit 2021, ERE ka marrë vendime në lidhje me shqyrtimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

Me poshtë rendisim disa prej tyre:

1. Vendimi nr. 51, datë 17.02.2021 "Mbi miratimin e Kontratës ndërmjet OST sh.a., dhe KESH sh.a., "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese".

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) ka përcjellë për miratim në ERE Kontratën ndërmjet OST sh.a. dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese".

Me vendimin e sipërcituar, bordi i ERE-s vendosi të shtrijë efektet nga data 1 Janar 2021 deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të bordit të ERE, nr. 106, datë 02.07.2020, për "Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike".

2. Vendim Nr. 89, Datë 31.03.2021 "Mbi propozimin e shoqërisë operatori i sistemit të transmetimit sh.a., "për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 prill 2021".

Bordi i ERE me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, Ndër të tjera kishte vendosur:

a. Të pranohet kërkesën e OST sh.a., për shtyrjen e afatit të zbatimit nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, pa efekte financiare (DRY RUN) deri në datën 31.03.2021, të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2020, "Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike". - OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijnë aplikimin e periudhës DRY RUN deri në datën 31.03.2021.

b. Pas përfundimit të periudhës së Dry Run nga ana e OST sh.a. në baze dhe të parashikimeve të ligjit të sektorit si dhe ligjit Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" të gjitha palët janë përgjegjëse për balancimin e sistemit elektroenergetik sipas kostove përkatëse.



Miratimi i këtij tregu i ka hapur rrugë hapjes së tregut të energjisë elektrike sipas kostove të cilat krijojnë të gjithë pjesëmarrësit e tregut si dhe ka gjetur mbështetjen dhe në deklaratën e Sekretariatit të Energjisë në Vjenë në Prill 2021.

2. Vendimi nr. 97, datë 07.04.2021 "Mbi miratimin e Treguesve për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2021".

a. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, ka miratuar "Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike". Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me kërkesë të shoqërisë OSHEE sh.a./OSSH sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj Rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, për shkak të nevojës së kryerjes së investimeve të domosdoshme.

Bordi i ERE me vendimin nr. 255, datë 21.12.2020, vendosi miratimin e treguesve të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021. Për rrjedhojë për t'i dhënë mundësi si Operatorit të rrjetit OSSH sh.a., si dhe përdoruesve/konsumatorëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të marrin masat e nevojshme operative për të operuar sistemet apo pajisjet e tyre me kushtet e reja të miratimit të standardeve të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes u gjykua që këto standarde të hyjnë në fuqi menjëherë, por aplikimi i pikës 7.2 në nenin 7 të Rregullores së miratuar me vendimin e bordit nr. 181, datë 10.11.2017, të pezullohet për një afat nga miratimi i këtyre treguesve, deri në 31 Gusht 2021. Kjo pikë të ketë efekte të plota juridike për periudhën nga 1 Shtatori 2021 e në vijim.

3. Vendimi nr. 108, datë 22.04.2021 "Mbi miratimin e Rregullave të Përbashkëta të Shlyerjes për Shkëmbimin e Energjisë në përputhje me Nenet 50(3) dhe 51(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195".

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 77, datë 19.03.2021, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e "Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195".

Dokumenti "Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195", të datës 23 Nëntor 2017, është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale (referuar si "TSO të CE") në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje) në përputhje me Nenin 50 (3) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195 të 23 nëntorit 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Këto Rregulla, përbëhen nga:

(I) Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të pa qëllimshme në përputhje me Nenin 51 (1), të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike;

(II) Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me Nenin 50 (3), i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 Nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

4. Vendimi nr. 126, datë 17.05.2021 "Mbi miratimin e Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)".

Bordi i ERE, me vendimin nr. 256, datë 21.12.2020, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë. Draft i Rregullores është përcjellë për opinione dhe komente në: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin



e Konkurrencës, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare, Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme (AREA) dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Pas shqyrtimit të të gjithë opinioneve dhe rekomandimeve të ardhura nga palët e interesit, bordi i ERE-s me vendimin nr. 126, datë 17.05.2021, miratoi Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë.

Kjo Rregullore transponon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë, në të njëjtën kohë ajo ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike. Rregullorja REMIT, po ashtu parashikon monitorimin e tregjeve të energjisë me shumicë nga Enti Rregullator i Energjisë.

5. Vendimi nr. 141, datë 15.06.2021 "Mbi miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Kriereve të Vlerësimit dhe të Përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike".

Ligji nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 87, pika 2 të tij parashikon se: ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, cakton furnizuesin e mundësisë së fundit. Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 449, datë 15.06.2016, ka vendosur "*Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike*". Në seksionin III, të VKM-së nr. 449, datë 15.06.2016, është vendosur se: deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit.

Bordi i ERE-s me anë të vendimit nr. 131, datë 10.08.2020, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Kriereve të Vlerësimit dhe të Përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike. Kjo Rregullore përcakton: a. Procesin e përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit; b. Detyrimet në lidhje me kushtet që kualifikojnë një të licencuar për të aplikuar dhe për t'u emëruar si Furnizuesi i Mundësisë së Fundit; c. Kriteret e vlerësimit që do të përdoren për përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit pas një procesi konkurrimi; d. Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e aplikuesit si furnizues i mundësisë së fundit.

6. Vendimi nr. 235, datë 26.11.2021 "Mbi miratimin e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve".

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 163, datë 12.07.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit ose ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit".

7. Kjo Rregullore u hartua në përputhje me nenin 20, germa "g" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; "Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe kushtet e licencave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për të licencuarit, që paraqesin kërkesën për:

a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;



b) ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;

c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.

8. Vendimi nr. 244, datë 02.12.2021 "Mbi propozimin e OST sh.a., për Treguesit e Kriteve Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike për Vitin 2022".

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, ka miratuar "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike", e cila parashikon detyrimin e shërbimit publik të OST sh.a., që të përmbushë standardet e cilësisë së furnizimit të specifikuar nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe nga kjo Rregullore.

Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit, të paraqitur nga OST sh.a., janë të përcaktuar dhe në akte të tjera të miratuara nga bordi i ERE-s, respektivisht: parametrat teknikë të cilët lidhen me tensionin dhe frekuencën janë të përcaktuar në "Kodin e Rrjetit të Transmetimit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE nr. 129, datë 04.06.2018, si dhe në "Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 87, datë 20.04.2018.

Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit, të paraqitur nga OST sh.a., janë: 1. Cilësia e Frekuencës (FQ), 2. Koha e Nevojshme për tu Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja, 3. Cilësia e Tensionit (VQ), 4. Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI).

Periudha Janar – Qershor 2022

Përgjatë periudhës Janar – Qershor 2022, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar punën gjithashtu për plotësimin e kuadrit ligjor në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, përmes miratimit të një numri të konsiderueshëm aktesh të cilat e pasurojnë edhe më tepër legjislacionin sekondar.

Deri në datën 20 Qershor 2022, Bordi i ERE-s është shprehur me 164 vendimmarrje në 28 mbledhje të zhvilluara.

Aktualisht janë marrë 7 vendime për licencimin e prodhuesve të energjisë elektrike nga të cilët 2 operatore për prodhimin e energjisë nga impiantet fotovoltaike.

Ndër vendimet kryesore të miratuara përgjatë vitit 2022 mund të përmendim

1. Vendim Nr.23 datë 14.02.2022, "Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit".

Në zbatim të Objektivave Strategjike 3 vjeçare të ERE por edhe detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2021, ERE ka miratuara gjithashtu edhe "Rregulloren mbi masat e të të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit". Kjo rregullore, e para e këtij lloji, së cilës do t'i nënshtrohen të gjithë furnizuesit e licencuar, përfshirë shoqërinë publike të furnizimit, ka në fokus arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit.

Çdo furnizues do të ketë detyrimin të informojë klientët për të drejtat dhe kushtet me të cilat do të furnizohet, mbi çmimet e furnizimit me energji elektrike për periudhën e ofruar apo mbi të drejtën që klientët kanë për të përzgjedhur një furnizues tjetër.

Përveç vendosjes së standardeve që furnizuesit duhet të përmbushin për një shërbim cilësor, rregullorja parashikon edhe të drejtën e monitorimit të këtyre treguesve, nga Enti Rregullator i Energjisë.



2. Vendim Nr. 63 datë 11.04.2022 "Mbi miratimin e kodit të transmetimit."

Kodi i Transmetimit përcakton kushtet për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit dhe këto kushte duhet të jenë të barabarta dhe jo diskriminuese për asnjë nga përdoruesit e sistemit të transmetimit. Kodi është përpiluar në përputhje me kodin e transmetimit të ENTSO-s dhe nga ana e OST janë zhvilluar po ashtu dhe konsultimet me palët e interesuara, proces i cili u zhvillua dhe nga ana e ERE-s.

Për të cilën palëve ju la kohe deri me 01.07.2022 për hyrjen në fuqi të tij në mënyrë që palët të kenë mundësi të njihem me dokumentin e miratuar nga ana e OST.

3. Vendim Nr. 72, Datë 13.04.2022 "Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024".

Të ardhurat e kërkuara që priten të realizohen nga OST sh.a. janë llogaritur për periudhën rregullatore 2022-2024 dhe tarifa e re të transmetimit të energjisë elektrike e cila do t'i shtrijë efektet nga data 1 Maj 2022, është përllogaritur duke konsideruar dhe diferencën e korigjueshme të të ardhurave të kërkuara për periudhën Janar-Prill 2022 për efekt të rekuperimit të të ardhurave të pafaturuara në 4 mujorin e parë. Kjo diferencë nuk ndikon në tarifën mesatare të transmetimit për periudhën 2022 – 2024 dhe do të korigjohet në zbritje të të ardhurave të kërkuara në vitin e dytë të periudhës rregullatore.

Tarifat e transmetimit të energjisë elektrike për çdo vit të periudhës rregullatore 2022-2024 rezultojnë: a) 0.85 lekë/kWh për vitin 2022; b) 0.89 lekë/kWh për vitin 2023; c) 0.83 lekë/kWh për vitin 2024, si rrjedhojë tarifa mesatare e transmetimit për periudhën rregullatore 2022-2024, rezulton 0.85 lekë/kWh.

4. Nr. 73, datë 13.04.2022 "mbi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj – 31 dhjetor 2022".

Miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, si vijon:

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV - 1.55 leke/kWh.

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 - 20 kV - 3.99 Lekë/kWh.

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV - 6.42 Lekë/kWh.

Miratimin e çmimit të aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022 prej 1.92 lekë/kWh.

Lënie në fuqi të tarifës fikse të shërbimit për leximin "zero" prej 200 lekë/muaj.

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria nga faturimi i energjisë reaktive për periudhën 2015- 2021 si dhe ato të parashikuara të tepërta për energjinë aktive dhe reaktive për vitin 2022 janë vlerësuar si të ardhura të zbritshme në tarifën e shpërndarjes për vitin 2022.

Nga përllogaritja e kostove të aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, tarifa mesatare e shpërndarjes e llogaritur për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2022, rezulton të jetë 5.62 lekë/kWh. Meqenëse llogaritjet për tarifën mesatare të shpërndarjes janë për të gjithë sasinë vjetore të energjisë që pritet të lëvrohet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2022 dhe tarifat e reja do të aplikohen për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, diferenca e korigjueshme për periudhën 1 Janar - 30 Prill 2022, do të reflektohet në rritje të tarifës mesatare të shpërndarjes për periudhën e mbetur të vitit 2022, me qëllim rekuperimin e të ardhurave të pafaturuara në 4 mujorin e parë të vitit dhe do të korigjohet në zbritje në periudhën pasardhëse rregullatore, viti 2023.

Tarifa mesatare e shpërndarjes për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, rezulton 5.89 lekë/kWh. ERE do të rishikojë shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe sasinë e energjisë së lëvruar në rrjetin e shpërndarjes kundrejt vlerave reale të tyre, në përputhje me përcaktimet e "Metodologjisë së



llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017.

5.Vendim nr. 74, datë 13.04.2022 mbi vlerësimet e ere për kostot e aktivitetit të furnizuesit të shërbimit universal për periudhën 01.05.2022 – 31.12.2022

Nga vlerësimet e ERE-s në mungesë të një aplikimi të FSHU-se, rezultoi se Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022 mbeten ato të miratuara me anë të vendimit të bordit të ERE-s nr. 252, datë 21.12.2021.

4.4.2. A janë përmbushur detyrimet ligjore të sigorisë kibernetike nga shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike?

Gjatë fazës studimore dhe asaj të terrenit grupi i auditimi të KLSH përcolli për shoqëritë KESH, OSHEE dhe OST pyetësor në lidhje me zbatimin e bazës ligjore për garantimin e sigorisë kibernetike të veprimtarisë se tyre shumë të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike në lidhje me pyetjen audituese:

A ka institucioni juaj ne strukturën e tij, përgjegjës për mbarëvajtjen e sigorisë se informacionit? Nëse po a është deklaruar kontakti ne Autoritet përkatëse?

Infrastrukturat kritike apo të rëndësishme të informacionit duhet të kenë një person përgjegjës për sigurinë kibernetike, kontaktet i komunikohen AKCESK sipas ligjit 2/2017 dhe ERE sipas Vendimit 126 date 30.07.2020.

Gjetje:

Referuar përgjigjeve zyrtare rezulton se OSHEE, OST e kanë personin përgjegjës për sigurinë kibernetike, ndërkohë që KESH për personin e kontaktit i referohet shkresës nr. 1165/3 date 02.03.2021 drejtuar AKCESK ku person kontakti është zoti A.A.

Ndërkohë sipas Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të KESH rezulton që ky punonjës nuk është pjesë e strukturës së KESH.

Në lidhje me pyetjen:

A keni strategji apo sisteme të menaxhimit të sigorisë kibernetike (ISMS) ku përfshihen politika, procedura apo rregullore të cilat kanë në objektin e tyre rritjen e sigorisë kibernetike?

Nga auditimi rezulton se vetëm OST ka rritur infrastrukture e sigorisë kibernetike por dhe të hartimit të dokumenteve strategjik.

Në mënyrë parciale dhe jo të plotë rezultojnë shoqëritë KESH dhe OSHEE grup.

Për pyetjen audituese:

A ka kryer institucioni një Vetëvlerësim për nivelin e sigorisë kibernetike?

Bazuar në ligjin 2/2017 për sigurinë kibernetike dhe Vendimit nr.126 të ERE datë 30.07.2020, ku parashikohet se: OIKI-operatori i infrastrukturës kritike të informacionit do të paraqesë vetëvlerësimin e tij në ERE bazuar në “Rregulloren mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë (Miratuar me urdhër nr.22, datë 26.04.2018 të AKCESK).

Ky vetëvlerësim do të përmbajë një informacioni të detajuar dhe të plotë (duke përfshirë metodologjinë që ka përdorur për të realizuar vetëvlerësimin, mënyrën se si e ka aplikuar këtë metodologji rezultatet e vetëvlerësimit të cilat duhet të përfshijnë identifikimin e riskut si dhe procesin e zvogëlimit të riskut) të çdo rreziku domethënës të identifikuar dhe çdo propozim fillestar për trajtimin e rrezikut përfshirë deklaram për rezultatin e nxjerrë duke identifikuar atë si ‘Jo e arritur "ose" Pjesërisht e arritur " dhe “E Arritur”. Me pas ai duhet te shikojë planin e masave për te ulur rreziqet e identifikuar si dhe te rishikojë planet e investimit për këtë pjese.



Shoqëritë publike te sektorit elektroenergjistik në zbatim të rregullores së sigurisë kibernetike të infrastrukturës kibernetike në sektorin e energjisë elektrike kanë paraqitur raporte periodike pranë ERE për sigurinë kibernetike.

Vetëm shoqëria OST ka realizuar vetëvlerësim për nivelin e sigurisë kibernetike. Pra përsëri shoqëria KESH dhe OSHEE grup përveç iniciativave të brendshme të tyre nuk kanë realizuar një proces të plotë me ekspert të jashtëm për vetëvlerësimin e sigurisë kibernetike.

Në lidhje me pyetjen:

A janë pajisur me Certifikatë ISO 27001 shoqëritë e sektorit të energjisë elektrike ?

Bazuar në ligjin 2/2017 për sigurinë kibernetike, Operatorët e Infrastrukturave Kritike në sektorin e energjisë elektrike të pajisen me certifikimin me standardin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje. Afati i fundit Mars 2022.

Nga auditimi rezulton se vetëm shoqëria OST është e pajisur me certifikatën e sigurisë ISO 27001, ndërkohë që dy shoqëritë e tjera nuk janë pajisur me këtë certifikatë duke vepruar ne mospërputhje me ligjin mbi sigurinë kibernetike dhe "Rregulloren mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë Miratuar me urdhër nr.22, datë 26.04.2018 të AKCESK , ku është parashikuar që:

Operatorët e Infrastrukturave Kritike në sektorin e energjisë elektrike të pajisen me certifikimin me standardin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje. Afati i fundit Mars 2022.

OST sh.a., operatori i sistemit të transmetimit të energjisë, në përmbushje të detyrimeve rregullatore bazuar në Nenin 10 të " Rregullores për Sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike ,Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 30.07.2020", ka marrë certifikimin ISO 27001:2013 për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS), duke treguar kështu angazhimin e saj për zbatimin e standardeve më të lartë për sigurinë e informacionit.

Konkluzione:

Certifikimi me standardin e sigurisë ISO 27001 i shoqërive të sistemit te energjisë elektrike të klasifikuara si infrastruktura kritike i jep përparësi mbrojtjes së të dhënave të klientit përmes kontrolleve të zbatuara duke përfshirë zhvillimin e produktit sipas sigurisë, kriptimin e të dhënave, menaxhimin e cenueshmërisë, vazhdimësinë e biznesit, planet e rimëkëmbjes nga fatkeqësitë dhe shumë më tepër. Konsumatorët mund të presin një menaxhim sistematik dhe të vazhdueshëm të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të ndikojnë në konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit korporativ dhe personal në të gjithë sistemet e TI, Siguria Fizike dhe Teknologjia Operative (OT).

Rekomandim:

Shoqëritë KESH, OSHEE dhe OST duhet të rrisin investimet në lidhje me sigurinë kibernetike për të ngritur një infrastrukturë të sigurt te teknologjive te informacionit dhe komunikimit me protokolle të qarta raportimi, sigurie dhe kontrolli.

Në vijimësi

5. PERMBLEDHJE

Pas fillimit të "normalitetit të ri" në bashkëjetesë me pandeminë covid-19 dhe pasojat e luftës në Ukrainë, industria botërore u ballafaquan me një rritje të shpejtë të çmimit të energjisë elektrike, duke shënuar vlera maksimale historike që kur nuk ishin dëgjuar më parë. Në bursën hungareze HUPX prej muajit Qershor 2021 filloj një rritje e lehtë e çmimit të energjisë elektrike duke pësuar në muajt pasues rritje eksponentiale për të vijuar nga 72 euro/MWh e duke kapur amplitudën më të lartë në



muajin dhjetor 2021 me 256 euro/MWh. Ky trend rritës u mbajt dhe përgjatë gjashtëmujorit të parë, të vitit 2022 duke shënuar vlerën më të lartë në muajin Korrik të 2022 me 359 euro/MWh.

Rritja e çmimeve të energjisë në bursat ndërkombëtare, u reflektuan edhe në ekonomitë e vendeve të ndryshme. E ndodhur në këtë situatë edhe vendi ynë u përball me një rritje të çmimit të blerjes së energjisë elektrike.

Situata në fillim të krizës energjetike në vend u bë më komplekse edhe si rezultat i problematikave të shfaqura në administrimin e rezervave hidrike nga shoqëritë publike përgjegjëse por edhe të mungesës së operimit të bursës shqiptare të energjisë si pjesë integrale e modelit të tregut të energjisë elektrike.

Çmimet e blerjes së energjisë elektrike për shoqëritë publike shqiptare, të cilat u "kapën" befasisht në këtë trend rritje të çmimit të blerjes vendosën në vështirësi financiare të likuiditeteve të tyre për të përballuar blerjen e energjisë elektrike.

Për këtë qëllim qeveria shqiptare financoj kompanitë publike të sektorit energjetik KESH dhe OSHEE për përballimin e blerjes së energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare.

Për sa më lart, në sinkron me sensibilitetin e lartë të shfaqur të shoqërisë shqiptare për masat e marra nga qeveria shqiptare dhe shoqëritë e sektorit elektroenergjetik, KLSH ndërmoi fillimin e auditimit të performancës për shoqëritë e sektorit elektroenergjetik dhe Entin rregullator të energjisë me temë "Performanca e shoqërive publike të sektorit energjetik në administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021-2022".

Objektivi i këtij auditimi është:

Vlerësimi i performancës së veprimtarisë së shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike përgjatë periudhës 2021 dhe 6-mujorit të parë të 2022, e cila përkon me krizën globale në fushën e energjisë dhe që ka impaktuar edhe vendin tonë.

Nëpërmjet vlerësimit të performancës së këtyre shoqërive dhe në veçanti të administrimit të rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, grupi i auditimit në përfundim të fazës së terrenit do të paraqes problematikën kryesore dhe do të rekomandoj masa të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre shoqërive brenda objektit të këtij auditimi.

Auditimi i performancës për shoqëritë elektroenergjetike u orientua në dy dimensione, efikasitetin dhe efektivitetin.

Gjatë hartimit të programit të auditimit në fazën studimore por dhe atë të terrenit nga auditimi rezultoi se; për furnizimin e tregut të brendshëm me sasinë e energjisë të nevojshme, u përdorën burime të larta financiare.

Prandaj vlerësimi i performancës së veprimtarisë së shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike u orientua nga vlerësimi i raportit të burimeve financiare të përdorura kundrejt rezultateve të arritura dhe njëkohësisht u vlerësua edhe në drejtim të efektivitetit, pra të realizimit të objektivave të planifikuara nga shoqëritë subjekt nën auditim kundrejt atyre të vendosura.

Kriteret e përdorura për analizë, konkluzionet dhe rekomandimet u ndanë në 4 (katër) fusha kryesore:

- 1) Kriteret e politikës, ku u përfshinë kryesisht Strategjia e zhvillimit në fushën e elektroenergjetikës për periudhën objekt auditimi;
- 2) Kriteret e monitorimit dhe raportimit ku u konsultuan raporte dhe studime nga subjektet në auditim, vetë KLSH-së nga auditimet e mëparshme apo në proces dhe palë të tjera interes;
- 3) Kriteret teknike, ku u fokusuan më së shumti në bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi për sektorin e energjisë;
- 4) Kriteret të tjera, ku konsultuam praktika të mira të vëna në jetë nga vende të ngjashme në fushën e gjenerimit të energjive të rinovueshme, ku përzgjedhëm rastin e Danimarkës.

Gjatë auditimit u përdorën teknikat audituese të mëposhtme:

- a) Rishikim dhe vlerësim i dokumentacionit të grumbulluar gjatë fazës studimore dhe asaj të terrenit.



b) Komunikim me drejtuesit dhe specialistët e subjekteve nën auditim, përmes intervistave gjysmë të strukturuar.

d) Kryqëzim analitik i të dhënave.

e) Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të mbledhura gjatë auditimit.

f) Analizë cilësore e politikave të ndjekura në sektorin e energjisë elektrike

I gjithë auditimi u përshkrua nga qasja apo paradigma:

"Sektori i energjisë elektrike si një sektor i rëndësishëm së veçantë për sigurinë kombëtare duhet të diversifikoi asetet gjeneruese me kosto eficiente duke ruajtur ekuilibrin mjedisor dhe garantuar qëndrueshmërinë e sistemit dhe furnizimin e pandërprerë të tregut të energjisë elektrike në vend"

Auditimi i performances, u orientua kah rezultatit, pasi u analizua struktura, funksionimi dhe pozicionimi i subjekteve nën auditim, në lidhje administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021-2022.

Grupi auditues i KLSH në përfundim ka adresuar rekomandime të cilat potencialisht mund të sjellin përmirësime në të ardhmen për rritjen e eficientes dhe efektivitetit të sektorit të energjisë elektrike.

Për sa më lart, pas auditimit, trajtimit të observacioneve, KLSH i qëndron mesazhit auditues se:

Kriza globale energjetike u shoqërua me rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi dhe me mungesë të likuiditeteve financiare të shoqërive të sistemit elektroenergetik shqiptar, duke vështirësuar garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike.

Keqmenaxhimi i kaskadës së Drinit, solli si pasojë rënien e rezervës hidroenergetike në liqenin e Fierzës dhe rritjen e kërkesës për import të energjisë elektrike, në një periudhë që përkon me çmime shumë të larta të energjisë elektrike në bursë.

Ndodhur në këto kushte, Qeveria Shqiptare, injektoi nëpërmjet instrumenteve financiarë 165 milion euro dhe 20 miliard lekë, që sistemi elektroenergetik të mos kalonte në kolaps.

Vlera e importit të energjisë elektrike për 6 mujorin e parë të 2022, u rrit me 156% krahasuar me vlerën e këtyre importeve për vitin 2021.

Shpenzimet për blerjen e energjisë nga importi për vitin 2021 dhe 6 mujorin e parë 2022, arritën vlerën **659,982,839 euro**.

Strategjitë e ndjekura nga sistemi për diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike, kanë rezultuar deri tani jo eficiente, duke sjellë ekspozimin e përhershëm të sistemit elektroenergetik kundrejt riskut meteorologjik. Kjo si pasojë, ka sjellë rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi me çmime të larta.

KESH përveç disa nismave fillestare në investime për burime foto volta-ike (PV), është larg realizimit të objektivave strategjike, për diversifikimin e portofolit gjenerues, me energji të rinovueshme.

Një nga sfidat e tjera të sistemit, ngelet niveli i lartë i humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike, e vlerësuar 21%⁴⁴ për 2021 dhe 20% në 2022.

Niveli i lartë i humbjeve, është pasojë e investimeve të pamjaftueshme në infrastrukturën e sistemit të shpërndarjes dhe mos implementimit⁴⁵ të sistemit inteligjent të matjes⁴⁶.

Siguria kibernetike, gjithashtu mbetet një çështje sensitive, në kushtet kur sistemi elektroenergetik është i klasifikuar, si infrastrukturë kritike e rëndësishme së veçantë për sigurinë kombëtare.

Garantimi i sistemeve të informacionit dhe ruajtja e të dhënave korporative, kërkon që shoqëritë e sektorit elektroenergetik, të certifikohen me standardin ISO 27001.

Krahas masave të marra për përballimin e krizës së energjisë elektrike, Qeveria Shqiptare duhet të

⁴⁴ Të dhënat sipas ERE "Raporti 2021 dhe 9 mujori i parë 2022"

⁴⁵ OSSH brenda vitit 2025 duhet të implementoj sistemin inteligjent të matjes

⁴⁶ Pika 2 dhe 3 neni 78 Sistemet matëse inteligjente të Ligjit 43/2015 për sektorin e energjisë elektrike



gjejë zgjidhje të qëndrueshme dhe eficiente për vënien në funksion të TEC-it të Vlorës, si dhe fillimin e operimit të bursës shqiptare të energjisë, për ta bërë të plotë modelin e tregut të energjisë.

6. GRUPI I PUNËS

R. XH., përgjegjës grupi

A. L., anëtar

DREJTOR I DEPARTAMENTIT
R. XH.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "PERFORMANCA E SHOQËRIVE PUBLIKE TË SEKTORIT ENERJTIK NË ADMINISTRIMIN E REZERVËS HIDRIKE NË KASKADËN E LUMIT DRIN, PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021-2022"

7. ANEKS

Aneks nr.1.

KESH PERMBLEDHESHE E TREGUESVE EKONOMIKO-FINANCIARE KRYESORE TE KESH sh.a. PËR VITIN 2022 (I Miratuari dhe I Pritshmi)

Nr.	Emërtimi	Njësia	I Miratuari i i Vitit 2022	I Pritshmi i Vitit 2022
I.	Të Ardhura gjithsej	(000/lekë)	28,814,300	29,491,911
I.I	Të Ardhura operative	"	28,679,292	27,700,211
I.II.	Të Ardhura Financiare	"	135,008	1,791,701
II.	Shpenzime gjithsej	(000/lekë)	28,457,814	55,582,268
II.I.	Shpenzime Blerje Energjie	"	21,433,117	49,087,561
II.II.	Shpenzime Personeli	"	1,382,201	1,283,934
II.III.	Blerje lëndë djegëse	"	-	-
II.IV.	Blerje Materiale dhe Produktesh(I+II)	"	201,522	137,313
II.V.	Shpenzime amortizimi e zhvlerësimi, humbje nga zhvlerësimi	"	3,610,810	3,610,810
II.VI.	Furnitorë dhe Shërbime (Të tjerë)	"	1,152,115	927,976
II.VIII.	Shpenzime Financiare	"	678,048	534,673
III.	Fitimi para taksave dhe të jashtëzakonshme	(000/lekë)	356,486	(26,090,357)
VI.	Fitimi i Vitit	"	303,013	(26,090,357)
VIII.	INVESTIMET	(000/lekë)	5,107,995	
	Projekti i Sigurisë së Digave (Kosto e huaj)	"	1,032,564	
	Projekti i Sigurisë së Digave (Kosto lokale)	"	206,513	206,513
	Investime me fondet e veta	"	3,868,918	3,868,918
	Injektivim kapitali	"	(000/lekë)	20,000,000
	Tremujori II	"	"	8,000,000
	Tremujori III	"	"	8,000,000
	Tremujori IV	"	"	4,000,000
	Hua (Trem. I)	"	(000/lekë)	7,905,300

Aneks nr.2.

Energjia e transmetuar për Oshee-ne dhe Konsumatorët e Kualifikuar për Vitet 2019,2020,2021,2022														
VITI 2019	Njësia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	SHUMA VJETORE
- Energji e transmetuar për OSHEE sh.a.	kWh	696,049,643.52	541,406,203.50	512,657,562.59	450,635,862.76	445,921,110.28	460,366,522.38	512,461,421.76	551,362,808.40	457,573,070.53	456,497,139.17	466,561,658.35	583,756,916.32	6,137,249,919.58
- Energji e transmetuar për klientët e kualifikuar	"	37,932,237.53	46,989,047.34	91,997,442.36	95,783,590.57	88,487,940.24	89,714,613.80	85,145,299.33	82,220,852.10	72,836,289.98	53,159,091.12	56,354,902.07	66,192,753.74	866,814,060.18
Total		735,981,881.05	588,395,250.85	604,655,004.95	546,419,453.33	534,409,050.52	550,081,136.19	597,606,721.08	633,583,660.50	530,409,360.51	509,656,230.29	522,916,560.42	649,949,670.06	7,004,063,979.75
VITI 2020														
- Energji e transmetuar për OSHEE sh.a.	"	667,660,190.44	559,955,213.77	527,212,501.22	435,192,708.12	418,033,916.39	433,213,141.39	506,882,822.79	517,902,848.67	468,208,024.41	471,434,682.67	541,020,030.68	637,461,946.66	6,184,178,029.20
- Energji e transmetuar për klientët e kualifikuar	"	44,973,908.36	57,387,501.87	56,198,690.63	44,029,243.33	71,918,356.87	73,689,330.61	72,234,805.40	74,832,588.08	76,924,868.91	81,900,583.93	75,559,413.54	80,921,490.87	810,570,782.40
Total		712,634,098.81	617,342,715.64	583,411,191.84	479,221,951.44	489,952,273.26	506,902,472.00	579,117,628.19	592,735,436.75	545,132,893.31	553,355,266.60	616,579,444.22	718,383,439.53	6,994,748,811.60
VITI 2021														
- Energji e transmetuar për FTL sh.a/OSHEE group	"	661,092,101.84	566,578,105.01	598,514,149.73	523,655,600.16	446,850,760.75	478,376,281.20	567,411,270.75	587,616,276.85	470,851,529.01	496,968,253.50	525,755,328.65	682,711,777.03	6,606,381,434.50
- Energji e transmetuar për klientët e kualifikuar	"	74,213,546.28	59,564,787.41	72,015,656.62	96,043,900.05	99,973,002.56	91,699,394.91	96,777,013.71	102,992,797.88	97,248,818.25	93,386,100.79	92,674,442.09	72,649,174.97	1,049,233,635.51
Total		735,305,648.11	626,142,892.43	670,529,806.36	619,699,500.21	546,823,763.31	570,075,676.12	664,188,284.46	690,609,074.73	568,099,347.26	590,354,354.29	618,429,770.74	755,360,952.00	7,655,615,070.01
VITI 2022														
- Energji e transmetuar për OSHEE sh.a.	"	715,775,856.19	606,652,612.48	645,277,760.66	489,739,260.44	451,412,375.27	492,191,173.56	571,030,355.70	564,471,979.81	461,190,398.19				4,997,741,772.31
- Energji e transmetuar për klientët e kualifikuar	"	42,911,327.48	62,366,072.87	75,227,044.38	86,590,024.45	86,348,526.75	81,077,465.30	54,925,696.63	48,854,022.80	30,360,520.71				560,655,701.36
Total		758,687,183.67	669,018,685.35	720,504,805.04	576,329,284.89	537,760,902.02	573,268,638.85	625,956,052.33	613,326,002.61	491,550,918.90				5,566,397,473.67

Aneks nr.3.

Numri i abonentëve familjar sipas fashave viti 2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "PERFORMANCA E SHOQËRIVE PUBLIKE TË SEKTORIT ENERJITIK NË ADMINISTRIMIN E REZERVËS HIDRIKE NË KASKADËN E LUMIT DRIN, PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021-2022"

Viti	Abonent	Segment FAMILJAR	Njësia (KWh)	"0"	"100"	"101_200"	"201_300"	"301_400"	"401_500"	"501_600"	"601_700"	"701_800"	"801_900"	"901_1000"	">1001"	
2021	Abonentet	Janar	Konsumi	-	7,742,086	23,687,869	32,172,739	34,935,574	34,868,848	33,325,864	29,336,674	22,690,306	17,213,241	12,821,289	50,254,257	
			Nr. Abonenteve	254,823	160,860	159,273	129,653	100,263	77,709	60,771	45,306	30,372	20,306	13,535	13,535	34,018
		Shkurt	Konsumi	-	7,673,312	22,646,425	31,022,699	34,451,740	34,541,414	31,121,371	26,322,462	21,315,413	17,108,180	12,926,025	55,154,573	
			Nr. Abonenteve	274,580	162,813	152,079	124,784	98,880	77,072	56,800	40,638	28,507	20,180	13,638	37,535	
		Mars	Konsumi	-	7,409,679	23,442,705	32,442,246	35,584,456	34,430,637	30,128,353	24,816,697	19,085,115	14,883,396	11,017,758	44,358,701	
			Nr. Abonenteve	289,118	153,589	156,965	130,536	102,190	76,846	55,005	38,358	25,531	17,621	11,627	30,372	
		Prill	Konsumi	-	7,764,978	25,820,634	36,209,682	38,645,344	35,321,436	27,657,745	20,570,654	15,606,589	11,573,181	8,554,168	29,195,345	
			Nr. Abonenteve	276,308	157,773	172,653	145,789	111,107	78,976	50,583	31,806	20,887	13,666	9,016	19,587	
		Maj	Konsumi	-	8,197,698	32,499,686	45,822,792	40,550,962	28,158,027	17,630,588	10,479,961	6,417,709	4,345,830	3,300,494	16,099,853	
			Nr. Abonenteve	267,436	165,898	215,409	184,976	117,353	63,265	32,364	16,254	8,603	5,140	3,471	9,445	
		Qershor	Konsumi	-	8,503,388	36,365,943	49,208,207	39,463,419	25,372,154	14,341,011	9,464,719	6,132,677	3,689,152	2,442,297	11,714,222	
			Nr. Abonenteve	249,559	166,347	240,764	199,363	114,445	57,042	26,344	14,653	8,222	4,357	2,581	6,923	
		Korrik	Konsumi	-	7,877,009	35,791,342	49,199,770	40,554,150	28,214,883	17,937,490	12,649,986	9,210,569	6,308,720	4,786,604	19,787,869	
			Nr. Abonenteve	234,016	152,639	236,354	199,325	117,402	63,324	32,876	19,562	12,337	7,453	5,041	12,246	
		Gusht	Konsumi	-	8,336,843	36,563,389	47,656,778	41,585,775	30,072,230	19,752,431	13,479,437	10,278,106	7,462,744	4,938,433	23,524,256	
			Nr. Abonenteve	216,317	157,058	241,769	192,540	120,337	67,291	36,185	20,861	13,725	8,816	5,215	14,259	
		Shtator	Konsumi	-	9,790,204	40,157,372	50,576,400	36,522,987	20,695,651	11,237,084	7,300,091	4,636,134	3,374,890	2,623,112	11,907,182	
			Nr. Abonenteve	226,570	193,474	266,123	205,500	106,119	46,716	20,597	11,321	6,208	3,978	2,767	6,800	
		Tetor	Konsumi	-	9,014,966	34,881,640	48,354,922	38,610,481	28,027,670	18,080,891	10,716,734	6,523,993	4,203,185	3,355,098	13,315,340	
			Nr. Abonenteve	235,516	185,470	231,077	195,610	112,298	62,623	33,174	16,610	8,746	4,967	3,526	7,925	
		Nentor	Konsumi	-	8,836,827	29,766,195	43,623,580	41,164,470	28,779,440	23,638,370	15,505,011	10,147,793	6,446,187	4,368,897	17,973,240	
			Nr. Abonenteve	252,719	184,337	198,956	175,958	118,606	64,315	43,251	24,013	13,595	7,616	4,610	11,182	
		Dhjetor	Konsumi	-	6,526,257	22,454,338	31,417,900	37,101,808	38,175,224	35,282,013	30,625,611	25,833,541	20,823,761	16,584,669	69,541,164	
			Nr. Abonenteve	253,839	143,205	149,698	126,006	106,423	85,111	64,354	47,243	34,541	24,572	17,502	47,676	

Numri i abonentëve familjar sipas fashave viti 2022

Viti	Abonent	Segment FAMILJAR	Njësia (KWh)	"0"	"100"	"101_200"	"201_300"	"301_400"	"401_500"	"501_600"	"601_700"	"701_800"	"801_900"	"901_1000"	">1001"	
2022	Abonentet	Janar	Konsumi	-	7,068,349	20,854,199	28,891,486	32,727,945	34,008,327	32,473,404	29,640,608	25,980,497	21,711,320	17,742,809	80,897,506	
			Nr. Abonenteve	282,903	153,575	139,690	116,325	93,879	75,741	59,202	45,725	34,717	25,602	18,707	54,637	
		Shkurt	Konsumi	-	7,702,947	22,697,188	31,741,183	35,491,557	35,562,046	31,495,989	27,840,343	22,695,244	17,472,161	14,333,405	58,196,563	
			Nr. Abonenteve	270,129	165,992	152,468	127,616	101,873	79,298	57,393	42,991	30,347	20,610	15,128	39,144	
		Mars	Konsumi	-	7,597,428	22,826,060	31,908,197	35,658,598	36,079,776	31,870,834	27,532,024	22,552,012	17,686,639	14,322,137	56,306,781	
			Nr. Abonenteve	269,709	165,924	153,066	128,241	102,348	80,407	58,155	42,475	30,174	20,865	15,106	37,829	
		Prill	Konsumi	-	8,017,758	27,726,815	40,525,325	42,052,938	35,285,134	25,418,757	17,424,798	11,451,415	7,864,602	5,619,971	22,468,304	
			Nr. Abonenteve	268,556	171,036	184,389	162,925	121,063	78,968	46,551	26,963	15,345	9,290	5,919	14,256	
		Maj	Konsumi	-	9,138,910	34,626,080	48,119,571	41,107,382	27,445,738	16,159,995	9,105,697	5,444,338	3,384,962	2,612,050	12,249,052	
			Nr. Abonenteve	244,413	192,558	229,507	194,322	118,926	61,694	29,698	14,120	7,300	3,996	2,743	6,997	
		Qershor	Konsumi	-	8,850,621	36,698,737	50,558,901	39,926,200	25,973,856	15,436,233	9,161,340	5,558,822	3,680,448	2,537,556	12,974,088	
			Nr. Abonenteve	240,679	182,032	242,328	204,854	115,640	58,411	28,336	14,188	7,451	4,347	2,670	7,337	
		Korrik	Konsumi	-	8,648,107	35,901,322	49,282,196	39,005,553	28,911,303	19,841,568	13,081,396	8,536,864	5,926,167	4,305,869	19,555,631	
			Nr. Abonenteve	235,366	168,957	237,016	199,616	112,726	64,822	36,381	20,262	11,438	6,997	4,540	11,392	
		Gusht	Konsumi	-	8,526,347	36,643,755	52,439,725	41,785,300	30,111,001	19,030,405	12,136,735	7,865,281	5,455,069	3,974,297	20,480,176	
			Nr. Abonenteve	217,405	165,553	241,580	212,071	120,832	67,611	34,896	18,790	10,537	6,442	4,193	12,007	
		Shtator	Konsumi	-	10,197,379	39,779,412	37,268,041	51,356,088	21,070,231	11,976,485	7,440,559	4,421,318	2,887,221	2,181,232	13,857,999	
			Nr. Abonenteve	232,374	202,859	263,685	208,504	108,288	47,410	22,001	11,510	5,915	3,407	2,301	7,439	

Aneksi nr.4

Rakordimi i ekspozimeve ndërmjet OSHEE Sh.a. dhe OST Sh.a. për vitin e mbyllur më 31.12.2021– Sipas OST

NR.	Emërtimi i Llogarisë	Monedha	Gjendje më 31.12.2020	Faturim 2021	Pagesë 2021	Rivlersim/ kurs kembimi	Gjendje më 31.12.2021
	Detyrimi i OSHEE ndaj OST						
	* Dsbalanca-Sistemim 2016-2017	Lekë	1,760,983,525	-	-		1,760,983,525
	* Dsbalanca-Sistemim 2016-2017	Euro	643,641,681	-	-	15,297,547	628,344,134
	* Sherbim per automjetet e vena ne dispozicion nga NJMT	Lekë	2,932,520	-	-		2,932,520
	* Penalitet per faturen 497 dt 31.12.2015	Lekë	490,054	-	-		490,054
	Totali	Lekë	2,408,047,800	-	-	15,297,547	2,392,750,233
	Detyrimi i OST ndaj OSHEE						
	* Dsbalanca-Sistemim 2016-2017	Lekë	(76,744,926)	-	-		(76,744,926)
	Total detyrimi Ost		(76,744,926)	-	-		(76,744,926)
	*Balanca Neto OSHEE		2,484,792,706	-	-	15,297,547	2,469,495,159

NR.	Detyrimet sipas mareveshjes OSHEE-OST	Monedha	Gjendje më 31.12.2020	Faturim 2021	Pagesë 2021	Rivlersim/ kurs kembimi	Gjendje më 31.12.2021
	Detyrimi i OSHEE ndaj OST						
	Transmetim energjie	Lekë	7,763,619,169	-	30,000,000		7,733,619,169
	Dsbalanca	Lekë	2,728,749,897	-	-		2,728,749,897
	Dsbalanca	Euro	58,539,109	-	64,544,455	(6,005,346)	
	Dsbalanca energjie Prill 2012	Lekë	24,518,730	-	-		24,518,730
	Kolaudim mates	Lekë	12,000	-	-		12,000
	Pagese pune per sherbimet e DTL Tirane	Lekë	3,144,361	-	-		3,144,361
	Matesa elektrike me NJOF	Lekë	1,162,721	-	-		1,162,721
	Totali	Lekë	10,579,745,986	-	94,544,455	(6,005,346)	10,491,206,877
	Dsbalanca	Lekë	891,977,677	-	-		891,977,677
	Total neto sipas marreveshjes		9,687,768,309	-	94,544,455	(6,005,346)	9,599,229,200
	Total detyrimi i OSHEE ndaj OST		12,172,561,015	-	94,544,455	9,292,201	12,068,724,359



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "PERFORMANCA E SHOQËRIVE PUBLIKE TË SEKTORIT ENERGETIK NË ADMINISTRIMIN E REZERVËS HIDRIKE NË KASKADËN E LUMIT DRIN, PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021-2022"

Emërtimi i Llogarisë	Monedha	Gjendje më 31.12.2020	Faturim 2021	Pagesë 2021	Rivlersim/ kurs kembimi	Gjendje më 31.12.2021
Detyrim I Fumizuesit I Tregut te lire ndaj OST						
Transmetim energjie	Lekë	726,798	16,122,226	7,490,572		9,358,451
Disbalanca	Lekë	257,634,077	1,817,277,852	-		2,074,911,929
Detyrim I OST ndaj Fumizuesi I Tregut te lire						
Disbalanca	Lekë	126,597,678	100,524,784	-		227,122,462
Disbalanca * Shitje te pafaturuara nga FTL pa TVSH-ne periudha Prill-Dhjetor	Lekë	-	335,361,699			335,361,699
*Balanca Neto Furnizues I Tregut te lire	Lekë	131,763,197	1,397,513,595	7,490,572	-	1,521,786,220

Emërtimi i Llogarisë	Monedha	Gjendje më 31.12.2020	Faturim 2021	Pagesë 2021	Rivlersim/ kurs kembimi	Gjendje më 31.12.2021
Detyrim I Fumizuesit Universal-OST						
Transmetim energjie	Lekë	867,417,129	5,871,196,778	3,816,193,818		2,922,420,090
Balanca NETO Fumizuesi I Sherbimit Universal		867,417,129	5,871,196,778	3,816,193,818		2,922,420,090
TOTAL Detyrimi Neto OSHEE Group 31.12.2021	Lekë	13,171,741,341	7,268,710,374	3,918,228,845	9,292,201	16,512,930,669

Rakordimi i ekspozimeve ndërmjet OSHEE Sh.a. dhe OST Sh.a. për vitin e mbyllur më 31.12.2021– Sipas OSHEE sha

Emërtimi i Llogarisë	Monedha	Gjendje më 31.12.2020	Faturim 2021	Pagesë 2021	Rivlersim/ kurs kembimi	Gjendje më 31.12.2021
Detyrimi i OSHEE ndaj OST						
* Sherbim per automjetet e vena ne dispozicion nga NJMT	Lekë	678,102	-	-		678,102
Totali	Lekë	678,102	-	-	-	678,102
Detyrimi i OST ndaj OSHEE						
Ost transferim aseti Fat 1 dt 31.03.2018	Lekë	29,326,601				29,326,601
IRTC fatura nr 27 dt 26.01.2018	Lekë	5,493,894				5,493,894
Total detyrim Ost		34,820,495	-	-	-	34,820,495
*Balanca Neto OSHEE 3=(1-2)		(34,142,393)	-	-	-	(34,142,393)

Detyrimet sipas mareveshjes OSHEE-OST	Monedha	Gjendje më 31.12.2020	Faturim 2021	Pagesë 2021	Rivlersim/ kurs kembimi	Gjendje më 31.12.2021
Detyrimi i OSHEE ndaj OST						
Transmetim energjie	Lekë	7,763,619,169	-	30,000,000		7,733,619,169
Disbalanca	Lekë	2,728,749,897	-	-		2,728,749,897
Disbalanca	Euro	58,539,109		64,544,455	(6,005,346)	-
Disbalanca energjie Prill 2012	Lekë	24,518,730	-	-		24,518,730
Kolaudim mates	Lekë	12,000	-	-		12,000
Pagese pune per sherbimet e DTL Tirane	Lekë	3,144,361	-	-		3,144,361
Matesa elektrike me NJOF	Lekë	1,162,721	-	-		1,162,721
Totali	Lekë	10,579,745,986	-	94,544,455	(6,005,346)	10,491,206,877
Detyrimi i OST ndaj OSHEE						
Disbalanca	Lekë	891,977,677	-	-		891,977,677
Total detyrim Ost		891,977,677	-	-	-	891,977,677
*Balanca Neto OSHEE 3=(1-2)		9,687,768,309	-	94,544,455	(6,005,346)	9,599,229,200
Total detyrimi i OSHEE ndaj OST		9,653,625,916	-	94,544,455	(6,005,346)	9,565,086,807

Akt Rakordimi KESH-OSHEE

AKT RAKORDIM KESH SHA-OSHEE					
Emërtimi	Monedha	Gjendje 31.12.2021			
		Valute	Kurs Kembimi BSH	ALL	
Prodhimi energjisë + Mbulim Humbje (OSHEE)	LEK			32,195,092,079.52	
OSHEE - Permbarim pa regjistruar				-	
OSHEE - Mbulim Humbje	EUR			-	
Diference mare permbarimi per fatura - pa regjistruar	LEK			- 2,858,932.00	
VKM 482 dt.05.06.2015				- 222,670,734.56	
OSHEE - Penalitete	LEK			14,764,058,470.00	
OSHEE - penalitete per vonesa ne pages	LEK			2,143,029,549.00	
OSHEE - Penalitete	EUR	1.23	120.76	148.53	
OSHEE - Shitje nga importi	EUR	-		-	
1. Totali për detyrimet e energjisë	LEK			48,876,650,580.49	
Detyrim për transferim aseti	LEK			17,400,414.00	
OSHEE - Shitje Materialelesh	LEK			16,864,433.00	
2. Totali detyrimit asete				34,264,847.00	
3. Totali detyrimit 1+2				48,910,915,427.49	
6.Marredhenie me OSHEE 30.06.2008 (provizionuar)				- 1,884,044,000.00	
7.Detyrimi ne total ndaj KESH sha (5-6)				47,026,871,427.49	



7/1. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I KESH-it

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar KESH është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2011/3 Prot., datë 27.12.2022 të administratorit të shoqërisë KESH Z. E.V., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

A-Pretendimet e subjektit

Ne lidhje me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH se:

KESH për muajin Maj, i ka shitur FSHU sasinë 317,077 MWh, duke tejkeluar me 57,077 MWh sasinë e parashikuar në kontratë. Subjekti KESH ka sjell si argument respektimin e vendimit nr.73/2020 piken 3 dhe se KESH nuk ka qene ne kushtet e tejkalimit te sasisë se kontraktuar prej 3,950,000MWh.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Observacioni i KESH për këtë pikë, trajtohet sipas tyre gjetje, por ne fakt ajo nuk është e renditur e tille ne materialin e auditimit, por si një konstatim burimi i te cilit është vete Departamenti i Operimit të Tregut (DOT) dhe në baze të të dhënave të bilancit të energjisë elektrike kjo diferencë përbën tejkalim të sasisë se parashikuar ne kontratën dypalëshe të miratuar nga ERE ndërmjet KESH dhe FSHU, **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

B-Pretendimet e subjektit

Ne lidhje me gjetjen e grupit të KLSH-se se:

Niveli i rezervës hidroenergjetike në Liqenin e Fierzës në Tetor 2021 zbriti me 29 m krahasuar me atë të muajt Maj. Në Tetor niveli zbriti në kuotën 267.74 m.m.n.d.

Ne observacionin e vet KESH përpiqet të sjelle si argument se kesh ka furnizuar FSHU, OST dhe KOSTT me 96% të sasisë se prodhuar ne kaskadën e Drinit, kjo me qellim sipas tyre të plotësimit të kërkesës se dërguar nga FSHU,... etj.

Gjithashtu sipas tyre, një nga arsytet ishin edhe kushtet meteorologjike me temperatura të larta mbi mesataren e muajve respektiv, të cilët sollën ulje të ndjeshme të prurjeve të lumenjve në Shqipëri.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Edhe për këtë pikë KESH nuk ka paraqitur evidence dokumentare të re dhe të panjohur me pare nga grupi i auditimit të KLSH, ashtu siç është trajtuar gjerësisht në këtë material auditimi

Siç raporton edhe ERE në raportet periodike dhe në korrespondencën me KESH, ku ka konstatuar që në fund të muajit Maj 2021 liqeni i Fierzës kishte një kuote maksimale prej 296.65 m.m.n.d.

Pra, siç është trajtuar edhe në këtë Raport përfundimtar të Auditimit, niveli i liqenit të Fierzës në këtë periudhë ishte brenda vlerave të lejuara maksimale dhe mbi mesataren disa vjeçare.

Me pas, nga administrimi i kaskadës së Drinit, niveli i lartë i arritur në 6 mujorin e parë të 2021 i cili përbente një siguri për të menaxhuar dhe shfrytëzuar sipas kushteve optimale kaskadën e lumit Drin edhe për 6 mujorin e dytë të vitit 2021, rezultojë se niveli i rezervës hidroenergjetike në Liqenin e Fierzës në Tetor 2021 zbriti me 29 m krahasuar me atë të muajt Maj. Pra në muajin Tetor 2021 niveli i rezervës hidroenergjetike në Liqenin e Fierzës zbriti në kuotën 267.74 m.m.n.d.

Kjo rënie e nivelit të Fierzës ka vijuar edhe përgjatë vitit 2022 duke arritur minimumin historik në fund të muajit Mars 2022 në kuotën 260.67 m.m.n.d., **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

C-Pretendimet e subjektit

Në lidhje me gjetjen e grupit të auditimit të KLSH, se:



KESH në periudhën Qershor deri Gusht 2021, që i përketë periudhës së thatë me prurje të pakta, rriti prodhimin e HEC-ve të kaskadës së Drinit duke prodhuar në total në këtë periudhë 1,192,661 MËh ose 30% të kërkesës së FSHU për furnizimin e konsumatorëve fundor.

Në mënyrë të përmbledhur observacioni i KESH konsiston se:

KESH ka shfrytëzuar rezervën energjitike i detyruar të përmbush kërkesën e FSHU/FTL për furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike, si detyrim për shërbimin publik.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Në observacionin e paraqitur për këtë pikë, KESH nuk ka kundërshtuar saktësinë e te dhënave të paraqitura nga grupi i auditimit të KLSH. Pasi rënia e nivelit të liqenit në muajin Tetor 2021, ka ardhur si rezultat i mosrespektimit të kushteve të shfrytëzimit dhe administrimit të kaskadës së Drinit, për ruajtjen e kuotave të prodhimit dhe nivelit minimal të lejuar. Gjithashtu në periudhën e thatë, në kushtet e mungesës së prurjeve; fakt është që KESH rriti nivelin e shfrytëzimit të HEC-ve në periudhën Qershor-Gusht 2021, duke prodhuar me gati 30% të kërkesës së kontraktuar me FSHU. Ndikim ka pasur në rënien e rezervës hidroenergjetike, edhe sasia e energjisë elektrike të prodhuar për shkëmbim me N.E. në periudhën Qershor-Tetor 2021.

Si përfundim, ashtu siç grupi i auditimit e ka nënvizuar edhe në këtë raport përfundimtar të auditimit, sfida e KESH ngelet, administrimi i rezervës hidrike si në drejtim të rezervimit të sasisë hidrike në rezervuarët e kaskadës në kushtet e prurjeve të mëdha, ashtu edhe në ruajtjen e vlerave të mesatares shumëvjeçare në kushtet e mungesës së reshjeve siç ka qënë rasti gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2021, **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

D-Pretendimet e subjektit

Në lidhje me gjetjen e grupit të auditimit të KLSH, se:

KESH nuk ka respektuar aneksin nr.1 të kontratës për furnizimin e FSHU me sasinë e energjisë elektrike të planifikuar për muajt Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor 2021.

Gjate observacionit të ve, KESH nuk e kundërshton gjetjen por konsiston se:

Për periudhën e cituar (Gusht -Nëntor), KESH, 95% të prodhimit e ka vënë në dispozicion të plotësimit të kërkesës së dërguar nga FSHU/FTL për furnizimin e klientëve fundorë

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Gjithë seti i gjetjeve të mësipërme, duke përfshirë edhe këtë pikë, ka të bëjë me të dhëna për periudhën objekt auditimi. Gjetjet e sipërcituar tregojnë shfrytëzimin dhe keqmanaxhimin e rezervës hidrike, e cila për pasoj sollli rënie drastike të nivelit të liqenit të Fierzës. Përgjigjet për këto gjetje janë trajtuara në mënyrë shteruese në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, nga ku përveç të tjerave për çdo gjetje grupi i auditimit ka dal me konkluzione përkatëse, **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

E-Pretendimet e subjektit

Ne lidhje me gjetjen e auditimit të KLSH, se:

KESH përveç operacioneve të tjera, si ato të shitjeve nga prurjet e larta, optimizimit, etj., në periudhën Qershor-Tetor 2021, ka dhënë 149,442 MWh energji elektrike shoqërisë tregtare N. E. në formën e shkëmbimit. Periudhë kjo që korrespondon me rënien e nivelit të liqenit të Fierzës.

Ne mënyrë të përmbledhur, KESH ka argumentuar se :

DOT ka vijuar me zbatimin e kontratës me shoqërinë N. vetëm pasi ka ezauruar të gjitha transaksionet e shitblerjes së energjisë elektrike me FSHU, OST, KOSTT dhe shitblerjet për optimizim në tregun e parregulluar, kjo deri në atë masë të kapaciteteve të vena në dispozicion nga drejtoria e shfrytëzimit si shkak i niveleve të liqenit të Fierzës si dhe të rimonteve të planifikuar e atyre të paplanifikuara në Kaskadën e Drinit nga Drejtoria e Mirëmbajtjes.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH



Observacioni për këtë pikë nga KESH duket i pakuptimtë, pas Grupi i auditimit të KLSH, nuk e ka trajtuar ligjshmërinë e këtij akti nga pikëpamja juridike dhe për me shume nuk ka meshuar në vlefshmërinë e tij në mungesë të miratimit në këshillin Mbikëqyrës dhe me tej në asamblenë e përgjithshme, por e ka parë vetë në pikëpamjen sasiore për të mundur që të jepte rekomandim që detyrimet e N. të realizohen sipas rekomandimit të KLSH. Pasi siç është paraqitur dhe në këtë Raport përfundimtar të auditimit, problematikat e konstatuara në lidhje me marrëveshjen Nr.2350/1 Prot. Datë 04.05.2021 për shkëmbimin e energjisë midis KESH dhe subjektit tregtar N. E. janë trajtuar edhe në raportin përfundimtar të KLSH me nr.889/34 Prot. Date 07.06.2022.

Trajtimi në këtë RPA, u bene sepse periudha e auditimit reflekton operacione tregtare të përditësuar në lidhje me sasi të shkëmbimit reciprok të sasisë së kontraktuar në marrëveshjen e sipërcituar. Pasi Subjekti tregtar N. E. deri në fund të muajt shtator 2022 është debitor për sasinë 17,515 MWh. Në bazë të kësaj marrëveshje kompania ka një fitim të munguar prej 9,367,730 euro në portofolin e vet financiar, pasi nëse sasia totale e shkëmbyer do të ishte shituar/blerë për optimizim në bazë të çmimeve referente në HUPX do të kishte një fitim prej 9,367,730 euro. Për sa rezultojnë në këtë raport përfundimtar auditimi problematikat me kompaninë N. janë të rëndësishme që të zgjidhen sa më parë, pasi sasia e mbartur dhe e pakthyer nga kjo kompani për llogari të KESH është e konsiderueshme edhe në vlerën financiare të saj, ky ka qenë qëllimi i trajtimit të kësaj gjetje nga grupi i auditimit të KLSH, **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

F-Pretendimet e subjektit

Në lidhje me gjetjen e grupit të auditimit të KLSH, se:

Departamenti i Operimit të Tregut nuk ka mundur të realizojë me sukses optimizimin e portofolit financiar nëpërmjet shitjeve/blerjeve për vitin 2021.

Në mënyrë të përmbledhur KESH argumenton se ka realizuar me sukses procesin e optimizimit duke bashkëlidhur dhe dokumente për observacionin e paraqitur.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH

Në lidhje me evidencën dokumentare të bashkëlidhur observacionit të kësaj pike, ato nuk janë të reja për grupin e auditimit të KLSH.

Shitjet dhe blerjet e realizuara nga DOT për optimizim në pamje të parë perceptohet që janë realizuar me sukses, pasi çmimi i shitjes është më i lartë se ai i blerjes, por ajo që ka ndikuar në mos realizimin e procesit të optimizimit është se sasi të blera nga KESH kanë qënë më të larta se ato të shitjes dhe për pasojë kanë ndikuar që efekti financiar i të ardhurave të rezultojë me humbje në shumën (5,840,019) euro për vitin 2021, **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

7/2. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I FTL-së

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar FTL është paraqitur observacioni me shkresën nr. 3043/1 Prot., datë 21.12.2022 të administratorit të shoqërisë FTL Znj. E. R., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit

Observacioni i FTL konsiston në gjetjet dhe konkluzionet e grupit të auditimit të KLSH në lidhje me planifikimin e fashave orare për të optimizuar blerjen e energjisë elektrike nga importi.

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në paraqitjen e metodologjisë së ndjekur nga Sektori i planifikimit në Drejtorinë e Tregtimit në përgjithësi dhe në vecanti atë të ndjekur për procedurën e blerjes nga importi për periudhën 11-17 tetor 2021. Pas hyrjes dhe shpjegimit të aktivitetit të përditshëm të këtij sektori ndër të tjera, në observacion shprehen, e citoj:



... per gjithë sa me siper, shoqëria "Furnizuesi i tregut te lire" Sh.A., nuk mund te planifikonte per te prokuruar sasine ditore prej 7559 MWh per te dyja periudhat (11-17 tetor dhe 13-17 Tetor 2021) pasi per keto dy periudha ka dy modele te ndryshme (te kryera ne kohe dhe kushte atmosferike te ndryshme)., etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit te KLSH

Subjektit të audituar FTL, si gjatë fazes studimore dhe asaj të terenit nga grupi i auditimit te KLSH i eshte bere prezent rendesia e zgjedhjes së fashës orare në profilin band apo pikë per procedurat që ajo realizon në bazë të kerkesave të FSHU dhe mundesive të KESH-it për furnizimin me energji elektrike për nevojat e konsumatorit fundorë apo të mbulimit të humbjeve për OSSH.

Subjekti FTL nuk ka sjellë apo pasuruar observacionin e vetë me evidence dokumentare të pa njohur më parë për grupin e auditimit të KLSH.

Sic është konstatuar dhe në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, planifikimi, zgjedhja e ditës dhe fashës orare për blerjen e energjisë elektrike ngelet një problematikat e trashëguara dhe si e tillë këto shoqëri duhet të rrisin nivelin e kapaciteteve të burimeve njerëzore që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre zgjedhjen optimale të fashës orare të blerjes apo shitjes, pasi zgjedhja e duhur ka ndikim në optimizimin e shpenzimeve të këtyre shoqërive pasi përcaktimi sipas një modeli statistikor të studiuar mund të rezultojë në blerjen e energjisë elektrike me çmim më të ulët në krahasim me fashat e përzgjedhura nga subjekti i audituar.

Grupi i auditimit të KLSH, për ta theksuar këtë çështje analizojë përcaktimin e fashës orare të lotit 2 për procedurën e prokurimit për periudhën 11-17 tetor 2021.

Përzgjedhja e kësaj procedure ka për qëllim ilustrative në lidhje me përcaktimin e fashës orare, pasi kjo procedure është realizuar sipas parashikime ligjore dhe për më shumë që loti 2 është anuluar nga komisioni i blerjeve te FTL dhe kjo qe sektori përkatës pranë FTL te bej një studim me te hollësishëm me variante dhe skenar te ndryshëm për te optimizuar blerjen e energjisë elektrike, **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

7/3. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I FSHU-së

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar FSHU është paraqitur observacioni me shkresën nr. 8486/1 Prot., datë 21.12.2022 të administratorit të shoqërisë FSHU., Z. E. S., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit

Observacioni i FSHU ne menyre te permbledhur ka te beje me gjetjen dhe rekomandimin e grupit te KLSH-se, si me poshte, e citoj:

...Nga auditimi i evidences dokumentare, sasia e kontraktuar si detyrim për të furnizuar FSHU në vitin 2021, wshtw realizuar brenda datës 20.12.2021 nga KESH-i.

Nga auditimi rezulton se: Sasia e lëvruar (shitur) nga KESH për FSHU pas datës 20.12.2021 deri më 31.12.2021 është 194,704 MWh.

Nga auditimi i faturave tatimore rezulton se e gjithë sasia e lëvruar nga KESH për vitin 2021 për FSHU është shitur me 1.5 lekë (Pa TVSH).

Në referim të pikës 3 nenit 2 të kontratës së sipërcituar, KESH-i sasinë 194,704 MWh duhej ta faturonte me çmimin e HUPX për FSHU.

Rekomandim: KESH në bashkëpunim me MIE, në cilësinë e pronarit të përbashkët për shoqëritë KESH dhe OSHEE grup, të kërkoj që shuma 618,8316,173 lekë (me TVSH) t'i faturohet shoqërisë FSHU sh.a., si një detyrim i lindur nga kontrata e shitblerjes të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të KESH.



Ne lidhje me kete rekomandim subjekti i audituar FSHU, ka sjellë si argument parashikimin e VKM 757 date 19.12.2021 për disa ndryshime ne VKM nr. 620 date 22.10.2021, konkretisht ne kreun IV, pika 1.

Qëndrimi i grupit të auditimit te KLSH

Për sa ju i referoheni ndryshimit të vkm 620 date 22.10.2021 me VKM 757 date 19.12.2021, pika qe ju i referoheni nuk ka ndryshim, pra ne VKM 620 date 22.10.2021 eshte percaktuar qe:

Shoqeria e prodhimit e ngarkuar me detyrimin e sherbimit publik furnizon Furnizuesin e Sherbimit Universal me gjithë sasine e nevojshme, per qellime te plotesimit te kerkeses te plote te furnizuesit te sherbimit universal, sipas cmimit per njesi te energjise lektrike, te miratuar nga Asambleja e Pergjitheshme e shoqerise.

Pra ndryshimi i kreut IV pika 1 te VKM 620 date 22.10.2021 ka te beje vetem me shtesen ne lidhje me te drejten e KESH në rolin e sherbimit publik për të marrë me qera asete gjeneruese termke të energjise, te shkembj/të depozitot apo të kryej transaksione shitblerje energjie në tregun e lirë.

Grupi i auditimit te KLSH, pa dyshim qe ishte ne dijeni te VKM 757 date 19.12.2021, por keto ndryshime nuk kishin te benin me kontaten e miratuar nga ERE dhe vendimin e Asamblese se pergjitheshme.

Kjo sasi energjie, për qëllime të përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik përkundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal, është përcaktuar në kontratën Nr. 2920/1 Prot., datë 24.09.2020 të miratuar nga ERE të bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit. Bazuar në Nenin 2 të kontratës së sipërcituar, "Sasia e kontraktuar dhe çmimi i shitjes", sasia e prodhimit të energjisë që KESH duhet të furnizoj FSHU-në për vitin 2020 dhe 2021, përcaktuar në Vendimin Nr. 10841/1 Prot., datë 27.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të KESH-sh.a. ka qënë në sasinë 3,950,000 MWh.

Nga auditimi, rezultoi se, Këshilli mbikëqyrës i KESH nëpërmjet vendimit nr.15 date 01.07.2021 me objekt "Për miratimin e disa ndryshimeve në programin ekonomik financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2021", ka rishikuar totalin e prodhimit neto nga 3,977,367 MWh në 5,322,813 MWh, nga ku rezulton që KESH për vitin 2021 ka prodhuar 5,901,697 MWh duke realizuar dhe tejkualuar parashikimin e planit ekonomik financiar.

KESH ka përmbushur detyrimin kundrejt FSHU, nga ku sasia e energjisë elektrike e shitur FSHU është 4,145 GWh, kundrejt sasisë së kontraktuar prej 3,950 GWh

Diferenca e sasisë së energjisë elektrike të shitur kundrejt të asaj të kontraktuar prej 194,704 MWh. nga KESH për FSHU është shitur me çmimin 1.5 leke/KWh, pra me të njëjtin çmim si ajo e sasisë së kontraktuar. Për sa më lart KESH ka vepruar në mospërputhje me neni 2 pika 3 të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 10841 /1prot, datë 27.12.2019 ku parashikohet se:

Shitësi në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë e prodhimit të energjisë elektrike mbi atë të parashikuar në piken 1, por në çdo rast jo me shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundor qe përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, është i detyruar t'ia ofrojë (propozojë) fillimisht Blerësit me çmimin e HUPX për atë moment.

Për sa më lart, në referuar të programit të rishikuar ekonomik financiar për veprimtarinë e KESH sh.a për vitin 2021., me nr.15, date 01.07.2021 protokolluar në KESH me nr.3474/1prot. Date 16.07.2021 në relacionin bashkëlidhur për rishikimin e programit ekonomik - financiar të veprimtarisë së shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021, miratuar nga asambleja e përgjithshme e aksionareve të shoqërisë me vendimin nr. 135/1 date 14.01.2021 "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021-2025", pika 1. Shitjet për FSHU është parashikuar, se:

Shitjet për FSHU sipas detyrimit për shërbim publik të përcaktuar me Vendimin e



Asamblesë Nr. 135/1 date 14.01.2021 "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021-2025" dhe sipas kontratës, parashikohen në masën 3,950 GWh, me çmim 1.5 leke/Kwh dhe rreth 208 GWh me çmimin mesatar të bursës HUPX.

Këshilli Mbikëqyrës në vendimin nr.20 date 21.10.2021 protokolluar në KESH me nr.4981/2 Prot date 10.11.2021 me objekt "Për miratimin e disa ndryshimeve në programin ekonomik financiar të shoqërisë KESH për vitin 2021" në relacionin bashkëlidhur në lidhje me sasinë dhe çmimin për FSHU, ka parashikuar që:

Shitjet për FSHU sipas detyrimit për shërbim publik të përcaktuar me Vendimin e

Asamblesë Nr. 135/1 date 14.01.2021 "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2021-2025" dhe sipas kontratës, parashikohen në masën 3,950 GWh, me çmim 1.5 leke/Kwh dhe rreth 208 GWh me çmimin mesatar të bursës HUPX.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.20 datë 21.10.2021 me objekt "Për miratimin e disa ndryshimeve në programin ekonomik financiar të shoqërisë KESH për vitin 2021" miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me shkresën nr.5755/3 datë 19.11.2021 ka konfirmuar që çmimi mbi sasinë e kontraktuar prej 3.950 GWh duhet të jetë sa çmimi mesatar i bursës HUPX, **prandaj observacioni për këtë pikë nuk do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

7/4. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I ERE

Në respektim të afatit 1-mujor, ERE përcolli shkresën nr.1372/2 prot., datë 05.12.2022, duke shprehur dakortësi të plotë me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH-së.

7/5. SHTOJCAT – OBSERVACIONI I OST-së

Në respektim të afatit 1-mujor, OST përcolli shkresën nr. 2575/3Prot., datë 05.12.2022, duke shprehur dakortësi të plotë me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH-së.